



Syri i Vizionit
Konsultimet lokale me shoqërinë civile
Hotel Dukagjini
26.06.2009
Pejë

Programi

Konsultimet lokale me shoqërinë civile të Kosovës për formimin e Komisionit rajonal për verifikimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në ish Jugosllavi (KOMRA)

Nevojat dhe pritjet e viktimave, shoqërisë kosovare dhe drejtësia tranzicionale

(26.06.2009. Hotel „Dukagjini“, Pejë)

- | | |
|---------------|--|
| 10:00 – 10:15 | Hapja e takimit
Veton Mujaj , Syri i Vizionit, anëtar i Koalicionit për formim të KOMRA-s |
| 10:15 – 11:45 | Nevojat dhe pritjet e viktimave, shoqërisë kosovare dhe drejtësia tranzicionale:
Bekim Blakaj , Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë
Përkrahja morale, materiale dhe ligjore
Drejtësia tranzicionale dhe zëri i viktimave

Diskutimi i pjesëmarrësve |
| 11:45 – 12:00 | Përvoja e të tjerëve në verifikimin e fakteve për të kaluarën
Veton Mujaj , Syri i Vizionit |
| 12:00 – 12:15 | Pauza |
| 12:15 – 13:00 | Prezantimi i nismës për themelimin e KOMRA-s <ul style="list-style-type: none">• Qëllimi dhe rrjedhoja e konsultimeve• Perse KOMRA? Salem Çorbo , Shoqata “Kthimi dhe mbijetesa e qëndrueshme“, BeH |

Valdete Idrizi, anëtare e Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA

Diskutimi i pjesëmarrësve

13:00 – 14:00

Shfaqja e filmit *Përballja me të vërtetën: Komisionet për të vërtetën dhe shoqëritë në tranzicion*

Diskutimi i pjesëmarrësve

Besarta Vasija, Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë

14:00 – 15:00

Fjalët përmblyëse: Komentet dhe propozimet

Evoluimi dhe rekomandimet

Moderator: **Veton Mujaj**

15:00

Dreka

Pjesemarrësit

1	Agim Gashi	Njësitë për të drejtat e njeriut, Klinë
2	Ardiana Begolli	SH.I.P.P.L
3	Arton Krasniqi	Zana (Kline)
4	Atdhe Berisha	OJQ, Kalaja, Peje
5	Atifete Bytyqi	Familja dhe Shpresa, Kline
6	Blendi Hoda	Prosperiteti
7	Elbert Krasniqi	Keshilli Rinor Pejan (Peje)
8	Gazmir Raci	Pro Peace
9	Gjylfidane Morina	NJPB
10	Hajdin Balaj	Shoqata e veteraneve të Luftës (Kline)
11	Halil Blakaj	Shoqata e veteraneve të Luftës (Istog)
12	Ilirijana Hoti	Medica (Gjakove)
13	Imer Zikollaj	Piramida, Dreje (Istog)
14	Lale Grabanica	Elena Gjika (Kline)
15	Lamir Rugova	Fahri Vraniqi (Gjakove)
16	Lendrit Qeli	Prosperiteti (Gjakove)
17	Lize Marku	“Indira” Videje (Kline)
	Lulzim Arapi	Shoqata ndihmë psiko sociale për fëmijë
18		Gjakove
19	Miradije Gashi	Venera (Peje)
20	Nora Dobruna	Shtëpia e sigurtë (Gjakove)
21	Pren Mrashaj	Veteranët e luftës (Peje)
22	Qefsere Kumnova	Shoqata e gruas (Gjakove)

23	Rexhë Mulaj	Vizioni 02 (Istog)
24	Sabrije Zeqaj	Hendikos (Peje)
25	Safete Gacaferri	Jeta (Decan)
26	Sami Topalli	RAE (Gjakove)
27	Sanije Hasanaj	Alma (Peje)
28	Shasimete Selimaj	Shoqata gruas, 7 shtatori (Peje)
29	Shkumbin Hyseni	Tides (Decan)
30	Veton Berisha	Programi i të drejtave civile në Kosovë
31	Vigan Husaj	OJQ, Arti, Peje
32	Vllaznim Krasniqi	Nisma për unitet&paqe (Peje)
33	Vlora Sadikaj	Handi Kos
34	Zyrafete Rushaj	OJQ, Jeta

Vezhguesit

1	Elvane Gjakova	UNHCR
2	Driton Bakraçi	ICO - Peja
3	Haxhi Neziraj	Komuna e Pejës
4	Sabahate Qarkadiu	Komuna e Pejës – Njesiti për të drejtat e njeriut
5	Remzije Maloku	Komuna e Klina – Njesiti për të drejtat e njeriut
6	Sanije Mavraj	Komuna e Istogut – Njesiti për të drejtat e njeriut
7	Artan Kastrati	UNHCR – Peja

Panelistet/Organizatore

1	Veton Mujaj	Syri i vizionit
2	Salem Corbo	Kthimi dhe mbijetesë e qëndrueshme,
3	Valdete Idrizi	CBM, Mitrovicë
4	Bekim Blakaj	FDH, Kosovë
5	Besarta Vasija	FDH, Kosovë
6	Qenan Bardhaj	Syri i vizionit
7	Zana Latifi	Syri i vizionit
8	Naser Lajqi	Syri i vizionit
9	Vlora Latifi	Syri i vizionit
10	Dukagjin Nishiqi	Syri i vizionit

Hapja e takimit

Veton Mujaj: Të nderuar pjesëmarrës, pjesëtarë prej Komunës, ISO-s, vëzhgues të tjerë të organizatave ndërkombëtare, mediat, mirëserdhët në takimin e sotëm. Realisht, ne po fillojmë edhe pse në ndërkohë pritjet që të vijnë edhe pjesëmarrësit tjerë. Jemi mbledhur sot këtu në Pejë, në vazhdën e shumë takimeve që po mbahen përveç në nivelin e Kosovës, thuaj në të gjitha rajonet e Kosovës, por edhe në të gjitha hapësirat e ish-Jugosllavisë. Ideja është që të jemi bashkë me juve, jo për të treguar ndonjë aspekt të gjerë, por të marrim më shumë mendime mbi të gjitha ato që shihen se ne në të ardhmen mund të veprojmë së bashku. Kryesisht, kemi të bëjmë pra me konsultime, në mënyrë që të krijojmë një ide të përbashkët mbi nevojat e vazhdueshme që besoj do të jenë të mëdha kryesisht në zbardhjen e nevojave dhe fakteve për të cilat do të përballemi në vitet në vazhdim. Paraprakisht, para se të fillojmë do të thotë me një ecje të përgjithshme të njerëzve dhe bisedave të vazhdueshme, unë do të ju shpjegoj pak përfaqësisht se çka mendohet të bëhet sot, gjatë kësaj dite të punës. Pas prezantimit të të gjithë pjesëmarrësve, ne do të vazhdojmë me një tematikë për nevojat dhe pritjet e viktimave të shoqërisë kosovare dhe të shoqërive në tranzicion. Por, të gjitha temat dhe e gjithë pjesa e panelit do të jenë shumë të shkurtër për shkak se do të bisedohet shkurt për me u lënë hapësirë më shumë diskutimeve që do të vijnë prej juve. Do të thotë ne do të tentojmë që secili në këtë temë të jemi shumë të shkurtër. Pas diskutimit të parë do të shpjegohen disa përvoja në botë mbi formimin e komisioneve të ndryshme. Do të kemi një pauzë të shkurtër për kafe, pastaj do të shqyrtojmë disa përvoja dhe do të jepen disa ide pse ka ardhur deri te iniciativa e krijimit dhe si paramendohet dhe bashkëbisedohet për këtë proces dhe për të lënë hapësirë që këtë proces ta përmbushim prej anës tuaj mbi KOMRA-n. Me ne do të jenë shoqërues dhe bartës të këtij këshilli nismëtar, do të kemi nga Bosnja, përvojat vendore nga Kosova dhe pastaj pas diskutimeve të shkurtra prej panelistëve gjithsesi do të mbetet hapësirë prapë për pjesëmarrjen tuaj aktive për të dhënë mendime dhe për një bashkë koordinim. Do të shohim edhe një përvojë prej shfaqjes së filmit, të cilin do ta shohim në pjesën e pas ditës dhe do të mundohemi që sado pak në fund të këtij takimi të mundohemi që të kemi disa rekomandime mbi ecuritë e mundshme të punës sonë në vazhdimësi. Pastaj, të gjithë së bashku, në fund do të kemi një koktej. Do të thotë, paraprakisht kjo është ajo që do të përpiqemi të përballemi sot, të konsultohemi, të marrim më shumë ide. Do të thotë gjithçka është në pjesën tuaj dhe do të varet kryesisht nga mendimet dhe nevojat që shihen nga ana e secilës organizatë ose pjesëmarrës. Fillimisht kisha pas dëshirë të fillojmë me prezantimin e të gjithë personave pjesëmarrës, duke filluar nga panelistët tanë që ua kisha dhënë fjalën një nga një, mundësisht e shkurt prej nga vini, emri e mbiemri, organizata dhe cila është pritja, shkurtimisht në këtë takim. Kisha filluar prej juve, Valdete!

Valdete Idrizi: Faleminderit! Jam Valdete Idrizi, vi nga Mitrovica dhe vi prej Organizatës joqeveritare CBM - me seli në Mitrovicë. Njëkohësisht jam edhe anëtare e Grupit koordinues të Koalicionit për Iniciativën e formimit të Komisionit rajonal për vërtetimin e fakteve të luftës në ish-Jugosllavi. Po më vjen shumë mirë që jam sot këtu në Pejë dhe po më vjen mirë që po i shoh disa fytyra, disa njerëz që i kam takuar në disa vite më parë, atëherë kur kemi bashkëpunuar në fusha të ndryshme. Unë sot pres prej të gjithë neve që të jemi të hapur në diskutime, që të paraqesim të gjitha pyetjet, të gjitha paqartësitë që i kemi, të gjitha sugjerimet. Me një fjalë të jemi sa më të lirshëm me njëri-tjetrin sepse ky është një lloj procesi dhe në proces mund të ndodhin ndoshta edhe

gabime të shumta, nëse i mbajmë të gjitha ato rezerva në veti. Kështu që, shpresoj se do të jemi të gjithë të hapur dhe të shfrytëzojmë këtë tryezë dhe të bashkëbisedojmë dhe të shpërndajmë informata për njëri-tjetrin. Më falni, ndoshta e zgjata pak. Faleminderit shumë!

Bekim Blakaj: Mirëdita! Unë jam Bekim Blakaj, jam udhëheqës i Zyrës së Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë – organizatë e cila ka qenë nismëtare e idesë për tu themeluar një Komision për nxjerrjen e fakteve për krimet e luftës. Më vjen shumë mirë që jam sot këtu, sepse mendoj që jam në vendin tim sepse jam me prejardhje prej Istogut, fshatit Kovragë, por si do qoftë, të mos ju lodhi, sot pres që të kemi diskutime të hapura pasi që kemi me pas prezantime për nevojat e viktimave dhe së pari të dëgjojmë cilat janë nevojat e viktimave dhe shpresoj se do të kemi ndonjë ide ose ndonjë rekomandim të mirë prej debatit të sotëm. Faleminderit!

Veton Mujaj: Në vazhdimësi, do me thënë, unë jam Veton Mujaj. Jam prej Organizatës “Syri i vizionit” këtu në Pejë. I jemi bashkëngjitur kësaj ideje për të filluar një hulumtim të përbashkët për vazhdimësi të punës dhe shpresojmë se shumë elemente do të dalin nga ky takim si nevojë ose bashkëbisedim.

Salem Çorbo: Unë jam Salem Çorbo, drejtor ekzekutiv i Shoqatës “Kthimi” në Bijelinë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe merrem tash e sa kohë me të gjitha çështjet dhe aspektet e viktimave civile të luftës dhe shpresoj se sot do të kam rastin të dëgjoj përvojat dhe problemet që janë të pranishme në këtë fushë, para se gjithash, në këtë pjesë të Kosovës.

Besarta Vasija: Mirëdita! Jam Besarta Vasija, nga Fondi për të Drejtën Humanitare – Prishtinë. Unë jam koordinatorë për Kosovë e Koalicionit për themelimin e Komisionit rajonal për vërtetimin dhe përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut në shtet e ish-Jugosllavisë.

Adem Berisha: Ju përshëndes! Jam Adem Berisha, nga Peja, prezantohem me OJQ, njëkohësisht jam familjar i 8 të vrarëve gjatë luftës së fundit.

Lulzim Arapi: Jam Lulzim Arapi, e përfaqësoj një Shoqatë e cila merret me shëndetin mental - Shoqata për Ndihmë Psiko-sociale për fëmijë dhe familje, që dhjetë vitet e fundit, pra është një përvojë e konsiderueshme në punën me personat të cilët kanë përjetuar humbje, kështu që do të doja që sot të bëjmë një hap përpara drejt paqes.

Sami Topalli: Jam Sami Topalli, i OJQ-ës ... për të drejtat e njeriut. Në këtë debat pres që të njoftohemi gjerësisht lidhur me situatën e mëtutjeshme.

Lale Grabanica: Shoqata “Elena Gjika”. Përshëndes iniciativën që e ka marrë KOMRA dhe shpresoj se do të punojmë në atë drejtim. Faleminderit!

Miradije Gashi: Jam Miradije Gashi, vi nga Shoqata – Organizata joqeveritare “Venera”. Ne merremi me punë të kontabilitetit dhe të financave.

Sanije Hasanaj: Quhem Sanije Hasanaj, vi nga Shoqata “Alma”. Më vjen mirë që jam këtu dhe besoj se do të marrë informata të duhura.

Vllaznim Krasniqi: Përshëndetje! Jam Vllaznim Krasniqi, vi nga Organizata “Nisma për paqe dhe unitet”.

Lendrit Qeli: Quhem Lendrit Qeli, i përkas komunitetit egjiptas, përfaqësoj Organizatën joqeveritare “Prosperiteti”, organizatë e cila ka për qëllim sensibilizimin dhe vetëdijesimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Shkumbin Hyseni: Përshëndetje! Jam Shkumbin Hyseni, nga Organizata joqeveritare TIDS. Nga ky takim pres që të kemi një pasqyrë më të qartë të atyre familjeve dhe të

atyre rasteve që janë më prekëse nga lufta dhe nga pasojat e gjertanishme që kanë pësuar nga lufta. Faleminderit!

Shasimete Selimaj: Jam Shasimete Selimaj, vi nga Organizata “7 shtatori”. Përshëndes këtë nismë, shumë me rëndësi. Faleminderit!

Sabrije Zeqaj: Quhem Sabrije Zeqaj. Jam menaxhere regjionale e organizatës Hendikos, e cila punon për personat me aftësi të kufizuara. Kjo organizatë synim ka mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara dhe punon në integrimin gjithëpërfshirës në sferat e jetës. Sot nga ky takim, sikur çdo kush që ka pësuar trajtimet e këqia nga lufta, që ka persona me aftësi edhe të kufizuara dhe pres nga ky takim të marrim informata më të bollshme.

Imer Zikollaj: Jam Imer Zikollaj, vi nga Istogu – nga Organizata “Piramida”. Sot ideja për organizimin e këtyre konsultimeve është mjaft e qëlluar dhe i përgëzoj organizatorët për këtë.

Arton Krasniqi: Përshëndetje! Unë jam Artan Krasniqi, dhe jam përfaqësues i Organizatës joqeveritare Klinë, Shoqatë e cila kryesisht apo në përgjithësi merret me promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Lamir Rugova: Mirëdita! Ju përshëndes të gjithëve. Quhem Lamir Rugova, vi nga Organizata joqeveritare “Fahri Vraniqi” Gjakovë.

Rexhë Mulaj: Përshëndetje të gjithëve! Jam Rexhë Mulaj, vi nga Organizata multietnike “Vizioni 02” nga Istogu. Nga ky takim pres rekomandime të mira dhe për veprim të përbashkët. Ju faleminderit shumë!

AtifeteBytyqi: Përshëndetje! Jam Atifete Bytyqi, nga Klina. Vi nga Shoqata “Familja dhe shpresa” ku aktiviteti im është për familjet që i kanë personat ende të pa gjetur në komunën e Klinës.

Halil Blakaj: Përshëndetje për të gjithë! Jam Halil Blakaj, përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare, dega në Burim. Faleminderit!

Pren Marashi: Përshëndetje të gjithëve! Pren Marashi, nga Organizata e veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Pejë. Unë, sinqerisht të ju them, pres nga ky takim që të gjitha këto shoqata, në rend të parë, edhe organizatorët, përgjegjësia kryesore nga këto takime të mbetet mbi institucionet shtetërore, në rend të parë presioni ndaj institucioneve dhe qeverisë së Serbisë, sepse është e vetmja qeveri e cila nuk bashkëpunon lidhur me këtë. Prandaj, shpresoj se gjatë debatit për këtë do të diskutojmë më shumë. Më falni! Faleminderit!

Elbert Krasniqi: Mirëdita! Elbert Krasniqi, prej Këshillit Rinor të Pejës, shpresoj se do të dalim me ide të përbashkëta pas këtij takimi.

Nora Dobruna: Jam Nora Dobruna, vi nga Shtëpia e sigurt, strehimore e viktimave të dhunës në familje. Nga ky takim pres të shkëmbejmë përvoja dhe të marrim fakte e informata të reja lidhur me këtë temë.

Ilirijana Hoti: Jam Ilirijana Hoti, juriste pranë Shoqatës Medika Kosova në Gjakovë, e cila është themeluar në vitin 1999 me qëllim të përkrahjes psiko-sociale, juridike dhe gjinekologjike të grave ose femrave të dramatuara gjatë luftës dhe që kanë përjetuar çfarëdo dhune.

Remzije Maloku: Quhem Remzije Maloku, koordinatore e Njesisë për të drejtat e njeriut dhe zyrtare për barazi gjinore Klinë.

Saniye Mavraj: Jam Saniye Mavraj, koordinatore e Zyrës për të drejtat e njeriut në Istog.

Haxhi Neziraj: Jam Haxhi Neziraj, kryetar i Komisionit për të pa gjetur dhe në emër të kryetarit, zotëri Ali Berisha, e përshëndes këtë takim.

Driton Bakraçi: Jam Driton Bakraçi, nga Zyra civile ndërkombëtare në Pejë.

Elvane Gjakova: Jam Elvane Gjakova, këshilltare juridike pranë Programit për të drejtat civile CRPK në Pejë. Njëherit sot përfaqësojmë edhe UNHCR-in.

Artan Kastrati: Jam Artan Kastrati, nga Organizata Programi për të drejtat civile në Pejë. Jam bashkë me kolegun këtu.

Hajdin Balaj: Jam Hajdin Balaj, nga Klina, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës. Ju përshëndes të gjithëve!

Aver Husaj: Jam Aver Husaj, Drejtorati për Arsim dhe Kulturë në Pejë.

Agim Gashi: Agim Gashi, Njësitë për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Faleminderit!

Blendi Hoda: Blendi Hoda, Gjakovë.

Vigan Husaj: Vigan Husaj, OJQ “Arti” Pejë.

Veton Mujaj: Faleminderit për prezantimin. Besoj se është një grup i madh i organizatave të ndryshme, sigurisht me punë dhe mendime të ndryshme dhe për këtë ndoshta edhe një llojllojshmëri e temave në fund do të na bie edhe deri te disa rekomandime pak më gjithëpërfshirëse. Faleminderit edhe një herë për pjesëmarrjen.

Para se të vazhdojmë me panelistët, vetëm ju kisha lutur që në momentin kur fillojmë diskutimet, të kemi parasysh që, secili, prapë të prezantohet dhe njëkohësisht të ketë mundësinë të flasë më ngadalë për shkak të përkthimit në sallë.

Fjalën e kisha drejtuar tash te Bekim Blakaj, nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, kryesisht mbi temën, nevojat dhe pritjet e viktimave të shoqërisë kosovare dhe drejtësisë tranzicionale. Beki, urdhëroni!

Bekim Blakaj: Faleminderit Veton! Unë, në fillim do t’i falënderohem Vetonit për këtë organizim respektivisht Organizatën “Syri i vizionit”, e gjithashtu edhe të gjithë juve që jeni prezent këtu – organizatave të veteranëve të luftës, organizatave që merren me trajtimin e viktimave dhe më vjen shumë mirë që në mesin tonë po shoh organizata të tilla dhe besoj se prej tyre do të marrim rekomandime të mira dhe mënyra se si duhet të veprohet në të ardhmen për rehabilitimin e viktimave. Gjithashtu, përshëndes edhe të gjithë pjesëmarrësit, qofshin ata monitorues apo pjesëmarrës aktiv të këtyre konsultimeve. Siç e përmendi Vetoni në fillim, unë do të jam shumë i shkurtër, sepse pres që do të kemi një debat dhe do të nxjerrim më shumë ide të reja se si duhet ballafaquar me të kaluarën. Megjithatë, unë do t’i them disa fjalë, edhe pse e kam një përvojë tetëvjeçare në punë me viktimat e luftës, unë mendoj se në mesin tonë këtu ka edhe njerëz që janë të prekur, që i përfaqësojnë njerëzit, viktimat e luftës dhe pres nga ata që të marrin fjalën dhe të japin rekomandimet e tyre. Sidoqoftë, besoj se të gjithë ju e dini që edhe dhjetë vjet pas përfundimit të luftës, të vrarët, të rënë dhe të zhdukurit në Kosovë nuk kanë marrë trajtimin e duhur. Çdo ditë ata janë duke u mbetur të vetëm, të vetmuar. Një herë në vit mbahet një komemoracion dhe kjo është e tëra. Aq më keq është se nuk është rregulluar statusi i tyre ligjor. Ende nuk e kemi një ligj për personat e zhdukur. Te ne në zyre shumë shpesh vijnë ankesa prej palëve të ndryshme. Familjarët e personave të zhdukur ende nuk mund t’i realizojmë të drejtat e tyre ligjore, në pronë e në çka do qoftë, nuk mund të nxjerrin dokumentacionet personale për shkak se ende nuk e kemi një ligj për persona të zhdukur, pastaj për veteranët e luftës. Besoj se mysafiri i nderuar, zotëri Salem Çorbo mund të na tregojë më shumë diçka për përvojat në Bosnje. Më vjen keq që

s'e kemi askënd prej Kroacisë, mirëpo informatat që i kam unë në këto vende statusi i tyre është i rregullar shumë më mirë dhe nuk e kanë vetëm një asistencë, më falni që po shprehem kështu, por një asistencë të mirë materiale. Ata kanë pensionet e tyre me të cilat mund të jetojnë në mënyrë të denjë, ndërsa tek ne nuk ekziston kjo. Gjatë punës sime në terren kam hasur, dhe është fakt, në familje të prekura nga lufta dhe shumica prej tyre janë në gjendje shumë të keqe materiale. Është ajo shtresa që kategorizohet si varfëri e skajshme. Unë mendoj se institucionet tona nuk kanë bërë mjaft për këto grupe të prekura nga lufta. Çka është bërë me drejtësinë për ta? Mjafton tua them një fakt. Deri më tani në Kosovë, nga gjyqësia kosovare, vetëm dy raste për krime lufte e kanë marrë formën prerë, që do të thotë se ka përfunduar procesi. Kanë filluar shumë. Ndërkohë, të akuzuarit që kanë bërë krime janë liruar, kanë ikur prej burgut. Janë dënuar, mirëpo gjykata supreme i ka kthyer në rigjykim këto lëndë, kurse viktimat – pala e dëmtuar në këto raste, nuk ka mund ta sheh ende drejtësinë. Dhe, nëse vazhdohet me këtë tempo, atëherë unë kam frikë që kurrë viktimat nuk do ta shohin drejtësinë. Gjithashtu, edhe Gjykata ndërkombëtare Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavinë është marrë vetëm me ato raste, që ata i kanë selektuar si raste më të rëndësishme. Ndërsa, rastet tjera ua kanë lënë gjykatave vendore të merren me to. Për ta përfunduar këtë temë, unë mund të them se gjyqësia në Kosovë ka dështuar plotësisht, sidomos sa i përket ballafaqimit me krimet e luftës dhe me shkeljet e rënda të drejtave të njeriut në të kaluarën. Prandaj, neve – shoqërisë civile na mbetet që të mos vazhdojë më kjo gjendje, shoqërisë civile dhe çdokujt prej nesh në Kosovë. Kjo është një përgjegjësi e të gjithë neve, jo vetëm e familjarëve, jo vetëm e shoqatave të tyre por e të gjithë shoqërisë civile. Më vonë, kolegët e mi, në panel, do të flasin për një nismë që ka filluar para disa vitesh për një ide që ka filluar që të ballafaqohemi me të kaluarën. Prandaj, nuk do të flas për këtë temë, por do ua lë kolegëve të mi. Por, ajo që desha të përmend, është se gjatë punës time në terren kam vërejtur se familjarët e viktimave dhe vetë viktimat kanë nevojë dhe nevoja dhe e drejta primare e tyre e pamohueshme e tyre është që ta dëgjojnë të vërtetën: pse dikush ua ka vra pjesëtarët e familjeve. Kush është ai? Cili ka qenë motivi? Si ka ndodhur kjo? Ku gjenden trupat e të vvarëve, pse ka ndodhur zhvendosja e trupave? Do të thotë, në rend të parë është dëgjimi i së vërtetës, hulumtimi i së vërtetës, nxjerrja e së vërtetës. Pastaj, jo më me pak rëndësi është përgjegjësia. Dikush duhet të përgjigjet për këto të **pa** bëra për këto krime. Gjatë bisedave me familjarët e viktimave, që është diçka shumë e natyrshme, shumë njerëzore, pa marrë parasysh se çfarë dënimi e merr kryerësi i veprës, familja, viktimat nuk do të ketë satisfaksion, sepse ka pasur një humbje të pariparueshme. Megjithatë, është një satisfaksion moral për ta kur e dëgjojnë të vërtetën dhe kur e shohin se ka përfunduar para gjykatës kryerësi i veprës ose kryerësit e veprave. Domethënë, kjo është hallka tjetër në zinxhir të cilin s'mund ta kapërcejmë kurrsesi. Duhet të ballafaqohemi me të kaluarën, duhet të nxirren përgjegjësit para drejtësisë, pastaj hapi i ardhshëm është, të cilin ne e quajmë, riparim ose dëmshpërblim. Nuk është e thënë se gjithmonë dëmshpërblimi të jetë material, edhe pse unë personalisht mendoj që këtu duhet të ketë edhe dëmshpërblim material, mirëpo është edhe dëmshpërblimi në forma të ndryshme. Edhe ngritja e memorialëve, mund të kategorizohen në mënyra të ndryshme dhe nuk është e thënë të jetë përmendore, mund të jetë një ditë e caktuar në vit ku do të përkujtohen, domethënë një ditë ose një javë ose një kohë edhe më e gjatë ku do tu përkushtohen viktimave. Prandaj, tek, më vonë, pas kalimit të këtyre hapave paraprakë mund të flasim për një, të them ashtu, relaksim. Unë dua ta ndaj me ju një eksperiencë

timen dhe Veton ndoshta po ju marr kohë pak, por megjithatë dua të ndaj me ju këtë lidhur me atë se si unë i kam parë në praktikë këta hapa që i përmenda: e vërteta, drejtësia dhe reparacioni. Më 27 mars të vitit 1999, në Podujevë. Dhe, ato ditë ka pasur nëpër krejt Kosovën krime të tmerrshme, masakra, vrasje dhe zhdukje masive. Mirëpo, të nesërmen, më 28 mars të vitit 1999 në qytet të Podujevës ka ndodhur një masakër e tmerrshme ku janë vrarë 14 pjesëtarë të tri familjeve, të gjithë ata fëmijë e gra. Atë ditë, një njeri prej Podujevës i ka humbur dy prindërit e vetë, gruan dhe katër fëmijë. Fëmiju më i vogël i ka pasur 21 muaj. Ne gjatë punës sonë, në Organizatën tonë kemi mbledhur të dhëna, fakte për krimet që kanë ndodhur dhe kam shkuar me i intervistua. Pasi jam prezantuar, ka qenë një ndjenjë që nuk mund ta harrojë kurrë, nuk mund tash edhe ta definoj. Ka qenë dhembje aq e madhe apo hidhërim aq i madh, tërbim thuaja dhe thjeshtë nuk ka dashtë të bisedojë me mua, më ka përndjek prej shtëpisë së tij, ia kam pa lotët në sy. Por, unë nuk kam heq dorë, pas nja 3 muajve e kam kontaktuar vëllanë e tij, kështu që më është dashur një vit e gjysmë deri sa ai ka pranuar të ma jap deklaratën. Pastaj, pas do kohe me punën e madhe të drejtoreshës së Organizatës time janë mbledhë fakte të mjaftueshme të cilat iu kanë dorëzuar prokurorisë e më vonë është ngritur aktakuzë ndaj një pjesëtarit të atij njësitit që e ka bërë atë krim dhe është gjend para gjykatës. Ky zotëri ka shkua në gjykatë dhe e ka deponuar deklaratën e tij, ka dhënë fakte të mjaftueshme. Kryerësi i veprës është dënuar. Pastaj, edhe katër pjesëtarë tjerë të atij njësitit janë akuzuar dhe para pak ditësh janë dënuar edhe ata. Organizata jonë ka bërë padi ndaj shtetit të Serbisë dhe shpresoj se do ta fitojmë. Është kjo padi për dëmshpërblim për familjarë. Si do qoftë, para pak ditësh kam pas takim me atë zotërinë dhe unë e di që ai ka dhembje të mëdha dhe kurrë nuk do t'i ndalojë ato dhembje. Mirëpo, ai tash është tjetër njeri, nuk është ai i vitit 2000 që e kam pas takuar unë për herë të parë, sepse ka kaluar nëpër këto faza, ka pas rast në gjykatë të dëgjojë si ka ndodhur e gjithë ajo, e ka pa dënimin që e kanë marrë kryerësit e veprës dhe tash ende nuk ka reparacion për të, por ai, siç thotë vetë ndihet më mirë. Domethënë mendoj se këta hapa duhet të aplikohen gjithkund. Ju kërkoj ndjesë që isha ndoshta shumë i gjatë, por shpresoj se kemi me pas debat këtu dhe kushdo që ka ndonjë pyetje jeni të mirëseardhur. Faleminderit!

Veton Mujaj: Faleminderit, shumë Bekim! Për t'u ndie më lirshëm, desha të ju tregoj vetëm për kyçjen e organizatës tonë në këtë proces. Do të thotë nuk ka shumë kohë, është para dy-tre muajve që kemi dëgjuar duke biseduar me kolegë, me njerëz që bashkëpunojmë, organizata jonë nuk ka ndonjë përvojë të caktuar në këtë proces por duke parë një kohë shumë të gjatë se asgjë nuk është bërë, po tentojmë pra në njëfarë forme që edhe ne, me atë formën edhe më të vogël dhe e mundshme ta japim kontributin tonë. Prandaj, po them se edhe secili nga ju, në formën e veçantë, ndoshta kishte mund ta jap një kontribut dhe të ndihet lirshëm në këtë proces. E thash këtë sa për të filluar edhe diskutimin dhe të ndjehemi të lirë dhe të shprehim tamam atë që e mendojmë në shpirtat tanë, për shkak se realisht e dimë se është një temë e cila nuk ekziston në Kosovë më e dhembshme dhe më e vështirë për ta diskutuar. Por, besoj se me ndihmën e të gjithëve, këto gjëra duhet gradualisht të fillojnë të rikorporohen, të fillojnë të marrin formën e drejtë, varësisht se si do të mundemi dhe në çfarë forme do të kemi dëshirë ne të organizohemi për këtë proces. Kështu që, e hapim diskutimin dhe ju përkujtoj edhe një herë, që paraprakisht, me marrjen e fjalës të prezantoheni dhe të folni sa më lehtë për shkak të përkthimit që bëhet këtu.

Pren Marashi: Vetë fakti se nëntë vite, domethënë dhjetë vite pas përfundimit të luftës, duke mos përfshirë këtu edhe luftën në Kroaci e Bosnje, sepse faktet tmerruese që kanë ndodhur atje i dimë të gjithë, përqendrimi kryesor do të mbetet në Kosovë.

Në fillim të debatit e ceka aty kur e bëme prezantimin, se mungesa e bashkëpunimit të qeverisë, unë po them Qeveria në Kosovë edhe pse nuk jam përkrahës i asnjë partie politike, Qeveria e Kosovës ka shprehur një gatishmëri së paku publikisht që të bashkëpunojë me të gjitha komisionet këtu. Por ç'ndodhë me Qeverinë e Serbisë, për shembull në këtë rast? Ne i kemi ende të zhdukurit, se nuk po dua të dal te trajtimi ligjor i kësaj, sepse kjo është mungesë e buxhetit dhe e financave, sepse në Kushtetutë absolutisht nuk figuron as lufta e as viktimat. Do të thotë është mungesë e përpilimit në to dhe është mungesë e shoqërisë civile në përgjithësi në Kosovë që para përpilimit të Kushtetutës së Kosovës nuk e ka ngritur zërin siç është kërkuar prej disa organizatave.

Dua të flas nga përvoja e Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila, që nga viti 1999 respektivisht nga nëntori i vitit 1999 ka pasur një organizim dhe koordinim me të gjithë organizmat relevantë të asaj kohe për vendndodhjen dhe gjetjen e kufomave dhe dhënien, kthimin e kufomave të ushtarëve të ish-Jugosllavisë e tjera. Unë i kam edhe vetë disa dokumente ku kemi bashkëpunuar me KFOR-in e atëhershëm dhe me komisione të ndryshme mirëpo e kam parë se asnjëherë publikisht ky bashkëpunim nuk është dhënë as te qeveritë e shteteve dhe vetëm ka mbetur në mes të KFOR-it dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bashkëpunimi të cilin e kanë bërë që një pjesë e familjeve ta ndiejnë veten më të lirë sepse faktikisht është shumë, të them ashtu, relaksuese për familjen kur dihet varri i një të afërmi të tyre. Domethënë kjo ka ndodhur në 1999. Dhe, pastaj ndodh ky mos koordinim në mes të Qeverisë së Serbisë dhe fshehjes së fakteve. Ju e dini që edhe më tutje gjenden kufoma të fshehura në Serbi. Me këtë rast, duhet përhëndetur posaçërisht Valdeten se e ka marrë një shpërblim që thjeshtë për t'ia ngjirur reputacionin Kosovës. Prandaj, po them, mungon trajtimi institucional dhe qasja institucionale në rend të parë nga institucionet e Serbisë. Presioni kryesor i të gjitha shoqatave dhe mekanizmave nga Kosova duhet të bëhet, po edhe nga Bosnja dhe Kroacia te bashkëpunimi i qeverisë. Ne jemi dëshmitarë të gjithë se sa sot lirshëm kriminelët më të mëdhenj të luftës enden nëpër Serbi. Ne jemi dëshmitarë që ata njerëz, një pjesë e tyre, edhe më tutje e kanë përkrahjen e Qeverisë atje, por mjerisht edhe të UNMIK-ut për nëntë vite sa ka ekzistuar në Kosovë. Dështimi i gjykatave, për çka zoti Bekim Blakaj e ceku, dështimin e gjykatave në Kosovë për mostrajtim. Ju e dini që për nëntë vite, faktikisht sa ka qenë administrata e UNMIK-ut në Kosovë nuk është marrë me luftimin dhe gjetjen e kapjen e kriminelëve serbë, absolutisht. Përqendrimin kryesor e ka pasur te ish-luftëtarët e UÇK-ës, mirëpo kjo ka ndodhur për arsye se mekanizmi – Qeveria e Serbisë e ka pasur mekanizmin dhe e ka pasur mundësinë që të përgatisë dokumente false, dëshmi false dhe ky bashkëpunim ka zgjatur për nëntë vite. Për nëntë vite pra nuk është orientuar kah kapja e kriminelëve të vërtetë, sepse kemi varreza masive, kemi vrasje masive. Nuk përjashtohet mundësia që të ketë ndodhë ndonjë akt individual i ndonjë njeriu – i hakmarrjes personale. Kjo absolutisht është kështu edhe e largon nga përgjegjësia edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nga këto. Ne jemi dëshmitarë edhe për librin e fundit të Karla del Pontes. Ju e dini fare mirë që për ta bërë një transplantim të organit edhe spitalet më të njohura me renome kanë komplikime e lere më këto të bëhen nëpër shtëpi private. Por, fabrikimi i gënjeshtreve që ka dalë nga Qeveria e Serbisë ka gjetur përkrahje te UNMIK-u. Unë për fillim desha t'i them këto fakte, edhe pse Kosova

është e vogël dhe i dimë faktet dhe i njohim njerëzit. Pra, duhet pasur parasysh një fakt – trajtimin ligjor vjen si mungesë e bashkëpunimit të gjykatave dhe Zyrës ligjore të UNMIK-ut për nëntë vite në Kosovë sepse ajo, ju e dini, çdo herë e ka thënë, ka konflikt nuk ka pasur luftë në Kosovë dhe mungesa e trajtimit ligjor nga ana e UNMIK-ut apo zyra ligjore e UNMIK-ut, e këtë publikisht e kemi kundërshtuar këtu, ka bërë që këto viktima, këta njerëz të trajtohen si njerëz të konfliktit e në konflikt mundet njeriu me pas edhe në familje, mundet me pas edhe në fshat mirëpo kur është konflikti i armatosur ka përmasa të gjera dhe ka përmasa edhe trishtuese. Faktikisht në këtë rast ne i kemi 12.000 të vrarë në Kosovë, janë edhe 1.900 ende të zhdukur, i kemi 2.500 dëshmorë të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i kemi invalidët e luftës që edhe më tutje janë të patrajtuar dhe me pjesë të humbura të trupit dhe që për këtë e marrin njëfarë përqindje nënçmuese dhe invalidë e veteranë të luftës, pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës fare nuk kanë trajtim ligjor. Kjo është kështu për shkak të mos zbatueshmërisë së ligjit dhe mospërfshirjes në Kushtetutën e Kosovës. Në momentin kur formohet një shtet, siç është Kosova dhe në Kushtetutën e Kosovës nuk shihet se nga ka ardhur dhe nga erdhën këto ditë që kanë ndodh sot, atëherë faktikisht edhe bie përgjegjësia mbi institucionet.

Kisha apeluar te Fondi për Mbrojtjen e të Drejtave Humanitare këtu që kryesisht, të gjitha këto debate, të gjitha këto, presioni kryesor të mbetet dhe puna kryesore të bëhet nga qeveritë e shteteve. Qeveritë e shteteve janë ato që mund ta obligojnë edhe individin, ligj e obligon individin për bashkëpunim, për koordinim dhe duhet një gjë të zyrtarizohet – gjetja dhe kthimi, rehabilitimi i njerëzve të luftës, viktimave të luftës dhe kjo duhet të bëhet në mënyrë ligjore, në mënyrë institucionale. Ne mund të formojmë me qindra e mijëra shoqata por në qoftë se nuk e ke përkrahjen nga shteti dhe nga ligji faktikisht do të mbetet e porealizueshme. Ju faleminderit të gjithëve!

Veton Mujaj: Faleminderit shumë, zoti Pren! Nuk ka problem! Realisht është më se e domosdoshme për të dëgjuar prej jush këto. Dikush tjetër? Urdhëroni!

Miradije Gashi: Përsëritës këtë takim dhe më vjen mirë që merret si çështje shumë serioze këtu me këto diskutime. Përndryshe, unë vi nga Organizata joqeveritare “Venera” dhe vi nga një lagje këtu e Pejës, nga “Dardania” 1. Unë kam qenë thuaja se gati gjithë kohës këtu në luftë. Më vjen shumë mirë që mu dha rasti të tregoj për disa gjëra. Domethënë këto gjëra i kam zënë disa herë në gojë, por dikush nuk është marrë me këto çështje seriozisht, i ka marrë diçka si kaluese këto. Unë kam qenë bashkë me familje këtu. Në “Dardani” kemi kaluar vetëm katër natë, pastaj kohën tjetër nëpër qytet. Unë për atë kohën sa kam qenë në luftë kam pa një familje, serbe ka qenë, një person që ai u thirrke në shqip, se shumë mirë ajo mëhallë e dinin, se unë një herë mendova se është shqiptar. Në familjen e tij u ndërrofshin disa uniforma, nëpër bodrume dhe ne ata i shihnim se ne aty kemi qëndruar 6 javë. Në atë mëhallën që qëndruam ne gjashtë javë, aty u bënë disa viktima, bile bash një numër i madh i viktimave. Ai personi u sillke andej dhe u merrte me njëfarë aktiviteti. Pos që e di, emrin e tij të vërtetë Boro dhe Bajram i thoshin, më tutje nuk di, por ai i kishte të kyçur edhe fëmijët diku në ushtri dhe djali i tij vinte dhe u ndërronte me ato uniforma aty. Shtëpinë ia di shumë mirë, më gjatë diçka nuk di për të. Ndoshta kishte qenë mirë të dihet, se ai kishte me dit diçka për këto viktima. Unë e pash një person këtu, **Miki Pasha** që dikush e njeh që me gjithë atë grupin në atë kohë u mbyt dhe një ditë përpara ai kontaktoj me të. E dimë se e varrosën por pastaj viktima e tij u gjet diku krejt tjetër, nuk u gjet në këto varreza ku u varros. Ndoshta sikur

të ishte gjetur ai person ose familja e tij kishin mund të tregojnë diçka më gjatë. Kjo ishte që unë mund të flas dhe të ofroj diçka për këtë rast dhe për këto viktime.

Veton Mujaj: Zakonisht, në vende të ndryshme që ekzistojnë komisione të krijuara, i kanë ato departamentet e caktuara ku bëhen edhe dëgjime publike për raste konkrete. Ky është edhe një lloj tentimi që në të ardhmen të jetë pjesë e procesit edhe dëgjimet direkte edhe prej njerëzve të tjerë. Unë them, për me mund me u përqendrua në diskutime në këtë rast kryesisht për shkak se kemi edhe tema tjera në vazhdimësi, kryesisht mbi përkrahjen morale, materiale, çka duhet me përfshi, si mund të ndërlihet zëri i viktimave. Këtë në njëfarë forme ta kemi për momentin si temë të caktuar ku më shumë do të flisim se si e shihni ju pak më shumë për përkrahjen morale, cilat do të jenë ato format ligjore në të cilat do të drejtohem, në çfarë forme ne të organizohemi për tu dëgjuar zëri i viktimave. Nëse kishit mund për këto momente, e pastaj në diskutimet tjera do të flasim edhe për këto gjëra tjera, por nëse mundeni ta koncentroni pak diskutimin në këtë proces kishte me qenë ndoshta shumë e domosdoshme. Urdhëroni!

Lulzim Arapi: Tregova edhe më herët se përfaqësoj një organizatë e cila merret me shëndetin mental, një OJQ. Unë nuk e përmenda pa qëllim si pritje personale nga ky takim se do të doja të jetë një hap sado i vogël drejt paqes. Shpeshherë kur e përmendim paqen e mendojmë vetëm njëherë palë, nganjëherë shumë më tepër ia tregojmë këtë të tjerëve, duke qenë të ndikuar nga faktori politik. Unë personalisht, pra edhe në aspektin profesional shumë më tepër e mendoj nga ana e viktimës. Në mënyrë që të arrihet një këndellje e nevojshme për viktimën pa paqen kjo është e pamundshme. Prandaj, është shumë me rëndësi që të mendojmë për të mirën e personave të cilët i kanë përjetuar pasojat e tmerrshme nga lufta. Mua po më vjen mirë që po marr pjesë për herë të parë për vite me radhë në një takim i cili organizohet shoqëria civile e jo nga asociacionet familjare të personave të zhdukur të cilët shumë e shumë herë kanë qenë të vetmuar dhe unë do të thoja zëri i shterur në ndërgjegjen tonë, në Kosovën tonë, për të drejtat e tyre. Vite e vite me radhë kam dëgjuar për klithjet dhe dhembjet e tyre dhe si ata vërtet ndihen të vetmuar dhe me këtë dhembje dhe të lënë anash jo vetëm nga institucionet qeveritare do të thoja por edhe nga njerëzit të cilët janë përreth tyre. Lufta lë pasojat afatgjata. Mua më vjen keq që institucionet tona qeveritare duket se ia kanë dhënë vetes luksin për një kohë shumë të shpejtë të mendojnë se ne si shoqëri do të jemi në gjendje t'i përballojmë pasojat për një kohë shumë të shkurtër. Kjo ka qenë një lajthitje. Pra, duke u bazuar nga përvojat e popullatave përreth vendit tonë, por edhe me përvojat e popullatave të tjera të cilat kanë përjetuar luftë më herët, mund të dimë se pasojat e luftës janë afatgjata. Kjo ka qenë ndoshta një ndër gabimet më të mëdha të sistemeve të institucioneve qeveritare duke filluar nga ato të edukimit, të shëndetësisë, të mirëqenies sociale e tjera, të cilat sipas mendimit tim nuk ia kanë kushtuar vëmendjen e duhur kësaj problematike. Kur flasim për viktimën, këtu u përmendën më herët disa çështje, të cilat janë të ndërlihdura edhe me drejtësinë, të ndërlihdura me një anë tjetër, ndoshta edhe me pajtimin dhe të cilat j anë të ndërlihdura edhe me këndelljen. Unë nuk do të hyja detajisht apo më tepër rreth drejtësisë sepse nuk e ndjej veten kompetent për këtë lëmi. Mirëpo më pëlqeu kjo që u tha edhe më herët, se drejtësia edhe pse është e dhembshme, nganjëherë ne profesionistët e shtrojmë si pyetje a është megjithatë e nevojshme për viktimat apo jo nga se personi gjatë dëshmisë e tjera i përjeton traumat, pra ritraumatizohet dhe serish ndoshta shumë e shumë probleme ngjallen. Megjithatë, në fund, është konstatuar se sado që e dhembshme

të jetë kalimi nëpër këtë proces, në fund arrihet një formë e lehtësimit, një formë e lirimit nga se personi sado kudo e ka atë ndjenjën se drejtësia megjithatë është vënë në vend.

Prandaj, edhe nga pozita e viktimës, drejtësia është shumë e nevojshme. Nuk do ta minimizoja efektin ligjor, por do ta theksoja efektin e asaj, që ne e quajmë, efekt psikik kur viktimat faktikisht konsideron se ja, më në fund, dikush e shpagoi për dhunën dhe krimin që i është bërë. Drejtësia, në njëfarë mënyre, e ofron edhe mundësinë e përfundimit të dhembjes. Unë kam ditur shpeshherë të them se më duket që personat të cilët kanë qenë të traumatizuar dhe të cilët kanë përjetuar humbje nga ngjarjet e tmerrshme gjatë luftës, më duket mua se ende, sot e kësaj dite, vazhdojnë të jenë në një stres të theksuar dhe të vazhdueshëm dhe, sidomos personat të cilët sot e kësaj dite nuk kanë ndonjë informatë për familjet e tyre. Prandaj, unë them se ata në njëfarë mënyre kërkojnë ndjesë për gjithë ata që janë të pranishëm, jetojnë në një pozitë pezull kur ende pra nuk e kanë mundësinë që së paku të ulen në gjunjë dhe të përshëndeten me personin i cili iu mungon. Më vjen mirë pra, që si pjesë e shoqërisë civile, në njëfarë mënyre, do të thoja, shtrojmë dhe ofrojmë empati dhe mirëkuptim për të gjithë ata që kanë pësuar drejtpërsëdrejti nga lufta dhe unë do të thoja se zëri i shoqërisë civile do të duhej të jetë shumë më i fuqishëm se sa zëri i atyre të cilët kanë përjetuar drejtpërsëdrejti humbjet. Për fat të keq, e kam vërejtur edhe në Bosnje dhe në Kroaci, zëri i shoqërisë civile nuk është gjitha i fuqishëm. Duket thuaja se ne të tjerët, të cilët nuk jemi të prekur drejtpërsëdrejti, disi ia kemi ofruar vetvetes një komoditet duke e harruar që pranë nesh ende dhembja e të tjerëve është shumë – shumë e fuqishme. Pra, le të flasim ndoshta shumë më tepër rreth mënyrave apo propozimeve konkrete të cilat mund ta ndihmojnë që sado kudo të bisedohet. Mund të them se, gjithmonë, kur bisedohet është e pamundshme të mos ketë ndonjë rezultat. Pra, është shumë me rëndësi të diskutohet – të bisedohet për çështjet të cilat si të tilla kanë mbetur të mbyllura për vite me radhë. Nuk e di sa asociacione familjare janë këtu prezent dhe unë do të thoja se ata janë shumë më kompetent se sa cilido nga ne këtu, në mënyrë që ata vetë t'i prezantojnë problemet të cilët ata i ndejnë. Megjithatë zëri i përkrahjes, së paku, i mbështetjes, i mirëkuptimit dhe empatisë nga ana e të gjithë neve nuk do të ishin të panevojshme. Ajo çka do të doja personalisht të sugjeroj dhe të them është se ndoshta këto presionet politike, për të cilat ne po japim kaq shumë theks dhe rëndësi, duket se nuk kanë gjitha efekt. Ndoshta shumë më tepër është mirë të krijohen ura të tilla të ndërsjella në mes vendeve të ndryshme ku ndoshta ekziston presioni i ndërgjegjes morale për të gjitha etnitetet, për të gjithë popullatën. Ndoshta kjo do të jetë shumë më produktive se sa nëse ne presim presione politike ndaj sistemeve të caktuara të vendeve të ndryshme. Dhe, këtë mund ta bëjnë njerëzit. Pra, njerëzit të cilët kanë guxim social, njerëzit të cilët e kanë një përkushtim shpirtëror për bashkëvendësit apo në përgjithësi për të gjitha qeniet njerëzore. Pra, kjo ndoshta do të ishte edhe një propozim i mundshëm që të shikohet se si mund të forcohen këto ura, të cilat ndoshta edhe ekzistojnë, se si mund të forcohen këto ura të ndërsjella në mes vendeve të ndryshme dhe në këtë mënyrë ndoshta të provohet të bëhet diçka më tepër rreth kësaj. Më vonë ndoshta do të bisedoj përgjithësisht për këtë. Më vjen mirë që diçka e tillë po organizohet nga shoqëria civile. Faleminderit!

Veton Mujaj: Faleminderit! Urdhëroni!

Atdhe Berisha: Ju përshëndes të gjithëve, ngrohtësisht! Unë jam Atdhe Berisha, i regionit të Pejës, prezantohem sot me OJQ “Kalaja”. Nuk e kam vështirë kur bisedoj në jetën normale dhe kur komunikoj me tjerët. Kësaj radhe ndihem pak më ndryshe. Arsyeya

është shumë e thjeshtë. Më është hera e parë që pas dhjetë viteve në një asociacion të tillë kam mundësi të bisedoj për një temë e cila direkt më ka prekur mua dhe familjen time. Deri tash fatkeqësisht nuk më është ardhur rasti, do të kam emocione dhe nuk do të mund të jam shumë i zgjatur. Problemi kryesor është anashkalimi nga institucionet kosovare, pa i përmend ato ndërkombëtare për të cilat ndoshta edhe nuk është pritur apo pse presioni ka qenë i tillë. Neve pse nuk kemi marrë diçka? Në asnjë mënyrë nuk kisha dashtë të bëj kategorizim të atyre që kanë rënë gjatë luftës, por në mesin e tyre unë e kisha shpëputur një kategori të njerëzve siç ka qenë edhe prindi im dhe i shumë të tjerëve. Ka punuar përreth diku 40 vite në arsim dhe asnjëherë në Kosovën e pasluftës nuk është gjetur një moment që të komunikohet me familjen tonë apo të ketë një kontakt në këtë drejtim. Ka vazhduar më tutje herën e fundit kur u bë një prezantim në Prishtinë, e ndjeva veten tej mase keq kur as aty nuk na kishin ftuar. Arsyesimi ishte prej drejtoratit rajonal të arsimit këtu në Pejë se sindikata i ka dërguar dokumentacionet dhe ne s'paskemi qenë të regjistruar në sindikatë. Do me thënë një fatkeqësi e radhës. Pak më herët, me kryqin e kuq komunal në Pejë pata marrë një iniciativë që edhe arsimtarët të cilët janë vra gjatë luftës të shënohen dhe të botohet një libër për arsye se kishte me i shërbyer të së vërtetës. Dhe, iu drejtova shumë drejtorateve rajonale, në nivel të Kosovës, fatkeqësisht në Gjakovë gjeta mirëkuptim dhe gjeta një libër të botuar, kurse në komunat tjera nuk i kishin listat fare. Pyeta veten thash, a është e mundur kjo që institucionet arsimore, shtylla kryesore e vendit, të mos ketë shënime për arsimtarët që iu kanë vra gjatë luftës. Thash a thua, a kishte qenë më mirë që këto dokumentacione të jenë komplet. Po edhe u diskutua për Kosovën në instanca të ndryshme gjatë zgjidhjes së statusit të Kosovës, fatbardhësisht tash veç u krye. A nuk kishte qenë mirë që edhe Kosova të prezantojë, se u thuke se ushtarët e UÇK-ës paska kanë bërë krime mbi ushtrinë dhe mbi popullatën serbe, a mos kishte qenë një demant shumë i madh kur ishte prezantuar edhe një numër aq i madh i arsimtarëve të vranë në Kosovë? E pse u vranë? Ndoshta pse ishin shqiptarë por ndoshta edhe pse ishin në krye të arsimit për shumë vite. Kjo nuk ndodhi asnjëherë. Do të thotë, në tryezën e bisedimeve kishte qenë shumë më e relaksuar ekipi shqiptar sikur të kishte prezantuar një listë me emrat dhe mbiemrat e atyre që u vranë gjatë luftës dhe me këtë do ta kishte fuqizuar edhe më tepër rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe do ta kishte bërë një shtytje edhe më të madhe në këtë drejtim. Duke mos dashur të ju marrë kohë më tutje, ju përshëndes edhe një herë ngrohtësisht.

Veton Mujaj: Faleminderit! Dhe, ju Elbert?

Elbert Krasniqi: Elbert Krasniqi prej Këshillit Rinor Pejan. Unë do të mundohem të fokusohem në një koment lidhur me iniciativën të cilën shumë e përshëndes dhe mendoj se ka qenë koha e duhur që shoqëria civile të fokusohet në këtë drejtim. Gjithë ne jemi dëshmitarë që pas konflikteve në ish-Jugosllavi edhe në Kosovë ka shumë shtrembërime të fakteve dhe të vërtetës. Dhe, Kosova, posaçërisht në këtë proces, që e përmendet edhe ju, është shumë mbrapa në krahasim me Bosnjën dhe Kroacinë pa dashur ta përmend edhe Serbinë në këtë fjalim. Unë mendoj se ka shumë modele që mundemi të bazohemi për të organizuar dëgjime publike në nivel nacional. Dëgjimet publike në nivel nacional mendoj se janë njëra ndër zgjidhjet për mbledhjen e fakteve dhe ato fakte të procedohen në vende në të cilat duhet të adresohen. Në Afrikën e Jugut, që janë organizuar komisionet për të vërtetën, domethënë kanë pasur sukses. Edhe në rast se shoqëria civile mund të ndikojë te institucionet përgjegjëse të qeverisë të fokusohen më shumë në këtë drejtim dhe jo vetëm me një mbështetje morale por edhe të mundohen t'i dalin në ndihmë

këtyre familjareve dhe vetë shoqëritë civile të organizohen në komisione për të vërtetën dhe mbledhjen e fakteve. Pra, patjetër duhet me u përkthyer në mentalitetin tonë që të ndryshojë mentaliteti ynë prej Afrikës së Jugut. Faleminderit!

Veton Mujaj: A ka dikush ndonjë përgjigje? Bekim, mos ke ti përgjigje për këtë?

Bekim Blakaj: Në fakt, unë dua me iu falënderuar të gjithë këtyre që e morën fjalën, duke filluar prej zotëri Marashit, Arapit, Berisha dhe Krasniqi, zonjës po ashtu. Zonja e përmendi një rast konkret që ka ndodhur në lagjen “Dardania”. Kjo është ndoshta jashtë teme që po dua të flas, por ndoshta ka të bëjë edhe për zotëri Krasniqin. Unë, që në fillim e përmenda se organizata jonë është duke u marrë me mbledhjen e fakteve për krime të luftës që një kohë të gjatë dhe i kemi identifikuar, besojmë diku mbi 90% të rënëve, të vrarëve dhe të zhdukurve dhe në këtë vit, faktikisht para dy muajve kemi filluar me prezantimin publik të këtyre hulumtimeve që i kemi bërë. Këtë e kemi bërë në dy komuna deri tani dhe besoj se diku kah shtatori do ta mbajmë edhe në Pejë dhe shfrytëzoj rastin që të gjithë të interesuarit edhe pse ne do ta bëjmë një kampanjë paraprakisht le të marrin pjesë dhe t’i shohin ato të dhëna që i kemi ne dhe gjithsesi ju kishim lutur nëse keni të dhëna shtesë, të reja, do të ishin të mirëseardhura për ne. Domethënë, këtu desha të ndërhyj. Ideja është, sikur e përmendi zotëri Berisha dhe ka shumë të drejtë. Unë sa e di, Universiteti i Prishtinës e ka bërë një botim për të vrarët e të zhdukurit, studentë dhe profesorë të fakulteteve. Mirëpo jo edhe stafi arsimor në shkolla të mesme dhe fillore. Ne e kemi ndërmend që diku kah fundi i vitit të ardhshëm ta publikojmë atë libër, ku shpresoj se për secilin që është vrarë ose zhdukur do të ketë të dhëna edhe personale edhe rrethana në të cilat është vrarë ose është zhdukur dhe sigurisht në raste kur ka dëshmi dhe kush është kryerës i veprës, pse jo, me bërë atë publike. Pse po e bëjmë këtë? Së pari, për mos të mohohet. Ne ende, këtë e përmendi edhe zotëri Marashi Qeverinë e Serbisë, e cila lende i mohon viktimat shqiptare dhe ajo është një dhembje shumë e madhe edhe për familje por edhe për ne si shoqëri. Pastaj, për ta ndërprerë kalkulimin ose, si të them, të numrave. Në fund të fundit, të vrarët dhe të zhdukurit nuk janë numra, nuk janë as lista. Ata janë qenie njerëzore që sot e atë ditë i mungojnë dikujt, dikush ndjen dhembje për ta. Prandaj, ideja e publikimit të atij libri është që ata të mos harrohen kurrë. Sepse, në rast se i harrojmë, shumë ka rrezik të përsëritet. Më falni që isha pak më i gjatë. Zonja, po më duket po e kërkon fjalën.

Sabrije Zeqaj: Së pari përshëndes mysafirin nga Bosnja dhe ju përshëndes për këtë iniciativë. Unë jam Sabrije Zeqaj. Gjatë luftës e kam përjetuar një ankth dyvjeçar, kam qenë në shtëpinë time, në fshatin Strelc i Ulët. Kam pa çdo gjë, që as truri nuk do të mund ta përshkruaj atë që e kam përjetuar, por më prekëse është ajo që i kam parë femrat e reja duke u strehuar nga fshatra tjera, të cilat kanë qenë të dhunuara e ku të di unë. Por, nuk do të hy në metalizim. Një mua më intereson se sa jemi ne në gjendje të bëjmë për personat me aftësi të kufizuara të cilët dihen se në komunën e Deçanit kanë qenë, do të thotë, motër e vëlla, apo dy vëllezër e një motër dhe pikërisht ata janë zhdukur dhe s’kanë lënë askë si pasardhës pas veti dhe institucionet tona çka do të bëjnë për ata persona dhe për persona tjerë me aftësi të kufizuara që kanë qenë këso raste po edhe më të rënda, ku për shembull e ka marrë djali 23 – 24 vjeç nënën në shpinë dhe polici paramilitar, që e kam pa me sy sepse edhe unë e kam pasur një torturë të madhe duke shkuar që ma kanë marrë kerrin, më kanë rrahë me nënën, më kanë zbritur në breg të rrugës, aty kam mbet deri sa janë ardhur do të Raushiqit dhe më kanë marrë e më kanë çua për Shqipëri. Desha vetëm të bëj një pyetje se sa jemi ne në gjendje dhe sa mundemi

të bëjmë për ata persona që s'kanë kush të përkujdeset për ta dhe sa është Këshilli për persona të zhdukur në gjendje që të verifikojë të dhënat që vijnë për ata persona, duke e lënë edhe këtë verifikimin nga ADN-ja. Unë kam rastin konkret, një djalë i axhës, tash ndoshta edhe është keq me përmend atë, i kanë jap familja e tij 70.000 markë në atë kohë dhe e kanë varrosur, e kanë prurë me një arkivol të metaltë, është varrosur me të gjitha ato ceremonitë nga luftëtarët nga ana, do të thotë, e pjesëmarrësve që i ka pasur shokë të vet të luftës. Mirëpo, pas 3 vjet, në zyrën time ka ardhur një person tjetër, një Binak Selmanaj, nga komuna e Deçanit i cili më ka shkruar krejt një pasqyre tjetër, ku ai person është mbytur në lokacionin tjetër dhe kur është ngrehë zhagas, do të thotë nëpër shkallë të autobusit është gjuajt te Kurshumlia diku, në breg të rrugës, ndërsa trupin e tij familja e mixhës tim e kanë marrë prej Somborit, e kanë prurë një arkivol të metaltë dhe unë nuk mundem me ditë këtë dhe tash më është një brengë sepse kurrë nuk e kam thënë por sot po e them për herë të parë këtu se a është ai person në atë arkivol të metaltë edhe pse ata i kanë paguar ato mjete aq të mëdha, edhe pse është varrosur ai, e ka një emër, a jemi ne ata dhe a duhet të jenë kompetentë dikush që të përgjigjet se a janë ata persona që po i marrim ne apo ata që rrinë nëpër murge të ndryshme e që s'mund të bëhet ADN-ëja dhe mos janë kontra të përziera këto punë. Kaq pata.

Bekim Blakaj: Zonjë faleminderit shumë! Mendoj, për fat të keq, pak jemi dal prej teme, mirëpo megjithatë po e marr një minutë kohë dhe po përpiqem të jap përgjigje.

Në fakt, kompetentë për identifikimin e mbetjeve mortore është Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur dhe të vetmin laborator që e kanë në krejt rajonin e kanë në Tuzlla. Çështja është se aty, ku hapen varrezat merret një mostër e eshtrave të mbetjeve mortore, ndërsa nga familjaret, ekipet e tyre në terren kanë mbledh mostrat e gjakut.

Çështja është se, kur dërgohen ato në Tuzlla, nuk dërgohen me emra të familjeve, por me kode. Kështu që, ata që i bëjnë analizat – ekspertët në Tuzlla nuk e kanë idenë prej nga vjen mostra e gjakut. Unë e kam një bindje, sepse bashkëpunojmë me ta, nëse del pozitive mostra e gjakut me mostrën e ashtit probabiliteti është mbi 99% i saktë. Për fat të keq, për fat të keq, sepse merremi me këtë punë, bashkëpunojmë me zyrën për persona të zhdukur me Komitetin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe ka pas edhe identifikime, të them, të pasakta mirëpo ato janë bërë në mënyrë tradicionale, në bazë të rrobave, në bazë të gjësendeve që janë gjetur dhe për fat të keq, kam frikë, se tani në Prishtinë, në murgun e Prishtinës janë diku rreth 400 mbetje mortore të cilat nuk po dalin pozitive. Një shpjegim, të cilin e kam marrë unë prej tyre, është se ndoshta aty kah fundi i vitit 1999 dhe fillimi i vitit 2000 janë bërë eshumime të varrezave pa analiza të ADN-ës dhe për fat të keq u është dhënë trupi i gabuar. Mirëpo, po them, kemi dal prej teme e ndoshta kur na vjen rasti për këtë do të diskutojmë.

Veton Mujaj: Edhe një herë, pak me tentua për tu kthyer në temë, u përmenden disa vende që kanë mund me qenë më shumë pjesëmarrës ndërsa prej familjeve të viktimave mirëpo fillimisht duke mos ditur edhe ambientin dhe përgjithësisht dëshirat e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në këtë proces ne kemi menduar se fillimisht ose në hapa të parë të fillohet me shumë organizata të shoqërisë civile që në këtë rast në njëfarë forme të ndryshme na ndihmojnë veteranët e luftës në këtë proces dhe po thuaj si panelistë për me i orientuar pak edhe organizatat tjera të shoqërisë civile që në njëfarë forme nuk janë marrë me këtë proces deri më tani dhe ideja është që së bashku kemi diskutuar edhe me anëtarët e iniciativës që të ketë edhe takime tjera të vazhdueshme por me specifika të veçanta, jo kryekëput pra vetëm shoqëria civile, por shoqëria civile dhe ata të interesuarit

që janë prej shoqërisë civile, së bashku edhe me familjarët e viktimave të tentojmë që gradualisht të përfshijmë çdo njeri që shihet se ka interesim dhe mundësi për të qenë i kyçur në këtë proces. Prandaj, për këtë kemi edhe disa minuta kohë që të diskutojmë këtë temën për përkrahjen morale, të drejtës ligjore dhe zërin e viktimave qysh kishim mund ta ndërlihim. Kemi edhe një pjesë të kohës. Tani e ka fjalën Valdetja, pastaj tjerët.

Valdete Idrizi: Unë do të flas vetëm një minutë. Desha me i nënvizuar edhe një herë disa prej çështjeve që ju zotëri veç i sjellët këtu në tryezë dhe këto i kam paraparë edhe në prezantime. Do të thotë prezantimi im do të koncentrohet më shumë se çka ka ndodhur deri tash në këtë proces të konsultimeve qysh atëherë kur ka nisë kjo ide dhe ballafaqimet me të kaluarën, më konkret. Dhe, njëkohësisht edhe Elberti përmendi diçka rreth dëgjimeve publike në nivel nacional, domethënë në nivel të regjionit dhe krejt, veç desha mos të mbetem borxh, të ju tregoj se do të kthehem prapë në sesionin e ardhshëm dhe konkretisht do t'i ndaj me ju këto shqetësime që i kanë pasur edhe pjesëmarrësit tjerë për disa prej konsultimeve edhe këtu në Kosovë por edhe në rajon. Faleminderit!

Pren Marashi: Desha të dal pak edhe te zoti Lulzim. Qëllimi dhe mostrajtimi është edhe një mungesë e traumave. Trajtimi dhe mostrajtimi i këtyre viktimave, do të thotë, e kam fjalën tash edhe te të mbijetuarit sepse edhe i mbijetuari është viktimë, mostrajtimi adekuat edhe në baza psikiatrike, nervore, ligjore, mjekësore. Ju e dini që pas çdo lufte në botë, tash nuk po përzihem në profesionin e tij, ekzistojnë ato trauma të luftës të cilat mund të kenë pasoja edhe në të ardhmen edhe në shoqërinë e tashme kur nuk jemi në gjendje lufte, pra edhe pas konsolidimit të shtetit. Absolutisht, mesa kam njohuri, disa organizata joqeveritare merren me këto çështje, mirëpo si institucion ende nuk është marrë askush me trajtimin e personave, flas konkretisht, për femrat e dhunuara, te veteranët e luftës, te njerëzit me pasoja. Sindromi i luftës, dhe të mos them sindromi i Vietnamit, por po e bëjmë sindromi i Bosnjës, mos të preket Salem Çorbo, por lufta si luftë i ka pasojat dhe traumat e veta. Në këtë rast, te ne, absolutisht askush nuk merret me këtë. Ka raste individuale kur njerëzit duhet të shkojnë të shërohen dhe për këtë janë shpenzimet e mëdha. Ju e dini tash edhe Ministria e Shëndetësisë i ka nis do ligje tjera, që ka me i kushtuar dhe nëse nuk gjendet një garantues që ka me i paguar shpenzimet... Të gjitha pra këto janë shqetësime dhe ne mundemi me dal te rastet individuale tërë ditën, sepse kjo nuk ka fund, thash janë me mijëra të vrarë dhe menjëherë të zhdukur. Por qasja, problemi i qasjes, prapë po lidhem, institucional mungon. Tani e dhjetë vite mungon. Kjo është edhe mangësi e organizatave joqeveritare. Ne kemi dëshmitarë se janë formuar organizata joqeveritare që kryesisht dhe prioritet e kanë pasur ndonjë përfitim material apo diçka tjetër. Mirëpo, për me u qas te problemet që janë jetike, jetësore, që kanë lënë edhe pasoja në shoqëri, që munden me pas pasoja edhe në të ardhmen. Është problem, për shembull një pajtim, ose propozim për pajtim, kurse njerëzit thonë çka do të ndodhë sepse pa u ulë një herë në odë të burrave herdokurë s'ke qare. Mirëpo, nëse unë vetveten e distancoj nga një faj e kur tërë bota e din që jam fajtor, atëherë është i vështirë edhe pajtimi. Në këtë rast ne kemi cekur disa herë, nuk mundet me pas përgjegjësi kolektive në luftë. Në luftën e fundit në Kosovë përgjegjësia ka qenë kolektive nga institucioni serb. Domethënë shteti ka bërë krim, jo individët. Me urdhër të shtetit janë bërë krimet. Me urdhër të strukturave komanduese. Ju e dini fort mirë se një organizim ushtarak nuk guxon me dal nga vija ushtarake. Këtu ka ekzistuar një komandë, një strukturë. Këtu janë bërë krimet në mënyrë të organizuar dhe janë fshehur krimet. Do të thotë, përgjegjësia ka qenë kolektive. E tash, në këtë rast, kur themi ne kolektive, nuk themi kolektive se edhe

ndonjë banor për shembull ka qenë i pafajshëm. Mirëpo, struktura komanduese dhe komplet klika komanduese ka qenë e kyçur në krime dhe në masakra. Te ne në Kosovë, për hir të raporteve, për hir të servilitetit duhet të them, ndaj faktorit ndërkombëtar, anashkalohet ajo. Jo, ne duhet të jemi të gjithë të qartë. Krimin duhet ta orientojmë dhe të themi Pren Marashi ka bërë krim dhe Pren Marashi duhet të dënohet. Në këtë rast në Kosovë kjo mungon për arsye se janë interesat që janë edhe më të larta, do të thotë te servilizmi politik që disa herë ka shkuar edhe në dëm të statusit të Kosovës. Kjo është edhe ajo që e ka zvarritur për dhjetë vite statusin e Kosovës e mos të flasim tash për maltretimin që e kanë pasur familjet e të pagjeturve, lojërat që janë bërë duke manipuluar se janë gjallë e keqpërdorime tjera. Të gjitha këto janë dëshmi, po edhe më tutje ndodhin, edhe më tutje flitet, edhe më tutje nga ana serbe vjen se në kampet e UÇK-ës ka të burgosur serbë, ka kufoma të fshehta. Absolutisht, absolutisht është e pa vërtetë. Mirëpo, mënyra e qasjes së medieeve dhe mënyra e manipulimit nga ana e institucioneve bën që njerëzit ta nxisin dyshimin. E pse nxitet dyshimi, sepse i afërmi i atij familjari shpreson dhe nëse ndien një lajm, po – qenka gjallë, paska kanë. Kjo është ajo. Unë kam pas qejf pak me ndie edhe zotin Salem Çorbo dhe ky me na fol pak lidhur me përvojat e tyre sepse ne e dimë që një ligj është miratuar në Kroaci, i cili është shumë i zbatueshëm edhe për viktima, edhe për veteranë të luftës dhe për të gjitha. Edhe në Bosnje, edhe pse është struktura pak më e përzier, sepse atje janë tri komunitete dhe është pak më problem, është e ndarë si lëkura e leopardit por një përvojë e kanë dhe sigurisht e kanë më të gjatë dhe numri i të vrarëve dhe qasja është shumë më e madhe, po ju tregoj, shumë më e madhe krahasuar me Kosovën, për fat të mirë se ne kemi pas më pak, por përvojat është mirë t'i dëgjojmë edhe prej zotit Çorbo. Kryesuesi: Po, realisht do të jetë pjesë kjo në vazhdimësi. Mirëpo, nëse ka diçka me shtuar për momentin në raport me temën ose do ta lësh në vazhdimësi.

Salem Çorbo: Jam nga Bosnja dhe Hercegovina. Më duket se janë bërë shumë pyetje, madje mjaft të hollësishme rreth asaj se si të tjerët i kanë zgjidhur këto probleme kyçe të popullatës. Unë këtë e kisha lënë për këtë pjesën tjetër të diskutimit, ndonëse pjesa që kam parashikuar unë dhe që është parashikuar ka të bëjë me të se çka do të bëjë Komisioni në nivelin rajonal. Mirëpo, do t'i them disa fjalë rreth asaj se në Bosnje e Hercegovinë natyrisht është përjetuar një kataklizëm, një shkatërrim tektonik që ka ndodhur në Ballkan nga viti 1991. Ne e dimë se ka nisur nga Sllovenia, pastaj në Kroaci me intensitet më të madh dhe ka kulmuar në Bosnje e Hercegovinë dhe finalja ka qenë këtu në Kosovë në vitin 1999. Në Bosnje e Hercegovinë deri më tani kemi numër, për fat të keq, mbi 100.000 të vrarë. Në Bosnje e Hercegovinë janë mbi 13.000 të zhdukur dhe nuk e dimë fatin e tyre. 2.500.000 janë të përndjekur. 1 milionë veta ende presin për t'u kthyer në Bosnje e Hercegovinë dhe kjo paraqet, për shtete shumë të mëdha dhe më të fuqishme, me kapacitete më të mëdha, një sfidë shumë të madhe. Për fat të keq këto janë vetëm shifra dhe unë shoh që edhe këtu janë kryesisht njerëzit që i përkasin këtij grupi dhe që bashkëpunojnë me grupe dhe bëjnë një punë që është më humane në botë dhe kjo ka të bëjë me ndihmesën dhe gjurmimin për të vrarët dhe është një punë pra më humane që e bëjmë në Ballkan dhe është mënyra më e mirë për këndellje dhe shërim të shoqërisë dhe mendoj se nëse nuk i shërojmë këto plagë, nëse nuk e dimë të vërtetën e dhembshme, vështirë se do të mund të komunikojmë me njëri-tjetrin si partnerë dhe fqinjë, si komshi në rajon. Ligjet në Bosnje e Hercegovinë i kanë kushtuar një vëmendje të caktuar kësaj çështjeje por për fat të keq, në praktikë nuk është ashtu. Vërtet ne kemi politikanë të tillë

që thonë se janë ligjet e mira mirëpo çfarë do të jenë ligjet varet nga ajo se si do të aplikohen sepse ne kemi ligje të mira dhe aplikohen në një pjesë që janë të ndarë në dy entitete dhe kanë të drejtë të reparacionit sipas shtatë bazave. Mirëpo, më duhet të them se ligji i Republikës Serbe është ai që e ka nënshkruar Radovan Karaxhiqi dhe kanë pasuar katër ndryshime në Bosnje dhe absolutisht nuk u mundëson pjesëtarëve të dy popujve të tjerë që ta rregullojnë statusin e tyre dhe i parashikon të drejtat vetëm për një popullatë. Në atë kohë ka qenë territor i spastruar, është quajtur Republika Serbe. Në Federatë është diçka ndryshe dhe është konstatim i përgjithshëm që Qeveria e Bosnjës ndanë për popullatën e pjesëtarëve të luftës dhe paraqesin një përqindje të madhe ndërkaq më shumë ndahen për viktimat civile të luftës. Ligji, megjithatë, është nxjerrë por nuk është i aplikueshëm. Nuk ka fond që do të siguronte aplikimin. Pra, kemi të bëjmë me një ligj për reparacione. Unë mund të them edhe shumëçka por kjo tash për tash do të ishte një përgjigje për zotin Marsh. Sa i përket REKOM-it, përkatësisht KOMRA-s jeni në rrugë të mirë. Dikush ka bërë ndonjë hap më të madh, dikush më pak, por do të ishte shumë mirë ta shohim atë rrugë përkatësisht se çka dëshirojmë me këtë komision. Pse unë besoj në të? Unë nuk u besoj politikanëve sepse ata në këtë temë punojnë dhe i vënë nën tepih, merren me viktimat dhe krime vetëm në situata të caktuara dhe thonë se viktimat janë tonat, ndërsa kriminelët në anën tjetër. Komuniteti ndërkombëtar pak a shumë është lodhur me këtë punë e këtë e shihni edhe ju vetë. OJQ-ët dhe shoqëria civile janë të pafuqishme dhe këtë e dëgjova edhe këtu dhe kjo paraqet atë pozitën e pjesës civile. Pra, gjyqësia, për çka nuk dëgjuam sa duhet, është e pafuqishme në këtë proces. Vetëm në Bosnje janë evidentuar mbi 25.000 dhunime dhe mbi 100.000 të vrarë, 13.000 pra të zhdukur dhe çfarë kapacitetesh të gjyqësisë do të mund të tentojnë t'i përgjigjen këtyre pyetjeve. Sikur dihet, ne në vitin 2003 kemi themeluar prokurorinë dhe gjykatën shtetërore. Mbi 120 aktgjykime të paraqitura dhe ju e dini se Tribunali i Hagës sa vendime merr për një kohë të caktuar. Politika nuk është e interesuar dhe është gjithnjë e më larg kësaj teme. Dhe, çka mbetet? Mbetet të bëhet një presion i madh ndaj pushtetit, një presion i sektorit joqeveritar, t'i bashkojmë forcat që në këtë proces të hyrjes në Evropë, të tentojmë që në një mënyrë siç është bërë në 36 vende të përcaktohet suaza ligjore, që do të thotë të kemi mundësi të hyjmë nëpër arkiva, në dosje, të hulumtojmë për të vërtetën dhe në një mënyrë, të them, të shkallës së lartë civilizuese pas tri vitesh të fillojmë të marrim një përgjigje në pyetjen që secili prej nesh e bartë në vete. Unë kaq për këtë pjesë, por jam i gatshëm edhe të përgjigjem në disa pyetje që ishin mjaft precize dhe shpresoj tash për tash që e kam dhënë një përgjigje, kurse për tjerat, me një rast tjetër.

Veton Mujaj: Ne do të vazhdojmë në këtë temë edhe pak për shkak se na kanë mbetur edhe shumë pak minuta, e kemi edhe një bashkëbiseduese dhe pastaj, sigurisht edhe zotëri Çorbo, do të vazhdojë në atë pjesën ku ai mund të jetë folës dhe do të ketë pastaj më shumë mundësi për pyetje.

Ilirijana Hoti: Nga Shoqata Medika në Gjakovë. Të ndërlidhem me shokun Pren Marashi, kur e ceku çështjen e një shtrese të një kategorie, të viktimave të luftës – për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale apo çfarëdo dhune në Kosovë.

Me rastin e aprovimit të Ligjit mbi viktimat civile, kemi qenë shumë të dëshpëruar kur nuk ka qenë e paraparë kjo kategori e personave dhe jemi të vetëdijshëm se të gjithë ne jemi dëshmitarë se këto ngjarje kanë ndodhur. Sipas statistikave që janë bërë nga ana e shoqatave apo personave, në fillim kur janë marrë të dhënat, është numër shumë i madh. Fatmirësisht, them “fatmirësisht” në thonjëza përderisa në Bosnje kanë qenë publike,

sepse iu ka imponuar edhe atyre, te ne nuk ka ekzistuar ajo mundësi. Kemi kërkuar përkrahje të UNIFEM, kemi mbajtur një tryezë në zyre të Ombudspersonit kur jemi munduar në bazë të përvojës nga Shoqata simotër në Zenicë Medika Zenica kemi paraparë amendament, do të thotë, që të bëhet plotësimi i ligjit ku do të parashihej një dispozitë që të kenë mundësi edhe kjo kategori apo këto viktime herë do kurdo në të ardhmen, ndoshta jo sot, të kemi fakte dhe të kërkohet njëfarë dëmshpërblimi apo të njihen e përkrahen moralisht. Mirëpo, deri më sot nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ana e institucioneve tona, edhe pse kanë qenë prezent edhe gratë deputete në këtë tubim. Kaq pata. Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, shkurt të lutem, se do ta përfundojmë këtë pjesë.

Lale Grabanica: Jam Lale Grabanica, “Elena Gjika” prej Kline. Vërtet është për t’u përhëndetur një nismë e tillë, duke pasur parasysh dhe natyrisht gjithnjë duke menduar se edhe formimi i këtij komisioni, dhashtë zoti të mos jetë nën hije si shumë komisione tjera. U thanë këtu shumë kritika, normal se përkrahja dhe mungesa prej qeverisë, ekziston. Mirëpo, prej të gjitha atyre, unë e kisha thënë edhe një se edhe ne si shoqëri dhe si popullatë na ka munguar një vetëdije dhe një edukatë në tërësi, në dhënien e dëshmimeve, në delegimin e padive dhe më duket kjo sikur ne të kishim frikë ende ne. Më kujtohet shumë mirë, para 3-4 viteve kemi punuar shumë në këtë drejtim edhe me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, që kemi këtu edhe bashkëpunëtore, që i kemi iniciuar, pikërisht dhe nuk do të thotë se duhet cekur vetëm ata që kanë qenë drejtpërdrejt të prekur nga ajo, kemi insistuar për të shkuar me dhënë padi, me bërë akuza pranë gjykatave dhe fatkeqësisht ne kishim qenë të vonuar. Se çka na ka penguar në atë drejtim, unë nuk e kam të qartë. Unë kujtoj se këtu është mungesë e një vullneti, apo ka qenë mungesa e vullnetit të mirë. Duke pasur parasysh dhe dhashtë zoti se formimi i këtij komisioni do të ketë një punë të mbarë dhe të mos ndalemi dhe të mos hezitojmë. Nuk mundemi me thënë, është fajtor ai, është fajtor ky. Këtu u përmend edhe Qeveria e Serbisë! Ai që ka vra, ai nuk pret, me t’i dhënë dëshmitë. Ai me pas dashtë nuk e kishte vrarë askend. Sot e kësaj dite e kemi edhe numrin, më tepër kemi padi nënë gjykata si viktime, se sa ata që e kanë bërë luftën. Ju jeni dëshmitarë i tërë këtyre. Do të thotë unë kisha insistuar më tepër në ngritjen e vetëdijes dhe për mos hezitim. Ndoshta do të flasim për këtë temë më thellësisht, po ishalla dhe dhashtë zoti ky komision të mos jetë si komisionet tjera vetëm ad-hoc dhe kinse jemi duke bërë diçka.

Veton Mujaj: Faleminderit, Lale! Kisha pas dëshirë të njoftoj, se në ndërkohë kanë ardhur disa persona dhe ata do të ishte mirë të prezantohen. Prandaj, ju lus juve që keni ardhur më vonë, të prezantoheni.

Gjylfidane Morina: Gjylfidane Morina, Shoqata “Ne jemi pjesë e botës” Pejë.

Ardiana Begolli: Ardiana Begolli, Shoqata e invalidëve të luftës Pejë.

Veton Mujaj: OK. Faleminderit! Para se të shkojmë në pauzë për kafe unë shkurtimisht desha të përmbledh një formë se tipet e komisioneve të ndryshme janë krijuar nëpër të gjithë botën që nga viti 1975, varësisht prej luftërave, konflikteve, rrjedhave që kanë qenë nëpër hapësira të ndryshme, sikur është Amerika Latine, Afrika dhe pjesë tjera të botës.

Kryesisht komisionet të cilat krijohen janë komisione jo gjyqësore, të cilat dalin nga nevojat e viktimave, nga nevojat e familjarëve për të ditë të vërtetën për atë proces. Domethënë kryesisht këto janë pjesë që në njëfarë forme e plotësojnë ligjin, e plotësojnë shtetin, e plotësojnë nevojën. Zakonisht, komisionet nëpër botë, kur janë krijuar asnjëra prej tjetrës nuk është e njëjtë. Disa thirren vetëm komisione të vërtetës, mirëpo në vende të ndryshme kanë emra të tjerë. Do të thotë varësisht prej mandatit që do tu përcaktohet

dhe prej vetë pjesëmarrjes së familjeve dhe gjitha shoqërive civile ose të gjithë aktorëve që mund të dhënë ndihmë në këtë proces. Mund të përmendi se qysh bëhen diku, zakonisht këto komisione në njëfarë forme akreditohej prej qeverive, do të thotë prej institucioneve. Kemi raste të veçanta, sikur janë për shembull Afrika dhe Amerika Latine kryesisht janë të bëra prej presidentëve. Presidenti e dekreton ose e formon komisionin me përmbledhje të të gjithë aktorëve. Për shembull e kemi rastin kur është krijuar me presidencë, në Ugandë, Bolivi, Argjentinë, Zimbabve, Çile, Çad, Shrilankë, Haiti, Nigeri, Peru. Në të gjitha këto shtete presidenti e ka krijuar komisionin. Ka raste të caktuara kur tentativa për të krijuar komisione jepen edhe prej grupeve të armatosura, ka edhe raste kur ndonjë ministri tenton ta krijojë komisionin, ose në raste të caktuara edhe qeveri. Mirëpo, fryma më e fuqishme ose më ndërlidhëse që shihet se ndihmon dhe ka kontribuar në këtë proces kanë qenë komisionet e krijuara prej parlamenteve. Do të thotë menjëherë parlamenti ka përcaktuar se kush duhet të jetë pjesë e këtyre proceseve. Ka edhe raste të caktuara, sikur në Timorin Lindor, për shembull, kur komisioni është iniciuar prej Kombeve të Bashkuara. Duhet të theksojmë se komisionet ndryshojnë, ndryshojnë për nga përmbajtja e tyre, ndryshojnë edhe për nga regjioni ku i përkasin. Ka komisione që janë të ndërtuara brenda për brenda shteteve. Ka komisione që ndërtohen pas konflikteve ose luftërave në mes dy shteteve. Do të thotë komisionet e tilla janë të ndryshme për secilin vend dhe secilën specifikë. Për këtë kudo në botë parashihet pjesëmarrja më e madhe e njerëzve që vetë ata, do të thotë viktimat e luftës, dëshmorët dhe të tjerët, të përcaktojnë rrugën se çfarë forme duhet të marrë komisioni dhe pastaj gradualisht, së bashku me institucionet të krijojnë hapa të vazhdueshëm se çfarë mandati do të ketë ky komision, a do të merret komisioni vetëm për të zhdukurit, a do të merret komisioni për viktimat, për torturën, për çdo gjë çka e përfshin. Rezultativisht nëpër botë, efikasitet më të madh kanë pasur komisionet të cilat me përmbajtjen e vet kanë qenë shumë më të thjeshtësuara ose me tema pak më specifike, për shkak se kanë ardhur pak më shpejt deri te zgjidhja e problemeve. Ndërsa, në ato vende ku tema është lënë e hapur, ku janë përfshirë të gjitha temat sikur që u përmendën më herët, prej dhunimeve deri te vrasjet, deri te torturat, deri te aspektet psikologjike të ndikimit ka ndodhur që në shumë vende për shkak të këtyre proceseve diku-diku komisionet të stërzgjaten dhe të mos mund të arrijnë efikasitetin e vet. Mirëpo, në disa vende, ku kanë qenë temat më të thjeshtësuara këto komisione kanë dal shpesh edhe me aspekte pak më rezultateve. Zakonisht një komision themelohet për të përcaktuar, do të thotë, të gjitha detajet. Në pjesëmarrjen e këtyre komisioneve, kryesisht, bazohet mbi përzgjedhjet që vijnë nga viktimat, luftëtarët, pjesët e shoqërisë civile dhe këta emra bashkëpunojnë do të thotë me institucione qeveritare dhe varësisht prej rregullave që i ka shteti përcaktohen personat ose individët. Komisionet mund të jenë të zgjeruara apo më të ngushta. Ka komisione që ka 5 anëtarë po ka edhe deri 60 anëtarë, varësisht se çka përmbajnë, dhe a përmbajnë staf. Është mirë dhe tentativë kryesore nëpër botë që është pa, është ajo se komisionet sidomos në vende të vogla, sikur që është Kosova në këtë rast, ose varësisht qysh përfshihet rajoni komisionet mos me pas shumë anëtarë për shkak se një pjesë e buxhetit harxhohet për vetë atë anëtarësi, kështu që shpesh si problematikë kryesore e funksionimit të komisioneve dhe më kryesore është vetë paraja dhe mundësia për të thithur donacion prej organizatave ndërkombëtare, të qeverive. Shumë shtete, funksionimin e komisionit e kanë të përcaktuar në baza direkte ligjore që gradualisht shndërrohet në ligj. Komisioni vepron i pavarur por në bazë të rregullores ku përcaktohet të mbulohet nga buxheti i

firmave të biznesit, që ndahet 1% ose 2% dhe të shkojë për të mirën e komisionit, të cilët varësisht prej mandatit që e kanë vet të përcaktuar, nuk ua kanë përcaktuar por e kanë të caktuar vetë, e ndajnë në mandat në komponentë të ndryshme. Ta zëmë që merret vetëm me të zhdukurit, merret vetëm me luftëtarët, merret vetëm me viktimat, vetëm me torturat, pra varësisht formave të veçanta. Ka mundësi që këto materiale t'i gjejnë dhe përdoren elemente që shihen se mund të jenë elemente më të mira e më të përshtatshme edhe pse, e thamë edhe më herët, gjithçka në secilën zonë, në secilin vend, format e veprimit janë krejt ndryshe, por ne mund të ndalemi vetëm në ato modalitete të ndërlidhura me institucione dhe me këto pjesë tjera, ndërsa pjesa e veprimit të shoqërisë civile në secilin rast, në çdo familje, në çdo fshat, në çdo pjesë është tepër i veçantë dhe do trajtim tepër të veçantë. Prandaj, nuk është iniciativë që ka filluar, nuk është diçka që nuk ka ndodhur nëpër vende tjera të botës por diku ka zgjatë shumë e diku është më e shkurtër dhe te ne, nëse fillon mbarë procesi, mund të përcaktohet edhe afati kohor i veprimit të komisioneve dhe nëse gjenden të gjitha rrethanat prej donacioneve deri te mundësia e hulumtimeve për të gjitha rastet atëherë do të jetë procesi më i shëndoshë.

Unë e kisha ndërpre këtu, kishim shkuar në kafe, e pastaj kur të kthehem edhe për këtë temë kishim mund të bisedojmë, varësisht edhe prej kohës që do të kemi. Shkojmë pra për ta pirë nga një kafe. Faleminderit!

(Vijon pauza)

Veton Mujaj: Atëherë, vazhdojmë pjesën tjetër. Besojmë se kemi me qenë shumë të shkurtër dhe të tentojmë që sa më shumë të paraqesim mendimet. Në vazhdimësi ia kisha dhënë fjalën koleges sime, është ajo Besarta. Urdhëroni, Besartë!

Besarta Vasija: Përshëndetje edhe një herë! Unë, së pari, desha të ju falënderohem të gjithëve që keni gjet kohë të vini këtu. Po më vjen mirë që kemi kaq shumë pjesëmarrës në këto konsultime dhe kjo tregon interesimin e madh të shoqërisë.

Pra, jam Besarta Vasija, koordinatorë për Kosovë në proceset e konsultimeve të Koalicionit për themelimin e KOMRA-s. Tani fillojmë me sesionin e dytë, ku unë fjalën do t'ia jap panelistit tonë Salem Çorbo nga Bosnja e Hercegovina i cili do të ju informojë diçka më shumë rreth Iniciativës për themelimin e KOMRA-s. Salem, urdhëroni!

Salem Çorbo: Edhe një herë po prezantohem: Salem Çorbo, Bosnja e Hercegovina. Në Bashkimi Evropian është duke u përgatitur një projekt që ka një titull pune "Evropa pa luftëra" Do të thotë 1914 – 2014, pra Evropa pa konflikte që prej se mban mend bota dhe ka filluar në vitin 1914 në Sarajevë dhe nga Lufta e parë botërore dhe shpresojmë, po edhe ata shpresojnë që luftërat në Ballkan, si ngjarje e fundit që ka ndodhur në Evropë. Ky projekt pra 1914 – 2014 Evropa ta lë pas veti epokën e luftërave dhe të gjakut, epokën e gjakut dhe të shpatave dhe kështu të rregullohen raportet në mes banorëve të saj. Në gjurmë të kësaj ideje është edhe ajo që ne duke u takuar në sektorin civil me anëtarët e shoqatave dhe familjeve të viktimave civile të luftës tash e katër vjet tentojmë të gjejmë se cila formë do të ishte më e arsyeshmja për të tentuar për të zgjidhur jo në mënyrë të segmentuar por në tërësi shumë prej këtyre problemeve, për të cilat, në pjesën e parë dëgjuam se ka aq shumë, do të thojë, pjesësh nga e vërteta, nga drejtësia, nga hospitalizimi i familjeve, ofrimi i ndihmës ndaj të gjithë të dëmtuarve, reparacionet, pra një varg çështjes dhe ne para disa vitesh jemi takuar në nivel të këtyre vendeve dhe kemi menduar që një komision rajonal, me një mandat shumë preciz dhe në funksion të caktuar do të mund të tentonte të përgjigjet në këto pyetje. Pra ky komision do të themelohej në mënyrë të ngjashme sikurse edhe disa komisione të më hershme por kemi të bëjmë me

një specifikum të këtij rajoni, pra kanë marrë pjesë më shumë vende dhe janë trajtuar shumë çështje por mendoj se në ecje e sipër nga viti 2004 në mënyrë që ky komision të mund ta kryente një pjesë të kësaj pune të rëndësishme. Përzgjedhja në mes të komisionit nacional dhe atij rajonal dhe përcaktimi që t'i jepet përparësi këtij të rajonit, është sepse komisioni nacional nuk do të mund të zgjidhte shumë çështje meqë kjo që ka ndodhur ka ndodhur në mënyrë të ndërlidhur dhe e gërshetuar në një kuadër të përbashkët që ata që e kanë bërë këtë krim e kanë bërë paraprakisht edhe në Bjelinë, Vukovar, Sanski Most dhe në vende të tjera. Pra, viktimat janë po ashtu në pjesë të ndryshme të këtij rajoni. Ne kemi situatën që vrasësit janë tani në shtete të tjera dhe edhe trupat e të vrarëve po ashtu në vende të tjera dhe ne nuk kemi paragjykim se si në kuadër të një komisioni rajonal t'i zgjidhim të gjitha këto çështje. Kjo siç dëgjova edhe nga njerëzit këtu, është një dialog, dialog i barabartë për të gjitha çështjet e hapura, duke përfillur të gjitha normat ndërkombëtare. Dikush e di që ka vetëm viktimat por jo edhe më shumë, as nuk e di kush ka qenë kryerës dhe ku janë trupat dhe ndodh se trupat e tyre të jenë në shtete të tjera. Dhe kjo është arsyeja kryesore se pse të orientohemi në një komision rajonal që ne, para se gjithash, me ngritjen e vetëdijes të opinionit publik të shoqërisë civile dhe opinionit në përgjithësi, duke mbledhur 1 milionë nënshkrime si formë presioni ndaj qeverive që mbi format e përcaktuara ndërkombëtare të punës së këtij komisioni, në suaza ligjore dhe do tua përcaktonin mandatin këtyre komisioneve për tu njohur me krimet, shkeljet serioze të të drejtave të njeriut, hulumtimin dhe gjurmimin e arkivave, gjurmimin për fatin e të zhdukurve dhe natyrisht edhe zbulimin e kryerësve dhe se kjo do të pasonte me vetë punën e këtij komisioni. Ka pasur dilemë nëse komisioni apriori të përcaktojë karakterin e luftës apo shkaqet që e kanë sjell luftën dhe një mendim që ne tani për tani mbajmë është që ne të përcaktojmë faktet, përmes fakteve pastaj, në mënyrë të përkryer dhe të qartë, do të shihet rruga e këtij krimi, do të shohim në mënyrë të qartë se cilat ushtri ku kanë qenë, çka ka mbetur pas tyre, sa shtëpi të djegur, sa civilë të vrarë. Pra, për një gjurmë të këtillë, përveç se do të ndërtojmë atë pasqyrën që e kemi të njohur, sepse dihet karakteri i deritashëm i luftës sonë në planin ndërkombëtar, por ne do t'i përkushtohemi edhe roli të viktimës dhe nevojave në raport me të. Tashmë theksova çështjen e problemeve të mëdha në Bosnje e Hercegovinë. Edhe ju i shihni çfarë janë problemet në rajon sa i përket bashkëpunimit, madje edhe me kryerësit e krimeve të luftës. Neve para do kohe na ka ndodhur një çështje, një gjë e hidhur dhe na ka ikur njeriu i cili është gjykuar për krime të luftës në Kroaci. Ai është endur nëpër Bosnje e Hercegovinë dhe me sistemet tona jo të konsoliduar nuk është dërguar atje ku është gjykuar me dhjetë vjet, sepse të gjitha vendet janë duke i konsoliduar mekanizmat e gjyqësorit dhe ndodh që ai, bie fjala, merr dokumentet në vendin tjetër dhe personi i tillë është i mbrojtur në raport me të gjitha çështjet e bëra. Unë nuk kam iluzione që formimi i këtij komisioni do të jetë i thjeshtë. Përkundrazi, do të ketë kundërshtime të mëdha, veçmas para strukturave politike që do të dëshirojnë t'i mbrojnë qëllimet e tyre madhe edhe territoriale për t'i dorëzuar kriminelët e luftës dhe të mundësojnë qasje varrezave, ta mundësojnë zbulimin e së vërtetës. Pra, kjo nuk do të jetë fare e thjeshtë. Rajoni është i ngarkuar me probleme të shumta. Ju e dini që Kroacia e ka akuzuar Serbinë për gjenocid dhe Serbia e kundërshton këtë, refuzon padinë për gjenocid dhe është gjykuar për mos pengim të gjenocidit dhe është përmirësuar në raport me atë që të parashikohen pasojat e gjenocidit dhe është kërkuar mendimi juridik. Pra, nuk do të jetë thjeshtë nëse pyeten vetëm politikanët. Mirëpo, pikërisht ata që i përfaqësojnë viktimat civile të luftës, ata që çdo

ditë ballafaqohen me probleme të tyre, ata që nuk duan që harresa t'i mbulojë të gjitha krimet dhe kriminelët të mbesin pa ndëshkuar dhe që të mos gjenden trupat, që familjet të mos marrin satisfaksion moral e material në këto reparacione, ata duhet të hapin një front dhe të bëjnë presion të fuqishëm ndaj pushtetit dhe me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar ka mundësi ta përfundojnë duke themeluar një komision të tillë me një mandat të fuqishëm dhe unë dua të potencoj se ky do të jetë mandat i fuqishëm me mbështetje ligjore. Mendoj se kemi arritur në punën e deritashme një nivel dhe mund t'i këmbëjmë përvojat, ta ndihmojmë njëri tjetrin dhe të tentojmë të sigurojmë të vërtetën dhe këto janë vrojtime parciais, prandaj ne nuk kemi të drejtë askënd ta ftojme në dëgjim, në përgjithësi, në intervistë. Këtë do të mund ta bëjë ky komision duke u nisur nga kryetari i shtetit dhe një çdo nivel tjetër. Ne nuk e kemi këtë forcë dhe nuk e kemi as këtë rol, prandaj ne duam që t'i nxisim ata që janë më përgjegjës dhe ta formojnë një formë të këtyllë të punës, natyrisht edhe me praninë e përfaqësuesve ndërkombëtarë në këto komisione, sepse nëse kanë mund 36 vende deri më tani ta bëjnë këtë dhe kanë qenë diku edhe 2-3 vende, mendoj se këtu duhet të jenë familjet e viktimave dhe shoqatat e këtyre familjeve mund të komunikojnë më lehtë. Unë pra këtë e them nga praktika dhe mund të flas shumë për këtë formë. Unë e di saktësisht se si e shoh këtë komision. Këtë e shoh si një organ ku organizata ime, unë dhe ju pra, mund të dërgoni të gjitha pyetjet e njohuritë tuaja dhe ta obligoni të përgjigjet në shumë pyetje. Shumë pyetje ka në pjesët tjera të rajonit, shumë trupa janë në vende ku ne nuk kemi qasje, shumë të vërteta nuk dihen për kampet e përqendrimit, shumë kryerës të krimeve i shoh në televizione në vende të tjera dhe është logjike që nëse një organizatë i drejtohet këtij komisioni ky komision pastaj në mënyrë relevante do të hulumtojë, pra do ta hulumtojë rastin dhe në mandatin e vet me siguri do të propozojë edhe procesimin penal dhe të gjitha shënimet do t'ia jap gjyqësorit dhe do të kërkojë nga gjyqësia ndërmarrjen e hapave, pra dikush që e ka këtë mandat dhe kjo është forma e vetme që ekziston në botë dhe në gjyqësi që të veprohet dhe punohet kështu. Pra, ne iniciojmë dhe delegojmë një pjesë të të drejtave tona, një pjesë të nevojave tona, të familjeve të viktimave që në një mënyrë të këtyllë të sistemuar ta rregullojmë këtë. Unë do të paraqes disa shembuj, sepse vi nga Bosnja. Nëse ju kujtohet në prill të vitit 1992 ka filluar pikërisht lufta këtu, në Bosnje e Hercegovinë dhe kam këtu një libër të kolegut tim që merret me hulumtimin e kësaj dhe dua tua tregoj dy fotografi për të cilat do të flas. Jemi pak dhe ndoshta mund të përcillet dorë në dorë dhe së pari shikoni këtë fotografinë ballore dhe këtë njeri të frikësuar, le të shkojë pra libri kështu dorë në dorë dhe mendoj se do të jetë interesante që pastaj rreth kësaj t'i paraqes disa hollësi për ç'arsye është me rëndësi që ky komision ta ketë mandatin çfarë duhet. Kjo fotografi është e një fotografi të njohur dhe në ballin e fotos shihen tre njerëz duke e shqelmuar një femër, pra ata janë me pajisje ushtarake. Paraprakisht i kanë vrarë 3 veta. Pra janë disa foto të këtylla se si shtinë në të. Pra, këto janë prej 1 prill të vitit 1992. Këta 3 njerëz, pa u fshehur, me fytyrë pra të hapur, qëndrojnë mbi viktimat dhe pas ekzekutimit i shqelmojnë, e shqelmojnë edhe këtë zonjë. Kjo është një familje e një njeriu që është vrarë para shtëpisë së vet, bashkë me vëllanë në prill të vitit 1992 dhe kjo fotografi ka dalë në të gjitha gazetat dhe revistat botërore, në të gjitha mediat. Kanë kaluar tash e 17 vjet dhe njerëzit që e kanë bërë këtë janë në Serbi. Ata janë gjallë, sa e di dhe vetëm Natasha Kandiç, drejtoreshë ekzekutive e Fondit për të Drejtën Humanitare ia ka dërguar një letër kryetarit të Serbisë Boris Tadiç duke kërkuar që t'i procedojë këta njerëz që janë në këtë fotografi të dokumentuar. Pra, absolutisht është ekspozuar në mënyrë

publike, kanë bërë masakër dhe me atë rast janë vrarë 17 veta. Nuk e di deri ku ka arritur kjo letër drejtuar kryetarit Tadiq, por mendoj se ky komision do të kishte për qëllim të hulumtojë dhe t'i detyrojë të gjitha organet për t'i dhënë shënimet, natyrisht edhe njerëzit e tillë, që prej tyre njëri është vrarë, ndërsa dy janë gjallë dhe tash e 17 vjet janë të lirë. E di këtë tërë bota dhe e sheh e tërë bota këtë të vërtetë dhe të kësaj familjeje edhe djalini ia kanë vrarë dhe ka mbetur gjallë vetëm një vajzë e cila deri më tani ka jetuar në Evropë dhe pastaj ka shkuar në Amerikë dhe tani është duke jetuar në Australi dhe me siguri edhe atje nuk do të gjejë prehje sepse nuk ka satisfaksion për krimin që ka ndodhur në familjen e saj dhe nuk ka marrë kurrfarë reparacionesh as morale as materiale as në Bosnje e Hercegovinë dhe as diku tjetër. Prandaj, pritet ndonjë moment e rast tjetër, priten njerëz më të guximshëm dhe politikanë për të gjetur forcë që ata ta thërrasin dhe publikisht të kërkojnë falje sikurse mijëra e mijëra të tjerë, që në mënyrë të ngjashme kanë kaluar. Kjo është Fotografia e njeriut të frikësuar që është vrarë po ato ditë, është pushkatuar. Kemi të bëjmë me një njeri, pra është një shqiptar nga Kosova i cili praktikisht është nxjerrë nga shtëpia e tij. E ka pasur letërnjoftimin nga Kosova dhe për ta ka qenë një arsye e mjaftueshme për ta burgosur dhe së pari e kanë rrahur, e kanë quar në shtabin e krizës të SDS – partia demokratike serbe që ka qenë bartëse e të gjitha ngjarjeve në Republikën e atëhershme serbe dhe nga lartë e kanë gjuajtur, pra nga kati i dytë, nga dritarja dhe kur ka ardhur fotografi ai ka qenë ende gjallë dhe meqë ka mbijetuar ata e kanë vrarë dhe pastaj ka ardhur Arkani dhe ka urdhëruar që ta çojnë në spital. Ruhan Habib pastaj ka shkuar në spital për ta gjetur këtë njeri dhe natyrisht nuk e ka gjetur dhe i kanë thënë as që është sjell në spital dhe praktikisht identiteti i këtij njeriu nuk dihet.

Këtë e them sepse ato ditë, për arsyetuar sulmin e tyre në Bjelinë kanë proklamuar një devizë, pra një definicion se përgatitet hakmarrja përkatësisht një sulm i radikalëve islamikë dhe i fundamentalistëve nga Kosova dhe për ta dëshmuar këtë pushtetarët i kanë nxjerrë të gjithë shqiptarët që kanë jetuar në Bjelinë dhe që kanë pasur qasje tek ata, i kanë nxjerr nga shtëpitë e tyre dhe thjeshtë i kanë ekzekutuar, i kanë vrarë dhe ky është pësimi më i madh i shqiptarëve në Bosnje e Hercegovinë. Pra ka qenë një vrasje kolektive. Trupat – kufomat pastaj i kanë larguar, kryesisht i kanë gjuajtur në Dri dhe disa të tjerë në varreza të fshehta dhe për një pjesë tjetër të tyre janë interesuar familjet dhe nga Bjelina janë transportuar për Maqedoni, shumica e tyre edhe në Kosovë. Ndërimi është bërë në Smederevë. Njeriu që i ka vozitur më ka fol për këtë. I kanë nxjerr nga Bijelina të gjithë këta trupa dhe familja e ka shpërblyer që i ka sjell ata trupa. Këtë e them nga një arsye të thjeshtë. Këta njerëz janë vrarë në Bjelinë. Vrasësit kanë ardhur nga Serbia dhe tani pjesa më e madhe e tyre që e kanë mbijetuar luftën jetojnë në Serbi. Trupat ose nuk dihet ku janë ose janë bartur dhe janë varrosur me doket dhe zakonet pa bërë trajtimin patologjik, pra pa përcaktimin e kryerësve janë varrosur sikur të kenë vdekur nga një vdekje e natyrshme. Për këto krime dinë vetëm familjet dhe praktikisht as që janë evidentuar në ndonjë vëllim më të rëndësishëm dhe kjo ndodh dhe bëhet ashtu siç duan pushtetarët që të harrohen sa më parë, që gjurmët të zhduken, që njeriu siç është rasti që është gjuajtur nga shtabi i krizës, kjo ndërtesë tashmë është rrëzuar prej nga është gjuajtur ai, nga kati i dytë dhe këtu është ngritur një bankë, pra nuk e kemi as vendin e krimin. Nuk kemi qasje në arkiva dhe unë do të kisha dëshiruar që dikush ta gjejë formën se si të gjurmohet, të hulumtohet ky rast e mos të jetë në një nivel rajonal. Unë merrem shumë gjatë me këtë çështje. Ata që i kanë shkaktuar këto konflikte të luftës dhe ceku këtu shembullin e Bjelinës. Në Bosnje e Hercegovinë dhe në të gjitha rajonet tjera të

Bosnjës ku ka pasur ngjarje të tilla kemi një situatë plotësisht të njëjtë. Të gjithë angazhohen që këtë ta mbulojë harresa, vdesin dëshmitarët, zhduken gjurmët dhe dëshmitë, rritet vetëm dhembja dhe mundimet e familjeve të viktimave, ata mbesin gjithnjë e më të vetmuara në tentim për të rregulluar të drejtat e tyre dhe përmes reparacionit material dhe jo material ku veçmas i theksojmë reparacionet jo materiale dhe unë kisha dëshiruar që në një të ardhme të caktuar përmes punës së këtij komisioni të gjithë të fillojmë të marrim pjesë në varrosjen e këtyre viktimave civile të luftës. Mjerisht në Bosnjë e Hercegovinë bëhen veç e veç, sipas zakoneve të secilit dhe duhet që ta njohim statusin e të gjitha viktimave civile të luftës dhe së pari ne duhet të jemi pionierë të kësaj çështjeje, të kësaj pune dhe të kemi një respekt të dinjitetshëm ndaj këtyre viktimave dhe të kërkojmë që edhe të tjerët të sillen kështu. Për ta realizuar këtë duhet në mënyrë shumë të organizuar dhe sistematike të ndërmarrim një fushatë publike dhe t'i paraqesim qartë mendimet, dëshirat dhe çka kërkojmë nga ky komision, t'i inkorporojmë të gjitha nevojat tona aq sa është e mundur në punën e këtij komisioni dhe t'i nxisim mekanizmat shoqërorë dhe para se gjithash ky është një mekanizëm shoqëror ku në kohën e shkeljes enorme të të drejtave të njeriut një shoqëri mund të ballafaqohet sepse natyrisht është e qartë se sistemet edhe më të ndërlikuara dhe më të ndërtruara nuk mund tu dalin në fund këtyre çështjeve. Pran, një qasje e përgjithshme sistematike aq sa ka mundësi në rajon, krahas një mbështetjeje absolute të të gjitha niveleve të pushtetit dhe natyrisht kjo të bëhet nga një zemërgjerësi dhe pastërti, sepse nëse duam që të arrihet deri tek dokumentet dhe argumentet dhe nëse këto nuk do të jenë, do të shfaqen probleme. Ne jemi pionierë, shoqëria civile. Unë dje kam udhëtuar tërë ditën për të qenë këtu me ju dhe për të parë atë sikur që e shoh edhe në Bosnjë, në Mal të Zi dhe në Kroaci. Ju tek ne do të takoni njerëz të njëjtë, me probleme shumë të ngjashme, me pakënaqësi shumë të ngjashme, me qëndrimin e qeverisë dhe përse vetëm këta e bartin atë barrë që është më e madhe, që na ka lënë edhe lufta edhe tranzicioini në trashëgimi dhe kjo është barra e viktimave dhe barra e asaj që përcaktimi i fajtorit të mos përcaktohet. Kemi rast që kanë mbajtur burgim dhe kandidohet për kryetar të komunës. Ne duhet të ndërtojmë një mekanizëm tjetër, sepse këtu duket se nuk ka mëshirë për t'i procedura këta njerëz dhe për largimin e përjetshëm të tyre nga të gjitha funksionet publike dhe të ndërtojmë një mekanizëm në kuadër të punës së këtij komisioni dhe të qëndrojmë fuqishëm pas kësaj, sepse nëse ua lëmë vetëm politikanëve të gjithë këtë që kanë bërë këtë periudhë, kjo është shumë pak dhe kjo që ka ndodhur nuk do të ndryshojë fare gjendjen para se gjithash për familjet e viktimave për të vërtetën që u ka ndodhur atyre. Unë me kaq edhe e kisha përfunduar këtë pjesë.

Besarta Vasija: Ju faleminderit, zoti Çorbo. Tani do t'ia japim fjalën Valdete Idrizi, anëtare e Këshillit koordinues të Koalicionit për themelimin e KOMRA-s. Urdhëro Valdete!

Valdete Idrizi: Faleminderit, Besarta! Unë dëshiroj vetëm të tregoj ndoshta përvojën time, edhe pse vetë iu kam bashkëngjitur kësaj iniciative, kësaj nisme, edhe pse nuk i jam bashkëngjitur prej fillimi. E di që në maj të vitit 2006, tri organizatat me një bagazh bukur të madh në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ballafaqimit me të kaluarën, e këto janë: Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Organizata "Dokumenta" nga Kroacia dhe Qendra për Hulumtim dhe dokumentim nga Bosnja, të cilët më në fund, pas shumë përpjekjeve kanë mbërrirë në njëfarë forme të alarmojnë edhe opinionin e gjerë dhe njëkohësisht edhe autoritetet, duke organizuar, pas disa përgatitjeve të mëdha, forumin e

parë rajonal, që atëherë nuk është quajtur forum për drejtësinë tranzicionale. Pra, pas një presioni shumë të madh, që edhe përfaqësuesit më të lartë të qeverisë me i bë presion që ta hapin bile forumin, që të tregojnë njëfarë përkrahje institucionale. Kjo ka pas rëndësi shumë të madhe edhe për pjesëmarrësit që kanë qenë nga gjithë rajoni, i shtresave të ndryshme të shoqërisë. Vlen të përmendet se njëkohësisht kanë qenë njerëzit, sikur edhe në këtë tavolinë këtu. Ka pasur njerëz edhe të organizatave të të drejtave të njeriut, ka pas edhe shkencëtarë të ndryshëm, ka pas artistë, ka pas përfaqësues të mediave, ka pas përfaqësues të shoqatave të dëshmorëve dhe të viktimave dhe njëkohësisht edhe përfaqësues të institucioneve. Dhe pas forumit të madh, do me thënë pas një buri të madh që është bërë në shoqëri atje, që është mbajtur fillimisht në Sarajevë, që do të thotë se është hapur njëfarë diskutimi publik, pra në çfarë forme me u ballafaqua me të vërtetën, cilët janë ata mekanizma, të cilët më së miri do të thotë në mënyrën më të mundshme dhe me objektiva të mundshme të arrihet deri te një e vërtetë, të kishin mund në njëfarë mase të arrihen të gjitha ato nevoja dhe të pritura prej viktimave. Kështu që rruga më e sigurt dhe më e mirë e mundshme që edhe këto tri organizata – iniciatore kanë bërë, ka qenë një proces i konsultimeve, të organizohen konsultime të ndryshme, me grupe të ndryshme njerëzish nga i gjithë rajoni dhe të dëgjojmë edhe njerëzit se çfarë kanë të thënë, çfarë i kanë idetë. Njëkohësisht kanë sjellë edhe përfaqësues të ndryshëm të komisioneve nga e gjithë bota, domethënë komisione të cilat kanë arritur me i ndriçuar dhe zbardh shumë raste, me i gjet kufomat e të zhdukurve, një numër shumë të madh dhe këto i përmendi më herët edhe Vetoni por edhe në materialet që i keni aty ka informata të bollshme rreth komisioneve në gjithë botën. Pastaj ka qenë edhe ideja tjetër që duhet, pasi po thuhet se është një nismë rajonale, u përmendën edhe prej zotëriut Çorbo dhe prej shumë tjerëve pse është me rëndësi që të ketë një qasje rajonale, e jo nacionale. Pikërisht, shumë raste që u thanë se krimet kanë ndodhur në një shtet dhe gjetjen janë diku krejt tjetër, do të thotë prej Bosnjës në Maqedoni dhe sikur që u tha edhe më herët prej zotërinjve këtu se kriminelët shëtisin në shtetet fqinje dhe ka shumë e shumë dokumentacione e dosje që arsyetojnë se duhet të ketë një qasje rajonale, sepse ajo nacionale do të jetë shumë e mangët ose në nivel nacional dhe të mos hy tash me më shumë argumentime. Pastaj është organizuar forumi i dytë i madh që i ka mbledh afër 400 vetë në Kroaci, pasi që është paraparë që të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë të organizohet forumi dhe që pikërisht të hapet ndoshta prej personit numër një të atij shteti. Edhe në Kroaci ka ndodhur e njëjta gjë. Edhe aty ka pasur një përkrahje jashtëzakonisht të madhe nga shoqëria për nismën dhe gradualisht vetëm duhet orientuar te një emër se çfarë lloj komisioni kishte me qenë ky. Edhe aty Presidenti i Kroacisë, zoti Stipe Mesiç e ka hapur forumin. Pastaj ka qenë forumi në shkurt 2008 në Beograd, ku kryetari i Kuvendit, pas një presioni bukur të madh që ka bërë zonja Natasha Kandiç, ka ardhur dhe ka thënë se duhet patjetër të ketë qasje rajonale pa e potencuar ndoshta Kosovën, Bosnjën, Kroacinë, Maqedoninë, Malin e Zi. Ndërkohë, në mes të gjitha forumeve kanë ndodhur konsultime edhe rajonale edhe konsultime në nivel nacional ose sh shtetëror. Vlen këtu të përmendet një prej konsultimeve ndoshta që ia ka dhënë edhe emrin, do të thotë Koalicioni, ku edhe është zyrtarizuar Koalicioni dhe është formuar ky grup koordinues si një strukturë brenda të gjithë iniciativë, ka qenë në Podgoricë, vitin e kaluar ku ka marrë pjesë një numër shumë i madh edhe prej Kosove. Kanë marrë pjesë një numër i madh prej shoqatave të familjarëve, sepse ka ekzistuar një bashkëpunim shumë i madh me këshillin e familjare – këshillin e shoqatave të familjarëve dhe është debatuar

rreth nevojës dhe rëndësisë për të pas një komision të tillë. Disa prej juve keni qenë aty dhe pasi që komisioni veç është strukturuar edhe grupi koordinues, fillimisht nga një përfaqësues prej secilit shtet, e më vonë edhe nga 2 përfaqësues prej secilit shtet, në këtë rast jam unë dhe është zonja Shukrije Gashi që është prej Organizatës “Partners Kosova” me seli në Prishtinë dhe që është e përfshirë në gjithë Kosovën. Do të thotë arsyeja e ekzistimit të këtij grupi koordinues ka qenë pikërisht për të gjitha këto rekomandime, sikur që është prej kësaj tryeze sot dhe sikur prej konsultimeve të deritanishme me u bartë në takime të rregullta që i kemi ne. Të gjitha këto shqetësime që paraqiten këtu dhe të gjitha këto, të them, edhe kritika edhe komplimente, edhe sugjerime që të paraqiten atje. Në të shumtën e rasteve, prej përvojës po ju them, shpeshherë të gjitha këto brenga të cilat ju po i shtroni sot dhe që po shtrohen nga konsultimet tjera janë të njëjta edhe në rajon. Shumë çështje teknike, politike, do të thotë, në bazë të proceseve që po ndodhin, ka pas pyetje të njëjta dhe brenga të njëjta. Pra, normal, edhe unë sikur të gjithë ju tjerët dhe kolegët e mi jemi të vetëdijshëm se ky është një proces shumë i ndjeshëm. E dimë që pas sa vjetëve, 17.000 janë të pagjetur në krejt rajonin. 1.900 janë vetëm në Kosovë dhe ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe vërtet personalisht mendoj që nuk kemi më komoditet që t’ia lëmë këtë kohës e të mos marrim veprime. Nuk mund të kemi komoditet që të bëjmë me gisht kah tjetri dhe të mos e qesim gishtin kah vetja. Pikërisht kjo ka qenë arsyeja pse unë herën e parë kur kam qenë e ftuar në konsultime në Beograd në dhjetor 2007, kur më kanë ftuar në njërin prej konsultimeve që kanë qenë me organizata të drejtave të njeriut, pyetjen e parë që e kam parashtruar pasi e lexova një material që më është dhënë atëherë rreth të gjitha këtyre që i thash më herët, pyetja e parë ishte pse ka pak njerëz prej Kosove, pse na keni ftuar kaq pak. Dhe arsyeja tjetër, edhe materiali që e kisha unë e kisha pa se ka pjesëmarrës tjerë prej Kosove, mirëpo njëfarë shpërndarje e informatave ka munguar. E pash se gatishmëria që të ketë më shumë njerëz prej Kosove ka qenë prej të gjithëve, prej iniciatorëve pikësepari por edhe prej të gjithë pjesëmarrësve. Menjëherë pas konsultimeve dhe pas forumit në Beograd janë organizuar konsultime edhe në Kosovë. Ndoshta një prej konsultimeve më të mëdha që kanë qenë, u mbajt në Mitrovicë, të cilin e kam ndihmuar për ta organizuar bashkë me zyrën e Fondit në Prishtinë, ku me këtë rast kanë qenë edhe përfaqësuesit e “Syri i vizionit”. Këtu edhe vetë nuk i kam pas të qarta disa gjëra, po flas për vitin e kaluar, ende nuk i kam pasur krejt. Kisha nevojë me dëgjua prej njerëzve çfarë lloj komisioni është ky, a mos vallë ne po e bëjmë këtë komision, sepse këto pyetje janë shtruar gjatë të gjitha konsultimeve, sepse së pari rreth mandatit a mos shoqëria civile ose Serbia pasi këto organizata prej Serbisë, Bosnjës e Kroacisë e kanë nisur, a mos Serbia po do iniciativa prej atje dhe ndoshta në njëfarë forme me i minimizuar edhe krimet në Kosovë. Jo, se krimet kanë ndodh dhe assesi shoqëria civile askund në botë nuk ka as takat as mandat me themeluar komisione. Mirëpo roli i shoqërisë civile në këtë rast i joni por edhe nëpër botë është që të luajmë rolin dhe të llojmë dhe në kuadër të këtyre konsultimeve t’ia dhamë formën këtij komisioni që ne po dëshirojmë ta kemi. Shumë pyetje pastaj janë bërë, pse ju nëpër materiale keni afatin kohor 1991-2001, pse jo në 81-ën kur dihet se edhe ushtarë janë vrarë në ish-armatën e Jugosllavisë, pastaj ka pas pyetje pse ju mos me shukua nga 2004 çka ka ndodh këtu në ngjarjet e marsit, pastaj në Kroaci kanë qenë pyetjet pse jo e 2000 sepse paskan ndodh disa ngjarje. Mirëpo e specifikoi shumë më herët Vetoni rreth përvojës së tjerëve, sa më i qartë, sa më i strukturuar të jetë mandati aq më shumë do të ketë sukses. Dhe pasi ne po flasim për luftërat që kanë ndodhur dhe të gjitha këto shtete

që kanë qenë të përfshira atëherë kjo periudhë 1991-2001, përfshirë këtu edhe Maqedoninë. Pastaj ka pas pyetje të njëjta që i parashtruat këtu, do të thotë edhe më herët, do të thotë, rreth manipulimeve, gënjeshtrove të ndryshme, rreth krimeve që kanë ndodhur. Pikërisht kjo është edhe arsyeja pse duhet me pas këtë komision. Pikërisht është kjo që unë kam thënë duhet gjithsesi... këto spekulime që kanë ndodhur dhe kanë me ndodhë, kanë me tentuar me ndodh për arsye të ndryshme, që mos me i lejuar. Sepse ne po tentojmë dhe nëse ne jemi ata që në njëfarë forme e dizajnojmë dhe i caktojmë të gjitha ato kritere se çfarë kanë me qenë për atë komision, çfarë kanë me qenë pra ata komisionarë dhe sidomos edhe gjatë procesit që ta kemi një njëfarë forme mbikëqyrjen, kontrollimin dhe vlerësimin e atij komisioni dhe mendoj se kjo është ajo rruga e vetme. Prandaj, fillimisht e thash, është shumë me rëndësi që çdonjëri prej neve, pavarësisht në cilën fushë punon, dikush prej juve në këtë sallë jeni edhe më të thirrur me folur sepse drejtpërsëdrejti jeni prek, apo jemi prekur në këtë rast, do të thotë prej lufte. Dikush tjetër është duke punuar në këtë fushë në formë tjetër. Nuk duhet vetëm ata, që e përmendi më herët edhe zotëri Arapi, nuk duhet të presim vetëm prej shoqatave që të organizojnë debate të tilla dhe të nxisin debate të tilla. Nuk duhet të merren me këtë çështje vetëm ata që drejtpërdrejt janë goditur. Ne, si shoqëri, jemi goditur të gjithë dhe e thash më herët, unë mendoj se historia nuk na falë nëse ne nuk i shtyjmë proceset. E dimë se është shumë e ndjeshme, dimë se ka pyetje ndoshta shumë të ndjeshme... Atëherë, Kosova nëse është shtet, Serbia s'e ka pranuar si shtet. Qysh presim ne do të thotë ai komision me u formua. Unë mendoj se nuk është puna jonë tash që të mendojmë. Ne duhet të koncentrohemi në mënyrën më të mirë të mundshme me krijuar këtë platformë dhe me i dizajnuar format në të gjitha ato faza apo etapa apo ato komponentë që gjithherë nevojat e viktimave me qenë numër një. U tha edhe më herët, këto janë vende të një rajoni, të gjitha këto shtete që kanë dal prej ish-Jugosllavisë janë të barabarta, kështu janë të barabarta edhe te ne në këshillin koordinues, kështu janë të barabarta edhe në nivelin e konsultimeve. Sepse me ndihmën e donatorëve të ndryshëm kemi mbërri, do me thënë kanë mbërri faktikisht një punë shumë të madhe që e ka bërë Fondi me i siguruar mjetet për diku 70 konsultime në nivel do me thënë të krejt rajonit. Edhe për Kosovë, deri në fund të vitit të kaluar sepse e dimë që ky është një proces dhe është edhe i ndjeshëm, nuk mundet të kryhet për një kohë të shkurtër dhe ka hapësirë për konsultime dhe gjithherë për rekomandime konkrete të dala prej konsultimeve. Unë mendoj se në pjesën e parë të debatit veç u dhanë disa rekomandime konkrete dhe u dhanë disa, do me thënë u dhanë disa alarme që u përmend edhe për vende tjera po edhe disa të tjera prej zotëri Berisha që nuk janë përmendur edhe më herët, kështu që është shumë me rëndësi që do me thënë të jemi të hapur dhe të ndihmojmë këtë proces. Do ta shihni tash në këtë dokumentarin më vonë konkretisht qysh kanë funksionuar komisionet nëpër botë. Do t'i shihni edhe vetë komisionarët, do me thënë me çfarë sfidash janë ballafaquar. Nuk jam unë eksperte në këtë fushë, nuk jam psikologe apo juriste që të ju flas më tepër, do me thënë, rreth të gjitha atyre procedurave veç mendoj se pas shikimit të dokumentarit që do ta shihni keni me pa që edhe pse janë formuar prej shteteve këto komisione kanë qenë të mbikëqyrura edhe prej palëve tjera. Domethënë kjo definitivisht është një sfidë se shtrohet pyetja se vetë shtetet po i formojmë atëherë ku e sigurojmë objektivitetin dhe profesionalizmin. E po pikërisht ne duhet tash me dizajnuar dhe me bë ndoshta kur flasim për mandat dhe për të gjitha, me i parapa të gjitha këto gjëra. U përmend më herët, do me thënë edhe Afrika e Jugut dhe domethënë... Unë për këtë komision që ka qenë komision për pajtim kam pas edhe

informata edhe më herët, kam pa disa dokumentarë, mundem me thënë të 99-tën veç kur kanë filluar edhe me punuar në punën që e bëj edhe sot. Fjala pajtim është përmendur shumë herë nëpër konsultime. Nuk jemi të gatshëm me u pajtua, veç duhet me u vërtetua faktet. Njëkohësisht edhe e vërteta, në komision për të vërtetën, e cila e vërtetë. Gjithkush e ka të vërtetën e vet. Mirëpo për atë kemi qenë do me thënë edhe ndoshta shumë të kujdesshëm domethënë për KOMRA-n – Komisioni rajonal për vërtetimin dhe përcaktimin e krimeve të luftës në ish-Jugosllavi dhe shkeljeve tjera të rënda njerëzore. Procesi i pajtimit kuptohet, domethënë komplet drejtësia tranzicionale komplet, procesi do me thënë është bukur i gjatë e bukur i dhembshëm mirëpo komisioni do ta ketë... Ne konsiderojmë deri tash, gjithherë po flas, duke u bazuar në procesin e konsultimeve dhe njerëzve që kanë marrë pjesë në këtë proces. Shumë qëllimisht i kemi larguar domethënë edhe prej agjendës sepse edhe sa i përket dëgjimeve publike, sidomos dje, ndoshta me nda prej juve disa, dy prej juve e di që jeni këtu prezent me gra, me organizata që janë pjesë e Rrjetit të grave të Kosovës, rreth dëgjimeve publike që i përmendi më herët edhe Elberti. Në të gjitha këto forume që kanë ndodhur dhe ky i fundit që nuk e përmenda, do me thënë në Beqiq me një numër shumë të madh të njerëzve prej rajoni, ka pas do me thënë edhe dëgjime publike apo rrëfime publike. Mirëpo edhe këtu qysh u tërheq vërejtja edhe prej grave përfaqësuese të grave aty, do me thënë duhet njëfarë forme jo tash të imponohet mirëpo është hapësira, janë grupet e ndryshme, kategoritë e ndryshme ku dikush ndihet mirë të rrëfëhet dhe të dëshmojë për të gjitha ato që u kanë ndodhur. Mirëpo kur vjen puna te rastet e dhunës seksuale, te gratë, atëherë normal duhet edhe të respektohet ajo mosgatishmëri. Kështu që, nuk po dua ndoshta tash në këtë fazë me ju lodh me të gjitha detajet, veç po kam qejf me ndërpre këtu dhe çfarëdo lloj pyetjeje rreth konsultimeve deri tash, çka ka ndodhur dhe rreth planeve, kisha pas qejf do me thënë me i shtrua. Ndoshta një informatë që u tha prej shumë njerëzve, mosgatishmëria prej qeverisë, edhe pse në forum, në Prishtinë që ka qenë deri tash, vlerësohet si forumi më i suksesshëm edhe me pjesëmarrje të njerëzve por edhe me pjesëmarrje në diskutime, ka qenë hapur nga kryetari i Kosovës dhe njëkohësisht edhe zëvendëskryeministri Ramë Manaj ka qenë prezent mirëpo edhe ministrja e Drejtësisë. Edhe ne si Kosovë duhet vazhdimisht të ushtrojmë presion sepse sinjerisht kjo temë është e ndjeshme dhe mundem me thënë nuk është atraktive fare, sepse nuk është punuar, mos të them, hiq por nuk është punuar sa duhet. Për atë duhet vazhdimisht të ushtrojmë presion dhe nëse sot, mua sot po më vjen mirë që ishte dikush edhe prej përfaqësuesve të komunës, do me thënë të Pejës këtu mirëpo është mirë që gjithherë domethënë pasi veç kemi qasje gjithëpërfshirëse jo assesi përjashtuese që të bëjmë presion edhe të informojmë çka po ndodh në atë mënyrë që me i përfshi të gjithë në proces se deshën s'deshën, qeveria, shtetet janë ato që kanë me i formuar. Dhe deshën a s'deshën unë e di dhe jam e vetëdijshme sikur edhe gjithë ju, Kosova është në një fazë të tranzicionit. Edhe Kosova i ka të them hajt në thonjëza “do prioritete të veta”, se tash jemi bërë shtet, s’jemi kanë kurrë dhe i kemi do sfida pak më ndryshe se shtetet tjera. Mirëpo, besoni në secilin shtet që shkojmë thonë kështu njëjtë – edhe ne i kemi do prioritete tona, edhe te na në Bosnjë i kemi prioritetet, domethënë, tjera probleme. Për atë po them që ajo që po na mbledh krejt rajonin janë këto lufta që kanë ndodh dhe kjo e kaluar e përbashkët gjithsesi duhet me na mbledh për mos me na u përsërit sendet në të ardhmen. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit, Valdete! Tani në radhë është shfaqja e një filmi lidhur me përvojat e të tjerëve. E kemi Komisionin e së vërtetës në Peru. Ky Komision është

themeluar nga dekreti presidencial, do të thotë nga një dekret presidencial dhe qëllimi i këtij komisioni ka qenë vërtetimi i fakteve dhe përgjegjësia e të gjitha palëve që kanë qenë të përfshira në luftë.

Pas filmit do të vazhdojmë me diskutime, ku mund të bëni pyetje dhe mund të komentoni edhe për fjalimin e Valdetes por edhe të Salemit. Tani fillojmë me filmin.

(Shfaqja e filmit dokumentar)

Besarta Vasija: Tani kisha ftuar të gjithë pjesëmarrësit në debat, për pyetje, për komente, për vërejtje dhe për çka do që kanë. Urdhëroni, zotëri Lulzim.

Lulzim Arapi: Desha fillimisht me falënderuar prezantuesit e mëparshëm, duke filluar nga zoti Salem, mysafir nga Bosnja dhe zonja Valdete dhe gjithashtu me falënderuar për prezantimin e filmit që shikuam. Edhe pse filmi kishte të bëjë me një dhunë e cila kishte ndodhur brenda shoqërisë së njëjtë, e cila nuk është rrethanë te ne, pra për fat të keq, megjithatë kanë qenë në pyetje grupe të ndryshme etnike. Megjithatë, janë shumë gjëra që sado-kudo mund të jenë të njëjta, pak a shumë, në aspektin e tragjedisë. U përmend disa herë, disi me një dozë të rezervës fjala “pajtim” apo ndoshta edhe qëllimi i këtij komisioni çfarëdo që të jetë ai. Nuk jam njohës i mirë i punës së komisioneve, edhe pse mendoj se kam lexuar diçka për to dhe çfarëdo qëllimi që të jetë i shkruar në kuadër të atij formulimi zyrtar të komisionit, mendimi im personal dhe ndoshta profesioni e bën këtë mendoj që në fund të fundit qëllimi është pajtimi. Dhe, nuk do të doja që kësaj fjale ne t’i frikësohemi dhe ta konsiderojmë se është diçka që i përket djallit apo kohës ku ta di unë të ligave, shtrigave e tjera. Nëse e kujtojmë iniciativën, nëse e kuptova mirë të Bashkësisë Evropiane, sikur që e tha zoti Salem, për një periudhë 100-vjeçare 1914 dhe 2014 të kohës pa luftë, unë për fat të keq, megjithatë do të doja të them se konflikti si i tillë ende vazhdon. Unë këtë vazhdimisht e them edhe në trajnime dhe në të gjitha takimet që unë marrë pjesë. Konflikti si i tillë, për fat të keq edhe etnik, këtu në Kosovë po do të thoja edhe në Bosnjë e Kroaci, si i tillë, për mendimin tim ende vazhdon, ai ende nuk ka përfunduar. Palët në njëfarë mënyre ndoshta janë shkëputur nga një kontakt i drejtpërdrejtë agresiv mirëpo megjithatë ai në njëfarë mënyre apo në një mënyrë tjetër ai ekziston dhe edhe më tutje vazhdon. Edhe konflikti si i tillë do të përfundojë në momentin kur personat të cilët kanë qenë të involvuar në një apo mënyrë tjetër të jenë në gjendje t’i përfundojnë të gjitha ato që kanë qenë të ndërlidhura me luftën. E kjo, nuk është e lehtë. Lufta, pas vete lë trauma. Traumata si të tilla janë gjurmë të pashlyeshme. Ato regjistrohen në sistemin tonë të trurit, sistemin tonë nervor – pra në trurin tonë dhe të tilla ato mbesin gjatë tërë jetës. Pra, është e pamundshme të mendojmë se nëse nuk flasim për atë se çka ka ndodhur kjo do të jetë ndoshta një mënyrë e zgjidhjes së problemi. Pra, kjo është marri, është e pakuptimtë. Mënyra se si problemet mund të zgjidhen, është biseda. Pra të flitet për to. Dhe, ndoshta, komisionet e tilla mund të ndihmojnë që njerëzit të kenë mundësi, të kenë një vend ku do ta kenë atë të drejtë ta thonë në mënyrë të hapur atë se çka iu ka ndodhur. Prandaj, po më duket se kjo do ta ketë një efekt psikologjik, një efekt shërues që ne e quajmë katarza, por katarza emocionale, kur arrihet një zbrazje e gjithë asaj ngarkese të tmerrshme emocionale. Unë nuk mendoj se do të duhet shikuar format e veçanta, definimet e veçanta të komisioneve në vende të tjera si forma të cilat duhet t’i respektojmë në tërësi dhe të mendojmë se ato mund të jenë të aplikueshme për vendin tonë. Edhe pse i përkas profesionit të shëndetësisë, të gjitha ato që kanë të bëjnë me shëndet mental, pra edhe me probleme mentale, me probleme të jetës – nuk janë kirurgji, por nuk mund të vendoset sikur që vendoset në një sallë të kirurgjisë njëjtë si në

Afrikë si në Kosovë me të gjitha instrumentet tjera. Pra, çdo gjë i ka specifikat e veta, i ka karakteristikat e veta, dallimet e veta. Edhe unë ndoshta jam kureshtar me marrë atë material dhe të shikoj çka është arritur në këtë drejtim, sidomos në vendet përreth nesh dhe mendoj se përvoja e Bosnjës, e Kroacisë sado-kudo mund të jetë një përvojë shumë më e afërt edhe për ne sesa ndoshta ndonjë përvojë e ndonjë shteti më të largët, pavarësisht prej asaj sado e mirë ajo që të jetë. Disi puna e komisionit, pra më duket nëse e kuptova mirë është në procesin e definimit, po flas për këtë idenë që të formohet në nivel rajonal. Mirëpo, nuk e di, por disi më shkoj ndërmend ajo figura e mitologjisë greke - Sizifi, pra si punë e Sizifit. Sizifi është një person i cili e shtyn një gur të madh në tatëpjetë, pra është një punë jashtëzakonisht e rënë dhe duket në dukje e pakuptimtë, pra. Mirëpo, megjithatë të gjitha materialet që kanë të bëjnë me punët e komisioneve të ngjashme në shtetet tjera, në vendet tjera megjithatë dëshmojnë se ka pas një efekt. Pra, këto në njëfarë mënyre apo në mënyrë tjetër kanë ndihmuar që plagët në njëfarë mënyre të shërohen apo të përmbyllen do të thoja dhe në njëfarë mënyre të ofrohet mundësia e vazhimit të jetës duke qenë pranë njëri-tjetrit. Pra, po flas sidomos për trevat ku kemi të bëjmë me popullatë të ndryshme nacionale. Ishte interesant ajo se çka pash te komisioni. Pra, ndoshta kishte me qenë shumë me rëndësi për përbërjen e komisionit, qoftë rajonal apo si vendor, që të respektohet diçka që është shumë e rëndësishme e që ka të bëjë me përbërjen e anëtarëve të komisionit. Unë nuk e di përvojën e Bosnjës por unë do të doja që në Bosnje të jetë një përbërje multi-etnike në komision, nga se në atë mënyrë komisioni do të jetë shumë më valid. Ndoshta, dyshoj se kjo si se tillë ekziston. Unë nuk e di a do të ishte diçka e mundshme këtu në Kosovë të jetë. Ishte interesant, nuk e di a e vërejtët një grua e cila në fillim u drejtua te pjesëtarët e asaj popullate e cila kishte përjetuar atë që kishte përjetuar dhe i kishte dorëzat në duar, nuk e di a vërejtët. Kjo ishte diçka që mua më rrëqethi. Pra, një mënyrë komunikimi jo verbal, i pavetëdijshëm i saj i cili e krijon një distancë jashtëzakonisht të fuqishme në mes të saj dhe personave me të cilët ajo tenton të bashkëpunojë. Edhe të gjitha këto që u thanë më herët, njohja e gjuhës, e tjera, nuk janë elemente të cilat duhet të injorohen. Është shumë me rëndësi që në kuadër të komisioneve të ekzistojnë njerëzit të cilët i përkasin trevave, të cilët u përkasin kulturave, të cilët u përkasin mentaliteteve të vendeve me të cilat ata dëshirojnë të merren, pra problemet me të cilat dëshirojnë të merren. Është shumë me rëndësi pra, sipas mendimi tim, te ata anëtarët e komisionit të ekzistojnë jo vetëm kualitetet profesionale por unë do t'i quaja edhe kualitetet njerëzore. Njerëzit që kanë arritur që t'i luftojnë paragjykimet, njerëzit që kanë arritur që të jenë mbi urrejtjen dhe të shikojnë atë se çka ka ndodhë si një pjesë e jetës e cila si e tillë vazhdon, megjithatë, nga se ndoshta kjo edhe do të ofron një mundësi që komisioni të ketë një efekt shumë të fuqishëm në ndërgjegjen e të gjitha shtresave në popullatë duke filluar që nga ajo politike dhe duke vazhduar deri te ajo shtresë e cila në njëfarë mënyre apo në një tjetër ka qenë pjesë e përgjegjësisë së asaj që ne e quajmë veprim i një aparati shtetëror ndaj një vendi tjetër dhe gjithashtu te shtresat tjera të njerëzve të thjeshtë do të thoja, të cilët nuk janë të paktë dhe të cilët jo gjithmonë janë të informuar për të gjitha ato që kanë qenë të kryera nga pjesëtarët e aparatit të tyre shtetëror. Unë para një kohe kam pas bisedë me kolegët e mi nga Serbia, para disa viteve dhe më besoni se dyshimi i tyre, rezerva e tyre ndaj asaj se çka ka ndodhë në Srebrenicë, mua më ka mahnitë. Pra, edhe pse jam përpjekur që sado kudo t'i kuptoj arsyet, sepse ata e mohojnë atë se çka ka ndodhë, megjithatë e pas se prapa rezistencë është një propagandë, një akumulim i një propagande jashtëzakonisht të fuqishme e cila vite me

radhë edhe është krijuar në Serbi. Prandaj, edhe puna e komisionit do të ketë mundësi, ashtu unë e shikoj, që t'i bëj të njohura, pra t'i jetësojë si vuajtje, si tragjedi të njerëzve, si individë, si grup nga të gjitha anët, nga të gjitha trevat dhe në këtë mënyrë ajo ndërjegjja njerëzore e cila megjithatë ekziston të mobilizohet dhe të kërkohet që atyre njerëzve të cilët janë të prekur drejtpërsëdrejti nga lufta tu ndihmohet duke u zbuluar e vërteta. Pra, sa herë që i kam pyetur njerëzit me të cilët kam punuar dhe të cilët kanë përjetuar probleme nga lufta, në pyetjen time se çfarë ata kishin pas nevojë, thjeshtë ata vetëm thonë – dua ta gjej ku është dhe dua ta kuptoj të vërtetën, asgjë më tepër. Dhe e gjithë kjo, unë kisha thënë, është shumë me rëndësi të shikohet si një punë humane, një punë jashtëzakonisht humane edhe pse ajo si e tillë ka efekte, ka ndikime edhe politike, do të thojë, pozitive, megjithatë në fund të fundit është punë humane, punë njerëzore. Pra, punë e cila si e tillë dalëngadalë do të ketë mundësi të sjell sado kudo ndryshime pozitive në këtë drejtim, në një gjendje, do të thojë të amullisë, në gjendje të impotencës, të pafuqisë e cila si e tillë ekziston pothuaj në të gjitha vendet që kanë përjetuar luftë dhe që i përkasin shteteve të ish-Jugosllavisë. Pra, unë do të doja personalisht që të fillohet të formohet një trup i tillë dhe të funksionojë duke qenë në përputhje me nevojat e trevave dhe njerëzve të këtyre trevave. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit, zoti Lulzim! Tani ia japim fjalën Bekimit.

Bekim Blakaj: Faleminderit, Besarta! Në fakt, nëse më lejoni, unë desha vetëm disa sqarime shtesë, sepse për fat të keq shumica prej jush nuk keni pasur informacione paraprake për krejt këtë iniciativë, prandaj po ndihem pak i obliguar që krejt në pika të shkurtra të shpjegoj iniciativën. Edhe zotëri Çorbo, edhe Valdetja e përmendën se si ka rrjedhë iniciativa, e kështu me radhë. Mirëpo, në konsultimet paraprake që i kemi pasur, shumëkush ka pas pyetje – jo neve na duhen gjykata e jo komisioni, sepse komisionet janë trupa jashtëgjyqësorë, nuk i kanë do mandate, nuk kanë mandat me futë dikë në burg. Në fakt, Komisioni nuk është zëvendësim për gjykata. Ne besojmë thellë që Komisioni kishte me ndihmuar gjykatat dhe prokuroritë kudo që janë ato, në mënyrë që me ardhur më lehtë edhe tek dëshmitarët, edhe tek dëshmitë mbi krimet e kryera. Çështja tjetër që desha të ndalem, nga fjalimi i zotëri Arapit që e përmendi komisionin për Bosnje, e kështu me radhë. Kjo iniciativë është ndërmarrë për krijimin e një komisioni rajonal. Dy parafolësit e mi, do të thotë edhe zotëri Çorbo edhe Valdetja në mënyrë tërthorazi e përmendën arsyen pse. Megjithatë, luftërat në ish-Jugosllavi, duke e përfshirë edhe Kosovën kanë diçka të përbashkët, edhe pse ndoshta nuk kanë ndodhur të njëjtën kohë, mirëpo aktorët e luftërave në shumicën e rasteve janë të njëjtë. Unë e përmenda dhe mora një shembull sot në mëngjes për rastin në Podujevë që ka ndodhur. Ai njësit që ka bërë krime në Podujevë ka bërë edhe në Srebrenicë. Besoj se dikush prej juve ndoshta ka pasur mundësi ta shohë incizimin – video-incizimin e ekzekutimit të tre të rinjve boshnjakë në Srebrenicë, i njëjti njësit është. Urdhërdhënësit e tyre janë të njëjtë. Nëse kishim krijuar komisione shtetërore, të them, nacionale atëherë kam frik se nuk e kishim pasur fotografinë e qartë, nuk kishte qenë i lidhur i gjithë mozaiku. Prandaj mendojmë se vetëm një qasje rajonale kishte mund me krijuar mozaikun, do të thotë me nxjerrë fotografinë se çka ka ndodhur në shtetet që kanë dalë nga ish-Jugosllavia, duke përfshirë edhe shtetin e Kosovës. Dua ta falëndero zotëri Arapin, sepse e përmendi edhe çështjen e anëtarëve të Komisionit, diçka që është shumë me rëndësi. E këtu është puna që na pret neve si shoqëri civile. E për me shkua pak në mënyrë hap pas hapi, dua me përmend se Komisioni nuk është formuar. Këtë komisioni që po e duam ne, nuk është formuar. Ky

është një proces i gjallë, ka filluar, çdo ditë e më shumë na bashkëngjiten organizata dhe individë të shoqërisë civile sepse besojnë në këtë komision. Mandati i komisionit ende është në draft, end s'është i përfunduar, prandaj edhe këto konsultime shërbejnë aty, domethënë se ne shpresojmë që kemi marrë ide që në të ardhmen e afërt, diku në vitin e ardhshëm ne, shoqëria civile, iniciatorët dhe krejt koalicioni ta përpilojmë një draft e me atë draft me iu ofruar kuvendeve të të gjitha shteteve dhe me iu thënë – ne po duam këtë, që ju ta krijoni këtë dhe që komisionarët, ata që kanë me udhëheq me punën e komisionit kanë me qenë të propozuar prej neve, njerëz me një të kaluar të pastër, njerëz që nuk bien në ndikime politike, që kanë dinjitet, njerëzve që ne u besojmë. Do të thotë, kjo ishte shkurtimisht faza në të cilën gjendet krejt kjo iniciativë. Tash, dua ta përmendi vetëm edhe çështjen e medieve. I kemi shifrat, i kemi emrat, mirëpo, megjithatë të gjithë jemi genie njerëzore. Unë e kam pa, mund të them, afër dhjetë herë këtë film dhe secilën herë rrëqethna. Besoj se edhe te ju ka nxitur atë ndjenjë. Dhe, të gjithë njerëzit tjerë, që do ta shohin, ka me nxit këtë. Mediat e luajnë një rol shumë me rëndësi krejt në këtë proces nëse komisioni krijohet një ditë dhe nëse ka me pas dëgjime publike, ideja është që të dëgjohet gjithkund, jo vetëm në Kosovë. Ne në Kosovë i dimë shumicën e gjërave. Mirëpo, duhet këto të dihen edhe jashtë Kosovës. Unë personalisht kam pasur raste me u takuar me njerëz nga Serbia të cilët në fakt, ju e përmendët, mediat në të kaluarën kanë luajtur, besa disa edhe ende luajnë, një rol shumë negativ. E shtrembërojnë të vërtetën. Mirëpo, kur të dëgjosh prej gojës së viktimave se çka u ka ndodhë atëherë askush nuk mund të mbetet indiferent. E vërteta duhet të dëgjohet edhe më larg, jo vetëm te ne. Më falni që ju mora, ndoshta pak kohë, por shpresoj se ka shumë prej juve se do të marrë fjalën.

Besarta Vasija: Faleminderit, Bekim! Urdhëroni! Tash fjalën e ka Gazmir Raci.

Gazmir Raci: Ju faleminderit! Unë vetëm desha ta komentoj se u shtrua një pyetje rreth përbërjes së komisioneve, kush janë njerëzit që mund të jenë pjesë e komisioneve. Pasi dje kam qenë edhe në atë këshillimin që është bërë me Rrjetin e grupeve të grave dhe e kam pas këtë përgjegjësi, tash kisha dashur me ju ofruar disa prej informatave se si i kanë bërë këto punë komisionet në nivel botëror. Janë disa forma dhe disa mënyra se si zgjedhën njerëzit në komisione. Për shembull, forma e parë është caktimi apo emërimi nga ana e presidentit të vendit ose nga organi i cili është më i larti në një shtet. Do me thënë presidenti në këtë rast, me një dekret, qysh u tha më herët, vendos se cilët kanë me qenë personat anëtarë të atij komisioni. Forma tjetër është kur një shtet hap një konkurs publik dhe kur të gjithë njerëzit kanë mundësi me konkurruar dhe janë të barabartë për të qenë pjesë e atij komisioni. Ose është forma e tretë ku shteti krijon një këshill me panelistë të cilët thërrasin njerëz, i intervistojnë dhe në fund prej një numri të madh mund të vijnë deri te një numër që kanë me vendos për njerëzit më të mirë të mundshëm për të qenë pjesë e atyre komisioneve. Për shembull, desha edhe një rast me ua thënë. Presidenti i Guatemalës, ka vendos që kryetari i Komisionit për të vërtetën në atë shtet të jetë një profesor i njohur gjerman i së drejtës. Domethënë ka përjashtime ku shtetet dalin edhe nga shteti i vet, dalin jashtë atij rajoni dhe marrin njerëz me renome të cilët mund të kontribuojnë në proces. Pastaj, ka pas shumë pyetje se anëtarët e komisioneve a mund të jenë edhe njerëz që janë viktimë, që kanë përjetuar tortura të ndryshme. Ka raste kur kanë marrë pjesë dhe janë ftuar njerëz që kanë përjetuar vetë tragjedi të ndryshme, ose ka raste për shembull sikur që e pamë në këtë film, që një anëtar i komisionit vetë individualisht mori përsipër dhe kërkoi falje mbi krimet e zhvilluara në atë shtet. Domethënë këto janë

disa prej formave që shtetet në të kaluarën i kanë përdorur e ndoshta se edhe ne është mirë të mendojmë për të ardhmen, sepse tash kemi kohë dhe kemi me u takuar prapë besoj dhe me dalë me ide e propozime në mënyrë që të kemi sa më shumë mundësi në fund për të vendosur. Faleminderit, Besarta!

Besarta Vasija: Faleminderit, Gazmir! Nëse do dikush tjetër? Urdhëroni, zotëri Lulzim, ose zonja Gashi.

Miradije Gashi: Ndoshta s'ka nevojë të prezantohem prapë, por jam Miradije Gashi!

Besarta Vasija: Vetëm emrin ta thoni sa herë që flisni, për arsye se krejt këto incizohen dhe ne i transkribojmë këto dhe ne na nevojitet ta dimë çdo diskutues. Pra, vetëm emrin, nuk ka nevojë diçka më shumë.

Miradije Gashi: Nga Organizata joqeveritare "Venera". Më tepër i bëj disa pyetje si kureshtje për pyetjet që na i bëjnë neve vetë komuniteti. Prej gjithë këtij diskutimi unë diçka kam si të mjegulluar në këtë punë.

Më intereson përbërja e komisionit, çka është bërë deri tash si punë paraprake me përbërje të komisionit, çfarë do të jetë ai komision, a do të zgjedhet nga komuniteti, nga përvojat apo nga profesionet a si do të jetë, sa është numri i anëtarëve të tij dhe nga kush do të zgjedhët ky komision. Pra, pak diçka më konkretisht. Dhe, mundësisht sa më shkurtër, sepse po na marrin shumë kohë diskutimet.

Besarta Vasija: Urdhëroni, zotëri Pren!

Pren Marashi: Tash po nisem prej fjalëve të Salemit, së pari, për projektin e Bashkësisë Evropiane "Evropa pa luftë 1914" dhe 100 vjet po bëhen, 100 vjet luftë dhe 100 vjet dihet kush e ka nis luftën. Përrjashtojmë vetëm kohën e 41-ës, nga ajo që ka qenë Gjermania. Do të thotë 100 vjet e fundit, iniciatori - prej atentatit të Sarajevës e deri në luftën e fundit në Kosovë, ka qenë Serbia. Po dal te ajo pika kur thotë se kriteret janë gjendja faktike, jo arsyeja. Duhet me u dit edhe arsyeja se çfarë ka qenë. Dhe këtë për komisionet e ardhme, kur të formohet komisioni. Nuk mundemi të dalim vetëm te gjendja faktike me thënë kaq janë të vrarë, kaq janë të pagjetur e mos me dit arsyen kush e bëri dhe mos me u dit të akuzohet faktori aktiv kryesor i këtij akti. Rasti që ka dështuar Bosnja në Hagë për me dënuar Serbinë për gjenocid, kërkesa e cila ka mbet nëpër arkiva, e Kosovës, për ta dënuar Serbinë për gjenocid, shëtitja e kriminelëve të luftës, mbrojtja nga ana e institucioneve qeveritare të Serbisë të këtyre kriminelëve bie të dyshohet se ende, askund nuk jemi. Të dal te çështja tjetër, më e rëndësishme. Nuk më intereson përbërja e komisionit. Një fjalë e urtë popullore thotë – le të vjen me më pa ai që është rrëzua prej dardhe, Nasradini ka thënë kështu, kur kanë shkua me pa, ka thënë kush po do me ardhë me pa, ai që është rrëzua prej dardhe e di qysh është. Normal ai që ka qenë pjesë e asaj masakre, është pak më i njëanshëm, i duket dikujt se është pak më i njëanshëm, por e ka përjetuar në lëkur të veten, e di çka është me iu fsheh një krim që ia ka bërë dikush. Po dal te çështja e pajtimit, ajo që më preku më së shumti. Me siguri se i ka prekur edhe ata që i kanë përjetuar edhe krimet e masakrat dhe i kanë humbur të afërmit. Nuk munden, në këtë tavolinë, këta njerëz këtu që janë me kërkuar pajtim – se viktima nuk kërkon falje. Ju lutem, me pas kujdes. E kam për të ardhmen për komision. Ky komision nuk kërkon pajtim, ky komision nuk guxon me përmend pajtimin se je viktimë, viktima nuk kërkon falje. Ju faleminderit, besoj se me këtë e përmbylla, më nuk flas. Kryesuesja: Faleminderit, zotëri Pren. Urdhëroni, zotëri Lulzim!

Lulzim Arapi: Ndoshta edhe u keqkuptuam, nuk e di sa isha në gjendje me qenë i qartë. Në rastet kur konflikti ndodh, herë do kurdo konflikti duhet të përfundojë dhe përfundimi

i konfliktit është pajtimi. Nëse flas në aspektin profesional, për hir të mirëqenies së përgjithshme të viktimës pajtimi është shumë më tepër i nevojshëm për këtë se sa për dhunuesin. Është pak ironike dhe ndoshta paradoksale, sepse në njëfarë mënyre.... Këtë nuk do të doja tash ta elaboroj më tepër as që unë të kam ndërmend të flas diçka rreth kësaj në mënyrë të drejtpërdrejtë. Mua më intereson faktikisht që te viktima të përfundojë agonia, të përfundojë dhembja, të përfundojë i gjithë ai tmerri që ai e ka brenda dhe të mbyllet sidokudo plaga e tij, edhe pse ajo do të lë shenjë të përjetshme te ai. Përderisa viktima, zoti Pren, të ketë urrejtje në aspekt profesional ju lutemi ta mbajmë në mend se viktima nuk do ketë mundësi ta përmbyllë traumën sepse trauma edhe më tutje e mban viktimën të lidhur me agresorin. Prandaj, në këtë kontekst fola, për mirëqenien e personave të cilët janë të prekur drejtpërsëdrejti nga pasojat e luftës. Falja që u përmend këtu në këtë prezantim, ndoshta ishte më shumë kërkesë për falje si një individ i një shoqërie e cila nuk kishte qenë e vetëdijshme për atë se çka ka ndodhur. Përndryshe, kur është fjala për krimet e bëra në vendet për të cilat po flasim, atëherë falja duhet të vjen nga individët të cilët e përfaqësojnë strukturën shtetërore pra jo nga ndonjë anëtar i ndonjë organizate, e tjera. Sikur që ishte rasti te aborigjenët kur kryeministri italian u kërkoi falje aborigjenëve për të gjitha ato që sistemi dhe pushteti australian kishte bërë ndaj tyre me dekada e shekuj me radhë. Prandaj, në këtë kuptim, falja duhet të jetë e kërkuar në mënyrë shumë të qartë nga kreu i aparatit shtetëror dhe tek atëherë kjo mund të jetë një falje e cila mund apo të mos respektohet nga një popull. Nuk e di a isha i qartë, për çështje të pajtimit, apo jo.

Besarta Vasija: Urdhëroni, zoti Pren!

Pren Marashi: Po ua marrim ndoshta të drejtën tjerëve, por ky është debat publik dhe kur është fjala publike, ka peshë. Të jemi të kuptueshëm! E thash edhe më parë, dallon dhe po lidhem te ky filmi, që absolutisht nuk ka të bëjë me realitetin e Kosovës sepse realiteti i Kosovës është plotësisht tjetër. Ne kemi të bëjmë me të gjitha luftërat në ish-Jugosllavi me një agresor. E njëjta metodë e veprimit e cila asnjëherë nga institucionet e tyre nuk ka ardhur kurrë një kërkim-falje dhe me i thënë dikujt: a di çka, po kërkoi falje edhe për atë qeverinë që o kanë, më falni burra se i kemi vra. Te ne në Kosovë edhe satisfaksioni, nuk jam psikiatër, nuk merrem me mjekësi, e kam një lëmi tjetër. Prehja e qetësisë shpirtërore për mua vjen nëse dënohet kriminel. Dhe nuk do të jam në gjendje kurrë me ia falë. Vetë i kam mbajtur në duar, edhe fëmijët e pafajshëm i kam qitë në dhe, që i kanë vra ata. Do me thënë, këtë e keni përjetuar këtë figurë shumica e popullatës në Kosovë. Kjo nuk falet e aq më pak nuk kam drejtë unë me kërkuar pajtim me ta. Jo ai duhet me ardhë, duhet me kërkua... Tash po dal te politika, duhet t'i pranojnë institucionet në këtë rrethanë çfarë e kemi ne Kosovën me pranuar shtetin e Kosovës, duhet me bashkëpunuar me komisionin, me i dënuar kriminelët. Dhe, çështja se kush do të jetë anëtar i komisionit nuk është absolutisht me rëndësi. E mira është të merren njerëzit që kanë vuajt, anëtarë të komisionit që dot ë formohen në këtë komisionit patjetër dhe absolutisht nuk kanë me mund kurrë me bë asgjë nëse nuk e kanë përkrahjen shtetërore institucionale sepse të bllokojnë. Ti mundesh me marrë ndonjë donacion prej faktorëve ndërkombëtar dhe tjetër, por kur vjen puna me bashku me lokalitet ke me qenë i bllokuar. E rëndësishme është që procesi të ecë përpara dhe ata kriminelë mos ta ndiejnë veten të çlirë në Beograd sikur që e kemi pas Karaxhiqin deri tash e tash e ke ende Mlladiqin e shumë e shumë tjerë, por t'i dënojmë ata kriminelë për ato krime që i kanë bërë dhe me siguri se ka me qenë edhe rasti më i rëndë psikik, nuk ka me mund me u

shërua edhe pse dënohet ai, sepse ai e ka vuajtjen, trauma e luftës e di vet qysh shërohet. Dashtë zoti që ju ecë puna mbarë. Puna e mbarë ju qoftë! Vazhdoni!

Besarta Vasija: Faleminderit, zoti Pren! Tash ia jap fjalën Valdetes.

Valdete Idrizi: Më luten që të jem shumë e shkurt dhe po provoj të jem e shkurtër. Nëse më keni dëgjuar me kujdes e me vëmendje, e thash se ky është proces. Unë personalisht si një përkrahëse e këtij procesi nuk e di qysh ka me u duktë komisioni tash. Për këtë edhe po diskutojmë. Unë i di arsytet për të cilat dhe i përmenda pse fuqimisht e përkrah idenë me pas komision dhe kush kanë me qenë komisionarët. Njëherit pra do t'i caktojme kriteret. Duhet të jenë sikur që i përmendi më herët Bekimi, s'po dua me u lëshua në to.

Edhe çështjen e pajtimit, që qëllimisht e përmenda, sepse është diskutuar shumë gjatë edhe më parë dhe pa dashtë me marrë kohë rreth diskutimeve të shumta "pro" dhe "kontra" fjalës pajtim, do me thënë edhe me qartësua se çka po duam ne prej këtij komisioni. Thjeshtë dhe qartë është dhe për këtë edhe është shkruar dhe edhe një herë po e them ideja është për komision rajonal për të vërtetuar dhe përcaktuar krimet e luftës në ish-Jugosllavi dhe shkeljet tjera. Do të thotë procesi i pajtimit është tjetër dhe pajtohem në përgjithësi me procesin e pajtimit, ka efekt mirëpo qëllimi i këtij komisioni është kryekëput kjo çka po themi tash. Edhe, sa i përket filmit. Qëllimi i prezantimit të këtij filmi nuk është të jetë vetëm model. U përmend disa herë, e përmendët edhe ju zoti Arapi. Qëllimi është vetëm të kuptohet se qysh ka funksionuar një komision, sepse u tha më herët, është herë e parë në botë, në historinë botërore të krijimit të komisioneve që po tentohet të krijohet një komision ku marrin pjesë të gjitha këto shtete, të gjitha këto qeveri. Gjithkund pra, brenda një shteti, ka ndodh. Kjo është sfidë në veti. Mirëpo, sikur që e tha dikush në film, s'kam besua kurrë që mund të realizohet kjo, s'kam besua se kanë me dalë të gjitha këto fakte dhe është realizuar. Kjo më nxitë mua me shty këtë proces dhe me përkrah këtë proces. Shumë njerëz, gjatë konsultimeve, që edhe s'e kanë përkrah. Kanë dalë, kanë shkruar kundër sepse kjo po vjen prej Beogradi si iniciativë, kështu e ashtu. Ka domethënë njerëz që nuk e kanë të qartë, sikur disa prej juve që keni ardhur nuk e keni të qartë dhe qysh nuk e kam pas as unë të qartë çfarë është ideja, çfarë tentohet të arrihet me komision. Mirëpo, ka edhe grupe të tilla njerëzish që prej mos punës së tyre, domethënë, menjëherë gishtin e qesin te tjetri, qysh e thash më herët, pa e qit te vetvetja. Nën një. Qëllimi është edhe të qartësohet sa më mirë që është e mundshme komplet ideja e krijimit të këtij komisioni. Dhe nën dy, sikur që e thash më herët, hajde ta krijojmë bashkë dhe ta qesim në ata binarët më të mirë të mundshëm. Faleminderit!

Kryesuesja: Faleminderit, Valdet! Fjalën e ka kërkuar zotëri Salem Çorbo. Urdhëroni!

Salem Çorbo: Unë ndoshta e kam lënë pa e thënë një pjesë kur e prezantova projekt idenë për Bashkimin Evropian dhe më duket se kam harruar të them se kemi të bëjmë me vitin 1914 dhe kohën kur vendet e këtij rajoni do të pranohen në Bashkimin Evropian. Pra, viti 2014 dhe do të përmbyllet ajo periudha njëqindvjeçare e luftërave. E kam lënë këtë pjesë pra për të qenë më i qartë dhe të them se për ç'arsye Evropa në këtë mënyrë, në mënyrë shumë simbolike dëshiron ta shënojë këtë periudhë dhe të dalim e të nisim një periudhë të re. Shkurtimisht, të them edhe diçka rreth kërkim-faljes dhe rreth mandatit të komisionit. Ende kjo është në fillim e sipër. Ne i theksojmë nevojat, synimet tona. Forcën mund ta japë shteti, legjislacioni në raport me këtë komision dhe sektori joqeveritar nuk mund ta bëjë këtë. Ne këmbëjmë informacione dhe ky duhet të jetë një institucion i fortë, që ka fuqi. Të gjitha këto komisione kanë marrë mandat dhe kanë dokumentuar 10 mijë raste. Shoqëria praktikisht as që e ka dit, bie fjala në këtë rast, të filmit se çka ka ndodhur

dhe kemi të bëjmë këtu me një bashkësi dhe paramendoni këtu çfarë dallimi ka, kemi një mozaik të rëndë të të gjitha ngjarjeve. Diçka rreth kërkim-faljes. Plotësisht i kuptoj viktimat dhe i përkas këtij grupi dhe e di saktësisht atë tragjiken që bartin ata, atë dhembje, atë traumë. Shkenca thotë se kjo është e pashërueshme, vetëm ai varianti i ndrydhjes apo i mjekimit dhe ilaçi është ai shoqëror dhe duhet në aspektin shoqëror pikësëpari të mjekohet, të shërohet. Kur flasim për kërkim-falje, mendoj se ka pasur një diçka të këtillë edhe më herët dhe këtë e kemi parë se ka ekzistuar një cinizëm i ri. Unë, dhe me siguri edhe të gjithë do ta ndjej këtë kur krahas kërkim-faljes pason ndryshimi i tërësishëm i vlerave shoqërore në raport me viktimën dhe kur çdo segment i shoqërisë do të ketë një qëndrim tjetër. Dhe, kur opinioni të njoftohet dhe për reparacione mos të pritret me vite të tëra dhe i tërë sistemi shoqëror të riorientohet dhe kur të hetoni atë sinqeritet të bashkësisë shoqërore dhe veçmas kur kërkohet falje në mes të popullit dhe shtetit është diçka e lehtë të thuhet, të kërkohet falje dhe unë këtë e shoh si diçka shumë cinike. Ajo fotografia e parë për të cilën unë fola, është fotografi për të vërtetën dhe kur dikush thotë se nëse mjafton e vërteta, unë me qëllim e qita këtë shembull. Këtë të vërtetë, 17 vjet bota e ka parë, e ka parë kush është viktimja, e ka parë atë familje. Mirëpo, a është më lehtë për atë familje që e tërë bota e di që familja e saj është vrarë kështu, dhe që i sheh fytyrat e vrasësve. Dhe një pyetje hipotetike, ti lëmë të gjitha dokumentet. Çka ka në këto familje? Unë nuk jam psikiatër, por mendoj se e gjithë kjo e shton atë traumën, e rritë traumën e tyre. Pra të gjithë e dinë, por asgjë nuk ndërmerret. Kemi deklaratën për të drejtën e njeriut, jemi në prag të Bashkimit Evropian dhe tani diçka do të them për drejtësinë dhe mund ta them rastin tim personal, sa i përket drejtësisë, është fjala për vëllanë dhe kunatin tim, janë vrarë nga një organizatë paraushtarake në Bjelinë dhe vrasësit janë proceduar dhe i kanë marrë 20 vjet burg në Bijelinë në vitin 1995. Nuk janë vrarë për krim të luftës por për lakmi materiale, sepse pasi i kanë vrarë u kanë marrë edhe para. Dhe, këta të akuzuar për katër raste, janë akuzuar dhe janë vrarë 14 veta dhe secili prej tyre ka marrë 20 vjet burg. Dhe të ju them pse nuk jam i kënaqur me këtë. Është një fëmijë 17 vjet e gjysmë dhe tjetri që këtë e ka bërë ka qenë edhe më i ri dhe nuk e kisha thënë se cili shërbim e ka caktuar këtë nëse sigurimi shtetëror apo kush, dhe në fshatin e tij, në vendin ku ai ka jetuar i është thënë se shtëpia i është ndezur dhe ia kanë dhunuar e vrarë nënën dhe motrën dhe se janë kolegët e tij dhe në këtë vend nuk ka pasur qasje dhe ai i doktrinuar në atë periudhë i ka bërë këto katër vrasje me ç'rast janë vrarë 14 veta. Mendoj se drejtësia në këtë mënyrë i ka heshtur gjërat, i ka keqpërdorur këta fëmijë që nuk kanë qenë të moshës madhore, pra është një shprehje e moshës madhore që me 17 vjet e gjysmë të bëjë 14 vrasje dhe për këtë kanë menduar se shoqëria do tu jetë mirënjohëse që i kanë vrarë myslimanët dhe kanë menduar që shoqëria në atë moment do t'i valorizojë si vlera dhe ata janë shqetësuar shumë kur kanë përfunduar në gjykatë dhe në fund të gjykimit e kanë parë se nuk është ashtu siç kanë menduar. Pra, drejtësia disi është përmbushur por jo vetë esenca. Dhe kur flasim për vetë esencën dhe rreth karakterit të luftës, kjo është çështje e gjykatave. Ne e kemi të qartë se kush çka ka qenë. E dimë se njerëzit kanë qenë nga një shtet tjetër në këtë qytet dhe natyrisht se me vetë këtë fakt çdo gjë është e qartë. Mirëpo, që të mos ngecet puna këtu në fillim, ta ndjekim këtë rrugë, mos të pyesim kush çka ka bërë dhe kush nga është por të flasim haptas për këto probleme, të hapim çështjen e këtij komisioni, t'ia përcaktojmë mandatin sepse, të jeni të sigurt, nëse me pjesëmarrjen e bashkësisë ndërkombëtare të jetë e vendosur dhe të punojë siç e pamë në këtë film rezultatet do të jenë shumë më të çmueshme se sa ne të

shkapërderdhemi, sepse dikush nuk dëshiron të pranojë nëse ka qenë agresor, okupues, sulmues dhe që në fillim një ide paraprakisht ta humbim. Kaq.

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni, kush dëshiron tjetër? Urdhëroni, zonja Lale.

Lale Grabanica: Po më vjen mirë që po diskutohet mënyra e funksionimit dhe çështjet tjera të formimit të komisionit. Sipas meje, këtë komision e shoh më tepër si çështje humane duke pasur parasysh se këtu është duke u diskutuar dhe jam duke parë se jemi duke e marrë disi si me skepticizëm formimin e këtij komisioni. Në fakt, mirë është nganjëherë edhe të dyshohet, të paraqiten dyshimet, duke pasur parasysh se ne na kanë ndodhur shumë komisione, pa rezultate dhe të gjitha tjerat. Po, unë kisha dashtë të them diçka se, çfarëdo komisioni që të formohet ose si të jetë, ne nuk duhet të frikohemi prej së vërtetës, me dëshmuar të vërtetën. Këtu është problemi. Dhe duhet të jemi të vetëdijshëm se, në rast që një komision insiston në keqpërdorime ose në mosdhënien e rezultateve, prapë ne do të jemi ata që e kemi dëshmuar të vërtetën dhe këtu e shoh rezultatit dhe dua me besua dhe e dashtë zoti se këtij komisioni t'i ofrohen njerëzit sepse ky komision, konsideroj, nuk është duke kërkuar diçka me krijua, por është duke kërkuar me treguar dhe ajo vërtetësi me u arkivua dhe aq më tepër më bën të besoj kur e ka parasysh multi nacionalitetin. Sepse ne në komisione, brendapërbrenda kemi formuar, dhe asnjëherë s'u kemi besuar komisioneve tona, po jemi të prirë për me u besuar këtyre multinacionaleve, multi kulturoreve e të gjitha atyre, por shpresoj se do të na jepet rasti t'i besojmë edhe këtij komisioni, ta përcjellim, po ende është një nismë e mirë. Meqenëse jemi popuj me përvoja të njëjta, me ngjarje të njëjta, nuk besoj as nuk kam pse me dyshua në atë drejtim, sikur që u tha aty ai skepticizmi – pajtimi, mospajtimi, falja e tjera. Një herë është problemi me i zbuluar dhe sa më parë t'i qesim në letra ne ato faktet që na kanë ndodhur. Jemi mësuar vetëm me fol, ndoshta edhe pa argumente. Fakt është ajo që është brendapërbrenda një popullate ai problemi që u shfaq, por hajde, a është brenda popullate sistemi i njëjtë, e ashtu... Dhe, kur të na krijohet shansi, mos ta krijojmë atë bindjen se gjithçka duhet me kundërshtuar. Të japim shans, të provojmë dhe kush ka çka të ofrojë mirë është të ofrojë. Na të keqpërdorurit duhet të reagojmë aty.

Besarta Vasija: Faleminderit, Lalo! Urdhëroni, kush do fjalën? Po, zotëri, urdhëroni!

Atdhe Berisha: Prej OJQ "Kalaja". S'kisha dashur ta stërzgjas, po u prolongua krejt rreth themelimit të komisionit dhe mandati i tij. Mirë është të formohet ky komisioni dhe siç tha zonja Lala me u qit në letër ata që kanë bërë krimet e mandej tani vendoset qysh. Po nganjëherë kur po thirremi në emra të mëdhenj, siç është Bashkësia Evropiane e disa emra tjerë, po ka pak pengesa këtu. Thuhet se deri në vitin 2014 Evropa po dojka me i bë 100 vjet pa luftë e ku ta di unë. Është një problem! Evropa ka në gjirin e vet edhe Greqinë një shtet që ka bërë krime mbi shqiptarët dhe është një problematikë se ende s'e ka zgjidh. Shqipëria është një shtet tjetër i pavarur dhe anëtar i NATO-s por në gjendje lufte faktikisht me Greqinë në aspektin e dokumentacionit, sipas Parlamentit grek. Këto janë probleme. Le t'ia lëmë politikës punën e tyre, ne mos të merremi me politikë, t'i gjejmë kush ishin përgjegjës në krimet që u bënë e pastaj, për sa u përket kërkim-faljeve e tjera, ka kohë. Francezët dhe gjermanët pritën shumë vjet, gati 30 dhe sot janë mirë ndër veti, ndoshta edhe ne, falë gjeneratave të reja, pajtohemi, s'është problematike. Kjo është ajo, sepse kur po thirremi në emra të mëdhenj, po kam probleme. Edhe sa i përket filmit, një sqarim krejt të shkurtër. Kam mbarua pak për gjeografi e histori, e shpjegoj shpesh për Perunë, tash e kisha mësimin e parafundit. Nuk është një etnitet në Peru. Në Peru jetojnë shumë etnitete, nuk i dallon vetëm gjuha por prejardhja, pastaj gjuha, doket e zakonet.

Aty nuk është bërë krim vetëm brenda shoqërisë por ka pasur krime edhe nacionale, për shkak se popujt e Andeve janë popuj tjerë në krahasim me spanjollët që kanë ardhur më vonë. Faleminderit! Kryesuesja: Faleminderit, zotëri Adi! A ka dikush përgjigje, komente, propozime. Po mendoj, ndihuni të lirë dhe nëse keni ndonjë propozim ose se si është dashur të duket mandati i këtij komisioni dhe nëse ju keni ndonjë ide se cilët duhet të jenë hapat e ardhshëm për këto procese. Po, urdhëroni zotëri Pren.

Pren Marashi: Që nga përfundimi i luftës e deri më sot, do të thotë, përveç Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut edhe organizatat e ndryshme joqeveritare janë marrë me grumbullimin e fakteve, shënimin e emrave të kriminelëve të luftës e krejt. A e besoni një fakt se i vetmi institucion – komisioni institucional që është, për shembull në kuvendin komunal në Pejë, s' di se a është këtu ai përfaqësuesi apo e ka deleguar dikë, ai nuk i ka shënimet që i ka Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, ai nuk i ka shënimet që i ka për shembull Organizata e Veteranëve të Luftës, nuk i ka të Fondit. Do të thotë duhet në atë mënyrë si duhet. Tërë jemi shkuar ne duke grumbulluar secili për veti shënime dhe nuk e kemi gjet ende pikën grumbulluese ku me i dorëzua. Të gjithë jemi duke i mbajtur për veti. Kjo është mangësi shumë e madhe. Është dashur me i centralizuar, apo çdo njëri për veti me i marrë ato shënime dhe me ia dhënë, për shembull sikur që është komisioni, zyra për të pagjetur dhe zyrat pranë kuvendit komunal, po. Hajde ta fuqizojmë, t'ia japim këtij e ky le t'i gjej. E tash, pasi ka dështuar këtu, prapë po lëmë fajtor shoqërinë civile në këto pjesë. Duhet qitur edhe vetën aty për këtë. Do të thotë unë nuk ia kam dhënë atij, ai nuk mi ka dhënë mua. Ndodh, për shembull dhe jam i bindur 100% vetëm që i ka marrë prej Këshilli për të Drejtat e Njeriut, veç Kuvendi komunal nuk e di saktësisht, komisioni e kam fjalën saktësisht sa vetë, as nuk e dinë në qeveri as nuk e dinë përkund. Pse, sepse çdonjëri i ka grumbulluar shënimet për veti dhe nuk i ka centralizuar. Edhe kjo është mangësi. Komisioni s'besoj se ka me mund tash me ardhur me i mbledhë të gjitha, por ia keni nisë mirë, i keni mbledhë, por ka me qenë problem, sepse Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut nuk e pas sot këtu. Nejse, ju faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit, zoti Pren! Sa për informatë, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ka qenë i ftuar por nuk ka pranuar me ardhur. Tash fjalën ia japim zonjës Sanije Mavraj.

Sanije Mavraj: Njësitë për të drejta të njeriut në komunën e Istogut. Në fakt, unë jam shumë e kënaqur me iniciativën që është marrë nga këta njerëz. I përsëritës! I përsëritës edhe pjesëmarrësit. Ndihej e nderuar që jemi ftuar, do të thotë, jemi afruar shoqëria civile dhe njësitë për të drejta të njeriut, në fakt pushteti. Njësitë për të drejta të njeriut, njësitet në fakt, janë të themeluara në të gjitha komunat e po ashtu edhe në të gjitha ministrinë dhe sigurisht për këtë jeni në dijeni. Është edhe zyra pranë kryeministrit. Njësitë për të drejta të njeriut ka misionin ndërlidhës në mes pushtetit dhe shoqërisë civile. Njësitë për të drejta të njeriut bën hulumtimin e të gjitha formave të dhunës, të ushtruara nga aparatet shtetërore. Po sa të foli për misionin e të drejtave të njeriut, sigurisht për këtë jeni në dijeni, dhe mos të bëhem e tepërt, por një iniciativë e mirë ose provokim i mirë ishte i zotit Pren Marashi sepse të gjitha njësitë, të gjitha grupet formale dhe jo formale kanë bërë hulumtime të dhunës nga pushteti serb dhe i kanë ato shënime. Njësitë për të drejta të njeriut, fakt është se nuk i ka, apo dikush i ka e dikush jo, por unë flas për njësitin e të drejtave të njeriut në Istog që është duke bërë një hulumtim mirëpo duhet të jemi shumë të kujdesshëm në qasjen e këtij problemi sepse për të marrë këto të

dhëna të gatshme që dikush i ka duhet një vetëdijesim sepse ai grup ka bërë një punë për të cilën pushteti një kohë nuk ka qenë aq azhur ose nuk ka qenë i mjaftueshëm krahas problemeve tjera, shumë madhore. Kjo ndoshta ka mbet pak anash por me faktin se tash janë këto njësite, kishte me qenë e udhës që bashkë me komisionin që do të themelohet dhe që për këtë e përgëzoj, të bëhet një simbiozë ose një bashkëpunim në mënyrë që të dalim me një organ të fuqishëm dhe ta kemi një adresë të fortë ku mund të paraqiten problemet e dhunës të çfarëdo lloji, e sidomos duhet patjetër t'i japim përparësi kësaj forme dhune për të cilën ne po diskutojmë. Sepse, është një brengë e madhe e jona dhe jemi të gjithë ata që e kemi përjetuar këtë dhunë, ka këtu plotë njerëz për të cilët kurrë nuk e kanë pasur një adresë të saktë, së paku për një rehabilitim moral pa e neglizhuar punën e kompetentëve, punën e njerëzve tjerë. Krejt çka desha të them, është se të gjitha këto grupe të cilat kanë këso të dhëna kishte qenë mirë t'i grumbullojnë, është shumë humane nga ana e tyre dhe pastaj të kërkojnë përgjegjësi prej atij organi të cilin këta e kanë autorizuar. Ju falënderoj!

Besarta Vasija: Faleminderit, zonja Sanije! Desha edhe unë të flas dy-tri fjalë.

Është ideja që ky komision, do të thotë, nëse formohet, të bashkëpunojë me të gjitha organizatat joqeveritare, me të gjitha shoqatat të cilat kanë informata, kanë të dhëna, kanë shënime dhe t'i grumbullojnë ato. Do të thotë ky është një qëllim me i mbledhë të gjitha informatat dhe pas kësaj këto me i proceduar. Dikush tjetër, nëse ka ndonjë pyetje, komente? Mirë! Zonja Miradije. Po ju përgjigjem. Është ajo që ne ende nuk mund të dimë se si ka me qenë përbërja e komisionit, kush ka me qenë si komisionarë. Ky është do të thotë një hap tjetër. Ne tash jemi në procesin e konsultimeve se pse ne na nevojitet ky komision rajonal dhe të marrim ide të ndryshme se si duhet të duket mandati i këtij komisioni, cilat janë nevojat tona si shoqëri. Unë mendoj se për përbërjen e komisionit dhe cilët kanë me qenë komisionarë dhe kush ka me i zgjedhë, ne mund të marrim ide prej juve dhe pastaj i mbledhim këto dhe ia kemi dhënë formën atij komisioni se si do të duhej të duket. Fjalën e ka zonja Sabrije Zeqaj. Urdhëroni!

Sabrije Zeqaj: Unë e përgëzoj zotëri Prenin që po diskuton kaq me elan dhe atë zotëriun atje, Arapin po edhe të tjerët. Ideja ime, nga një eksperiencë prej 1983 që e kam si person me aftësi të kufizuara, e kisha dhënë një propozim që këta persona të cilët do të jenë të përfshirë në komision dhe si rrjet i OJQ-ve që veprojnë të merren CV-të e tyre, veprimtaria, kontributi dhe të gjitha tjerat sepse ne, si të them, po prezantohemi si organizatë e faktikisht një organizatë duhet të jetë organizatë që ka një veprimtari, që ka një dëshmi që e ka dhënë kontributin e vet për mirëqenien e të gjithëve. Prandaj, në këtë rast, unë mendoj se duhet të jenë të përfshirë në atë komision njerëz të cilët do të japin kontributin e vet maksimal dhe duke u dëshmuar dhe nëse është nevoja edhe me kontribut që do të veprojnë ndoshta pa u lodhur për të hulumtuar rastet dhe nëse ata persona, që posedojnë dëshmi apo kanë të dhëna statistike t'i ofrojnë ato dhe të përkrahin atë komision dhe ky këshill të funksionojë mirë dhe të jetë sa më efektiv dhe ta ketë një punë më të suksesshme. Sepse, unë e di që në komunën tonë në Pejë dhe në regjionin tonë ka të dhëna dhe ka dëshmi që i posedojnë njerëzit të cilët janë marrë, sikur zotëri Preni dhe shumë tjerë, në komunë që janë, i kanë dëshmitë, i kanë faktet, kanë të dhëna dhe besoj ata njerëz do të jenë ata persona që do të kontribuojnë mjaft në këtë lëmi, e jo të kyçen persona që s'marrin absolut vesh as nuk u intereson por i këqyrin interesat e veta personale. Kaq dhe ju përsëndes.

Besarta Vasija: Faleminderit, zonja Sabrije! Tash e ka fjalën Vetoni. Atëherë, fjalën e ka Bekimi.

Bekim Blakaj: Faleminderit, zonja Sabrije! Ndoshta s'patëm kohë të mjaftueshme me shpjeguar se si funksionon një komision ose së paku në të kaluarën si ka funksionuar. Komisioni, varësisht prej vendeve të ndryshme, ka pas numër të ndryshëm të anëtarëve. Gjithsesi komisioni duhet me i pas grupet e ekspertëve prej të gjitha lëmive, prej psikologëve, prej juristëve sidomos. Do të thotë të gjitha grupet. Dhe, ata udhëheqin me komision – komisionarët. Mirëpo, gjithkund, në secilin komision që ka ekzistuar deri tash, komisioni pastaj ka angazhuar staf tjetër. Ka pas komisione deri me 600 anëtarë, hulumtues, ata që kanë bërë intervista, ata që iu kanë dhënë përkrahje viktimave gjatë dhënies së dëshmimeve. Ata zakonisht kanë ardhur prej sektorit jo qeveritar, prej organizatave për të drejta të njeriut që kanë marrë dëshmi në terren dhe prej shoqatave të familjarëve të viktimave kanë qenë ata që iu kanë dhënë përkrahje viktimave gjatë dhënies së dëshmimeve e kështu me radhë. Do të thotë, struktura e komisioneve mund të jetë shumë e ndërlikuar. Bile ka pasur komisione të ndryshme që janë ndarë në departamente të ndryshme, prej atyre ka pasur departamente që janë marrë vetëm me futjen e të dhënave, që u përmend baza e të dhënave, që është shumë me rëndësi. Do me thënë kanë qenë njerëz ekspertë të statistikës e kështu me radhë. Domethënë ka hapësirë për një numër shumë më të madh të njerëzve që punojnë në komisione. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit, Bekim! Unë ju kisha ftuar të gjithëve të bëni pyetje për çka do që nuk është e qartë për ju. Kjo është hapësirë që ju jepet juve për të pyetur më shumë rreth iniciativës ose për t'i dhënë mendimet tuaja. Unë kisha dashur të kyçen edhe tjerët në këtë debat. Urdhëroni, Valdete!

Valdete Idrizi: Sa i përket pyetjeve, mendoj se gjithë ka me pas pyetje që kanë me pas përgjigje që ndoshta s'na pëlqejnë, si me rastin që nuk di, nuk di asnjëri qysh ka me u duktë ajo. Do të thotë mendoj, mos të presim diçka çka nuk dimë, ose mos të presim diçka prej këtu, prandaj qasja e përgjithshme është shumë e mirë. Mua më pëlqeu ajo që u përmend çështja e grumbullimit të të dhënave. U përmend disa herë e dhe përpara, do të thotë që KLMDNJ – Fondi dhe shoqatat, po më duket të tri shoqatat e dala nga lufta, edhe e dëshmorëve, e veteranëve dhe e invalidëve kanë bazë të të dhënave...

(Ndërhyrje)

Po, mendoj se cila i ka të vetat, por megjithatë prapë janë bashkë. Pikërisht Bekimi që e përmendi kohën e shkurtër, sikur kur thoshim me mbajt vajzë, me mbajt ligjërata e me shpjegua krejt qysh ka ndodhur dhe shpresoj se keni me i lexuar këto dhe bukur disa sende kanë me u sqarua. Ndoshta disa prej pyetjeve që edhe unë dhe tjerët i kemi e që nuk po i dimë përgjigjet dhe veç kemi me i definuar, do të thotë në kuadër të procesit duke pasur ekspertë të ndryshëm. Ai zotëriu Eduardo Gonzales që doli atje përpara, unë kam pasur rastin dy herë në trajnime që ai ka organizuar me marrë pjesë dhe me i bë disa pyetje direkte. Ai ka qenë vetë, do të thotë prej përvojës së vet, mirëpo edhe njohës i mirë i të gjitha komisioneve. Edhe ai, në rastin tonë, konkretisht kur e pyeta, do të thotë se qysh kishte me u duktë sipas tij, ai më tha mua – s'di, qysh kishte me u duktë. Prandaj, duhet me i mbledhë të gjitha forcat, po edhe kur është fjala për ata hulumtuesit në terren. Të gjitha këto forca, të gjitha këto organizata me një bagazh të madh që janë dëshmuar që kanë punuar duhet me i mbledh forcat dhe me punua bashkë. Veç kështu do të thotë krijohet edhe informata, shpërndahet informata dhe vërtetohen të gjitha ato faktet. Faleminderit!

Besarta Vasija: Urdhëroni, zonja Lale!

Lale Grabanica: Për me ta vërtetuar, Vali e tha. Unë kisha me thënë se mos të ishte Këshilli për të Drejtat e Njeriut me dhënë fakte, argumente me siguri se s'kishim ardhë deri këtu. Nuk është një punë që nuk ia dimë rëndësinë, por është një punë sa e kemi vullnetin me punua në atë drejtim. Nuk jemi pa përvojë në atë drejtim. Për këtë, dua me thënë, po më vjen shumë keq se jemi duke debatuar rreth këtyre çështjeve... Nuk janë vetëm organizatat jo qeveritare, më së paku kanë informata ndoshta organizatat joqeveritare, sepse nuk jemi së bashku dhe nuk kemi kulturë. Mua po më vjen shumë mirë që ka me u ndërtua në këtë drejtim edhe një kulturë e mbledhjes ose e grumbullimit të informatave dhe azhurimi, arkivimi i tyre. Ne kemi, po them dhe me secilin që të rrish ke me marrë diçka prej tij, por sa jemi këtu se është duke më pëlqye shumë kjo iniciativë sepse kemi me u mësua me dit me qit dhe me arkivuar diçka, me lënë një testament, një moment, një histori që nuk argumentohet ajo zhduket. Prandaj edhe në gjithë jetën tonë i kemi pas këto probleme, sepse kemi hezituat, i kemi ditë dëshmitë, i kemi njohtë gjërat e s'i kemi publikuar, sepse kur të vdes njeriu s'ka çka me dëshmuat. Thoni sa të duash, tamam o kanë baba im, kështu e ashtu, ku e kemi, kështu që unë po besoj se jemi duke ndërtuar edhe një kulturë të arkivimit, të ruajtjes së të dhënave e kështu me radhë. Faleminderit! Më falni...

(Ndërhyrje)

Po, këtu është problemi. Ne sikur kur frikohemi të tregojmë të vërtetën. Unë e përmenda dhe po më vjen shumë keq që po ju marr kohë. Unë e përmenda edhe çështjen e ngritjes së padive. Po kur kanë filluar ata më të mençur se ne... Po ne të mençur jemi boll, por për vetveten s'punojmë si duhet... Kur kanë filluar ata me ngrit aktpaditë nëpër secilën komunë për asgjë hiq, për një lopë që u ka cofë, ne s'kemi ngritur padi dhe e dimë shumë mirë, unë jam shumë e njoftuar me ato s'kemi luftuar me nxitë njerëz me ngritë padi ndaj krimeve që janë bërë. Kur kanë filluar serbët me ngrit padi atëherë është shtuar numri i ngritjes së padive. Faleminderit, më falni!

Besarta Vasija: Po, por pas këtij zotëriut, jeni ju. Më fal, prezantohuni!

Veton Berisha: Faleminderit për fjalën! Jam Veton Berisha, vi nga Programi për të drejtat civile në Kosovë.

Ju përgëzoj për këtë iniciativë. Po vërej se kjo iniciativë është nismë e shoqërisë civile. Po më intereson me ditë cili është bashkëpunimi në këtë fazë tani ku jeni me organet qeverisëse pasi që mendoj që është i domosdoshëm bashkëpunimi. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit për pyetjen. Në fakt, kur ka filluar krejt kjo ide, qysh me thënë më thjeshtë kemi dashtë së pari me u konsultuar me shoqërinë civile, me parapërgatit edhe draftin e mandatit të komisionit e mandej me iu qas institucioneve. Po dua me thënë që ende zyrtarisht nuk i jemi afruar institucioneve ose qeverive ose kuvendeve mirëpo kemi pasur kontakte. Kemi pas kontakte, që e përmendi edhe Vali gjatë prezantimit të saj që në secilin vend kur janë mbajtur forumet në hapje të forumit kanë marrë pjesë bartësit e institucioneve. Në Bosnje ka qenë kryetari, në Kroaci gjithashtu kryetari Mesiq, në Serbi ka qenë kryetari i Kuvendit, në Kosovë e kemi pas kryetarin e Republikës së Kosovës dhe zëvendëskryeministrin e kështu me radhë, të cilët gjithashtu edhe në forumin e fundit në Mal të Zi, ka qenë kryetari i Kuvendit. Po thuaj se të gjithë. Vetëm po dua me sqarua. Në dy forumet e para nuk ka qenë strategjia aq shumë e zhvilluar, do të thotë, për një komision. Atëherë, edhe titulli i forumit ka qenë

“Drejtesia tranzicionale”. Mirëpo bashkërisht me të gjitha organizatat të cilat janë pjesë e koalicionit tanimë, jemi konsultuar dhe kemi ardhur deri te një hap përpara.

Po dua me thënë, se në princip e kanë përkrahur. Mirëpo kjo s’do të thotë se do ta pranojnë ashtu qysh e dorëzojmë ne idenë për mandatin e komisionit. Mirëpo, tash pas konsultimeve gjatë këtij viti, vijmë në atë fazën ku duhet ofruar me propozim të caktuar.

Valdete Idrizi: Ndoshta edhe një plotësim. Edhe Pren Gjeta, që është në kuadër të komisionit qeveritar për të pagjeturit ka marrë pjesë në shumë prej konsultimeve si në Kosovë po ashtu edhe në rajon, në Beograd. Do me thënë për këtë edhe është njëfarë përkrahjeje, bile zyrtarisht sepse e ka përkrahur edhe qeveria mirëpo shumë kishim pasur qejf që në të gjitha prej këtyre konsultimeve me qenë, sepse është një fakt që vërtetë se është brengosës por të gjitha këto prioritete, të gjitha këto telashe që i ka qeveria, nuk po kanë kohë me ardhur me i përcjell të gjitha proceset. Mirëpo, s’mund të themi se e kanë anashkaluar krejt, sepse kanë ardhur dhe jo vetëm në Kosovë por edhe në nivel me delegacione prej Kosove kanë marrë pjesë edhe në shtete tjera në rajon. Kryesisht, do të thotë, e përmenda zotëriun Gjeta, po edhe këshilltarë të ndryshëm të Kryeministrit sikur që kanë qenë edhe në Beqiq.

Besarta Vasija: Faleminderit Vali! Zotëri Atdhe? Urdhëroni!

Atdhe Berisha: Po vjen puna kur po kalohet prej një pjese në pjesë tjetër, sikur që u tha për qeverinë se ka shumë punë. Fakt se qeveria ka shumë punë, por prioritet iu ka dhënë rrugëve. Dje a po më duket nuk ishte në përrurimin e rrugës, prapë se prapë po e anashkalojmë atë se s’është në interes për me dit. Ishte problemi tek dhënia dhe mbledhja e shënimeve më herët, që u cek. Problemi është bashkëpunimi i qytetarëve me pushtetin dhe menjëherë s’i ka mbledh shënimet, ka qenë i mangët, arsyeja është e thjeshtë. Neve shqiptarëve, prej ekzistimit të Kosovës, pas shpërndarjes në vitin 1912 e deri sot nuk kemi pas pushtet vendor. Do të thotë pushteti vazhdimisht ka qenë i dhunshëm. Si rezultat i kësaj, ofrimi i një personi të dhënave të pushtetit, i thoshim përpara hafije, në atë kuptimin që nuk është edukuar ky popull. Ende polici te ne nuk shihet si shërbyes por si milic. Në atë kuptimin që dhunshëm është punuar në këtë vend. Mbledhja e fakteve në këtë kontekst ka pak probleme në aspektin psikologjik, sepse duhet me shkua me dhënë një dëshmi dhe tash e krijojmë atë oponentë... Ky është problem, është faza e parë para se me u përgatit kur vjen ajo faza për me dhënë shënimet, mundem me u relaksua në këtë drejtim, me dhënë më tepër shënime dhe si rezultat i kësaj në fund atëherë mbledhen më shumë dhe ka mundësi që ky komision me funksionuar më mirë. Kryesorja është dhe apelimi im është që edhe një herë dhe për herë të fundit është se ky komision me u formua, me u mbledh faktet e kush dhe si nuk do të ketë problem. Dashtë zoti ky komision të formohet dhe të funksionojë jo me iniciativa, qoftë të presidentit a të kryeministrit a të parlamentit se qysh jemi ne shumë parti, në momentin që e thotë presidenti a kryeministri a kryetari i parlamentit fill i vishet asaj partie dhe këtu asgjë më nuk bëhet. Ai është problemi që kemi me pas, unë mendoj kështu. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Dikush tjetër? Po, zotëriu e ka ngritur dorën, pastaj jeni ju zonjë.

Zeqir Mehmetaj: Radio “fontana” - Istog: Mua për asnjë moment nuk më ra me dëgjua për rolin e medijave në këtë drejtim.

(Ndërhyrje)

Qenka folur për këtë. Atëherë unë qenka kyç me vonesë, kërkoj falje, veç mendoj se kanë një rol më të pashmangshëm mos për kurgjo tjetër së paku për sensibilizimin e opinionit

që të bashkëpunojmë me të gjithë ata njerëz të cilët merren me këtë punë shumë të rëndësishme. Kërkoj falje që nuk kam qenë prezent kur është fol në atë kohë.

Besarta Vasija: Urdhëroni, zonja Miradije!

Miradije Gashi: Më vjen keq se më ra pak më shpesh me marrë fjalën. Kishte qenë mirë që çdonjëri prej pjesëtarëve bile pak me ia kushtua një minutë ose dy minuta dhe edhe ne t'i dëgjojmë opinionet e tyre. Mirëpo, kësaj radhe është shumë interesant se fakte e argumente paskeni mbledh, do të thotë paskeni mbledhë dhe do të jemi edhe ne të organizatave joqeveritare të gatshme të ofrojmë edhe fakte të reja, dëshmi të reja. Mirëpo, kam një dyshim këtu se kush do t'i merr këto fakte dhe kush do të na i prezantojë atëherë. Në qoftë se qeveria jo, atëherë kush do të jetë ai person i besueshëm që do t'ia japim faktet.

Besarta Vasija: Ndoshta një sqarim këtu nevojitet. Këto komisione, edhe pse themelohen prej qeverive, prej presidentit ose prej parlamentet, janë plotësisht të pavarura. Të paktën pra duhet të jenë të pavarura prej themeluesve të tyre. Do të thotë, ato nuk do t'i mbledhë qeveria por komisioni do t'i bëjë. Në qoftë se ka dikush tjetër pyetje? Po, urdhëroni! Nora Dobruna e ka fjalën.

Nora Dobruna: I pata unë disa pyetje. Desha ta di ky komision, do të thotë kujt ia referon këto të dhëna, sa kohë mendohet të funksionojë komisioni, sa konsultime janë bërë në Kosovë deri tash dhe sa mendohet të bëhen, ose kur mendohet të themelohet ky komision. Në qoftë se ka mundësi me u dhënë përgjigja.

Bekim Blakaj: Po më duket, s'e di a Gazmiri a kush e përmendi, kohëzgjatjen e komisionit. Ka pas komisione në histori, po, në bazë të përvojave tjera po flas. Ka pas komisione që kanë pas mandate ndër më të ndryshmet, më duket më i shkurtri ka qenë 8 muaj dhe ka pas komisione që s'e kanë përfunduar kurrë punën – mandatin e tyre, sepse e kanë zgjatur punën e tyre. Në bazë të përvojave tjera ne kemi ardhur në një përfundim se komisioni praktikisht ishte dashur ta ketë mandatin prej 2 viteve deri në 3 vite e gjysmë, jo më gjatë sepse pastaj edhe interesimi i publikut për komision kishte me ra dhe do të ishte më pak... Mirëpo kjo varet se çka ka me shtjellua më shumë komisioni. Nëse i futim të gjitha shkeljet, atëherë komisioni thjeshtë nuk ka me mund ta përfundojë mandatin, nëse fokusohemi në persona të zhdukur dhe të vrarë... E kam parë një insistim të madh dje në konsultimet me Rrjetin e grave që të futen edhe shkeljet e rënda siç është dhunimi. Edhe unë praktikisht pajtohem me atë dhe ndoshta kishte me qenë një nga rekomandimet... Po, edhe depërtimet e kështu me radhë. Mirëpo, nëse zgjerohet shumë atëherë komisioni s'do të mund ta kryejë misionin e vet në kohë të përcaktuar. Çka është me rëndësi, është se komisioni del me rekomandime. Pyetja juaj tjetër ishte kujt i referohet. Komisioni gjithmonë e nxjerr një raport me gjetjet, ku kanë me qenë edhe rekomandimet e komisionit, e ai raport i dorëzohet shteteve që e kanë krijuar. Në formë të librit u thotë urdhëroni, këto janë gjetjet tona, lexoni mirë dhe këto janë rekomandimet tona, e rekomandimet kanë të bëjnë me riparim, dëmet për viktimat, nxjerrjen e memorialëve e kështu me radhë mirëpo disa komisione e kanë pasur një rekomandim të posaçëm. Nëse nuk kanë mund me u marrë me një çështje, me një shkelje të caktuar po e zëmë, me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, që i kanë rekrutuar për me marrë pjesë në luftë, është shkelje e rëndë e drejtave të njeriut. Atëherë komisioni e ka nxjerrë një rekomandim që me u krijua një trup tjetër, një komision tjetër që ka me u marrë vetëm me atë çështje, kështu që gjithmonë ekziston mundësia që me u mbulua më shumë, do me thënë përmes rekomandimeve. S'e di a u përgjigja në të gjitha pyetjet tuaja?

Besarta Vasija: Faleminderit, Bekim! Nëse ka dikush tjetër pyetje? Urdhëroni, prapë zotëri Veton.

Veton Muja: A mendoni që krijimi i komisionit ka filluar shumë vonë, pasi që shumica e gjykimeve për krime të luftës në Kosovë kanë përfunduar, kanë marrë verdiktin e fundit. Sa mendoni që do të ketë komisioni efekt në rikthimin e atyre gjykimeve në rast se dalin fakte të reja, argumente të reja dhe dëshmi të reja. Pra, sa do të ketë efekt në rikthimin e atyre gjykimeve që janë krye dhe kanë marrë përfundimin.

Bekim Blakaj: Po tentoj të përgjigjem. Më herët e përmenda, para dite në fakt sot, se ne, në organizatën tonë e kemi edhe një projekt tjetër – monitorimi i gjykimeve për krime lufte dhe për krime etnikisht dhe politikisht të motivuara dhe në bazë të dhënave tona që i kemi në fakt vetëm dy gjykime për krime lufte kanë marrë formën e prerë, jo më shumë. Ka tjera, që aktakuza e parë ka qenë për krime lufte mirëpo në ndërkohë prokuroria e ka ndërruar aktakuzën dhe të akuzuarit janë akuzuar për shkelje të rënda të drejtave të njeriut dhe kështu me radhë. Aso gjykime ka më shumë. Mirëpo, ne mendojmë se nuk kanë përfunduar dhe as që janë afër të përfundohen e as që janë iniciuar lëndë për krime lufte në Kosovë. Po më vjen mirë që po e përmend se mos është vonë. Në fakt ne kemi pasur shumë raste që shumë pjesëmarrës në konsultimet që kanë thënë mos është herët për komisionin. Unë mendoj se nuk është vonë, po as herët nuk është. Do me thënë është koha e duhur me u marrë dhe me u ballafaqu me të kaluarën tonë. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit, Bekim! Urdhëroni, zonja Ilirijana.

Ilirijana Hoti: Unë e përgëzoj këtë iniciativë, se ndoshta sot është vonë por më mirë se kurrë. Dhe, çka më nxiti tash në fund, se vërtet ndoshta nuk kam qenë e inkorporuar me qëllimet e këtij komisioni mirëpo të paktën do të jetë ndoshta një dokumentim, jo vetëm vërtetim por edhe dokumentim. Ne e dimë menjëherë pas luftës ICG-ëja në Gjakovë e këta të Hagës kanë marrë dëshmi prej viktimave, por sot nuk di ku janë dhe ku kanë mbet. Janë humb. Unë kam njohuri ndoshta me gojë se këto të Hagës janë të zhdukura shumica. Të paktën le të jetë një dokumentim.

Më vjen keq kur një grua e moshuar në Vlorë, vjet, më thotë: është tragjedi që një popull ka përjetuar të gjitha ato gjëra e të paktën mos ta ketë secili person nga një ditë mbi përjetimet prej momentit kur ka filluar e deri më sot. Kaq kisha.

Besarta Vasija: Faleminderit! Dikush tjetër? Po, urdhëroni dhe prezantohuni, ju lutem!

Vllaznim Krasniqi: Pasi që në Afrikën e Jugut është bërë komisioni për amnisti, për pajtim, desha me dit se a do të jenë të kyçura edhe subjekte fetare në këtë komision.

Besarta Vasija: Valdete, urdhëro! Jo! Atëherë, Bekim!

Bekim Blakaj: Po, pyetja ishte a do të kyçen edhe komunitetet fetare në komision. Ju e përmendët Afrikën e Jugut. Në fakt po, në Afrikë të Jugut kanë qenë të kyçura komunitetet fetare dhe ne në konsultimet tona të ndryshme kemi pas përfaqësues, në fakt nuk na kanë ardhur përfaqësuesit e fesë ortodokse, por si do qoftë kemi pas përfaqësues dhe kanë qenë shumë konstruktiv. Ne do të përpiqemi që t'i konsultojmë edhe ata në këtë proces. Faleminderit!

Më fal, e përmendet edhe diçka shumë me rëndësi që s'është përmend sot. Disa komisione kanë pas mandate të ndryshme. Po dua me i përmend tash edhe disa fakte të ndryshme, varësisht se kush ka krijuar komisionin. Ne u pajtuam këtu që komisioni faktikisht ishte dashur të krijohet prej kuvendeve, parlamenteve sepse ka fuqi më të madhe sepse në parlament janë të përfaqësuar parti të ndryshme politike dhe pjesëtarë të partive prej etnive të ndryshme. Atëherë, komisioneve u është dhënë mandat më i madh,

kanë pasur disa mandat që me i bastisë nëse institucionet e ndryshme, policia ose ushtria nuk pranuar të japin dokumentacionin, arkivat e tyre, ata kanë pas të drejtë me i thirrur përfaqësuesit e atyre institucioneve në dëgjim publik. E ceke çështjen e amnistisë? Ne ende nuk e kemi një qëndrim se a mundet komisioni me i ofrua amnisti kryerësve të veprave apo jo. As unë personalisht nuk kam ndonjë qëndrim ende, sepse në një rën anë është pothuaj e pa imagjinuar prej perspektivës së viktimave po edhe të organizatave për të drejta të njeriut që mu amnistua ata që kanë kryer vepra të tmerrshme. Mirëpo, në anën tjetër, mua më kujtohet një film që për fat të keq që nuk patëm kohë me shfaq edhe një film tjetër, e ka të bëjë njëjtë me Afrikën e Jugut që ai komision u ka ofruar amnisti bashkëpunëtorëve të autoriteteve që kanë bërë krime dhe, në mënyrë që me nxjerrë të vërtetën, iu kanë dhënë amnisti. Për amnisti kanë aplikuar 7.000 kryerës të veprave ndërsa në fund gjithsej, më duket 2.000 prej tyre u është dhënë amnistia. Mirëpo, prej atyre 2.000 kanë nxjerrë të dhëna shumë me vlerë dhe më kujtohet kur e kanë intervistuar një grua e cila s'e ka ditur ku e ka burrin dhe për shkak të ofrimit të amnistisë është lajmëruar ai që ia ka vra burrin dhe praktikisht ka treguar ku janë mbetjet mortore, pse e ka bërë, kush ia ka dhënë urdhrin e kështu me radhë. Do me thënë, janë nxjerrë fakte të reja, mu për atë se i është dhënë amnistia atyre të cilët kanë kryer vepra.

Nuk ekziston ende një qëndrim – qëndrim për komisionin rajonal se a do të futet amnistia apo jo. Faleminderit!

Besarta Vasija: Vali?

Valdete Idrizi: S'po di a jemi kah fundi, Besartë? Atëherë, vetëm kisha pas dëshirë vetëm me ju falënderuar të gjithëve për këto biseda konstruktive dhe të hapura që i kemi pasur. Ju kisha inkurajuar që me i marrë materialet dhe jo vetëm me i marrë por edhe me kërkuar tjera materiale, e me i lexua gjithsesi dhe shpresoj se po, por edhe çfarë do lloj informate, sikur që kam lyp edhe unë, sepse jam bërë, mos me thënë kështu alla katundarçe zhugë e kësaj dhe fondit, sepse unë e përkrahi këtë iniciativë dhe po dua me pas material për Perunë, për Guatemalën, për Marokun. Kështu që po ju inkurajoj edhe juve se në këtë deklaratën që është e bashkëngjitur dhe besoj se të gjithë ju veç e keni pa, e ndoshta dikush edhe e ka nënshkruar, që këtu i keni të gjitha mail-adresat, do të thotë tonat, edhe sugjerim tjetër me shkrim dhe çfarëdo qoftë vetëm me pa qartë se është proces dhe janë shumë të mirëseardhura. Do të thotë, do sene që s'i di unë i dini ju dhe do sene që i di unë s'i di dikush tjetër, por ajo qasja që e përmendëm më herët gjithëpërfshirëse është shumë e domosdoshme. Faleminderit edhe një herë. Unë u ndjeva shumë mirë dhe shpresoj se kemi me u pa prapë edhe tjera herë.

Besarta Vasija: Tani ia japim fjalën organizatorit. Urdhëroni!

Veton Mujaj: Realisht, nuk kam çka të them më shumë sepse shumë gjëra janë përmbledhur dhe nuk desha të shkoj tash pikë pas pike. Qëllimi kryesor i këtij takimi ka qenë që së bashku të diskutojmë se a po shihet që ka një shpresë ecjeje në këtë proces, a ekziston vullneti i kyçjes në njëfarë mase që të japim kontributin tonë në masë çfarë mundemi ne me bë sepse secili i ka mundësitë e veta në forma të ndryshme, dikush i ka më shumë e dikush më pak, mirëpo a ekziston ajo mundësi që gradualisht të jemi grup dhe të tentojmë që bashkërisht të veprojmë. U përmendën këtu shumë detaje, prej varrezave, vrasjeve, përgjegjësia që është një hapësirë për të gjithë ish-Jugosllavinë dhe që u përmend për Serbinë, pastaj mungesa e botimeve, mos mbajtja e shënimeve, fshehja e të dhënave, mundësia që këto të dhëna me gjet formë për t'i gjenerua, me i bashkua dhe me funksionuar si të dhëna, dëgjimet publike në nivel nacional, pastaj petitionet si formë

e mundshme e reagimit të përbashkët të të gjitha parlamentet. U fol shumë për përgjegjësitë dhe çfarë forme mundet me marrë komisioni. Realisht, ne nuk mundemi me vendos dhe e thamë prej fillimit se nuk jemi ata që vendosim këtë proces mirëpo së paku është e mirë të debatojmë dhe gradualisht hap pas hapi prej sot e tutje edhe rajoni i Pejës dhe organizatat që veprojnë në këtë drejtim të kyçen në proces për dhënien e ndihmës këtij bashkëpunimi. Unë nuk kam dhe nuk dua të shtoj asgjë më tepër se nuk janë rekomandime këto, këto janë vetëm mendim i ardhur te unë prej bisedës por të gjitha bisedat që i kemi bërë janë të incizuara dhe në ndërkohë njerëzit kanë shkruar dhe të gjitha këto materiale do t'i bartim te ju për shkak se i kemi mail-adresat tuaja dhe do të mundohemi që për çdo gjë të jemi në kontakt. Realisht, është pak problem, për shkak se e dimë çfarë është çështja, është pak problem me ngacmua që dikush të jetë gjithqysh pjesë e procesit. Për këtë kishim dashtë të keni vullnet dhe të kontaktojmë së bashku. Takimet nuk kanë me munguar. Ne me Fondin jemi duke bashkëbiseduar dhe besoj se edhe organizatat tjera prej sot do të jenë në bashkëpunim në këtë rrjedhë dhe në këto formë komunikimi dhe të realizohen edhe konsultime tjera shtesë. U tha edhe diçka me rëndësi prej Bekimit, kur tha diku në shtator do të mbahet një lloj prezantimi i disa të dhënave për rajonin që për mua personalisht mu dukte element shumë i mirë dhe njëkohësisht edhe ide tjetër që mendohet së paku të ketë edhe konsultime me familjarët e viktimave të mbahet në këtë rajon sa të jetë e mundur më shpejt. Këto janë që i kemi biseduar dhe nuk është e thënë se kjo mund të përfundojë me kaq. Kisha inkurajuar secilin prej jush që ka dëshirë dhe mund të kontribuojë të marrë këtë iniciativë dhe të bashkëpunojmë në këtë proces. Unë ju kisha falënderuar shumë, duke ia nisë prej panelistëve për punën dhe disave që kanë udhëtuar me orë të tëra për me ardhur këtu, pastaj teknikën, por falënderoj edhe përkthyesin – e unë kam fol pak më shpejt dhe e kam lodhur edhe atë, që e falënderoj për punën e kryer. Falënderoj edhe anëtarët e stafit që janë kujdesur për të gjitha detajet. Mirëpo, realisht nuk mund të them diçka më shumë, por falënderoj të gjithë pjesëmarrësit sepse kanë qenë të angazhuar shumë por njëkohësisht edhe prej institucioneve komunale dhe prej organizatave ndërkombëtare që veprojnë në rajonin e Pejës. Jeni të ftuar, e di që jeni unte se disa edhe s'kemi ngrënë mëngjes, e njëri prej tyre jam edhe unë. Është një koktej me ushqim dhe është në sallën tjetër. Jeni të gjithë të ftuar. Pra, mirë u pafshim në takimet e ardhshme. Faleminderit shumë!

Besarta Vasija: Faleminderit! Unë desha edhe një informatë të vogël. Nëse dikush nga ju e ka nënshkruar Deklaratën për bashkëngjitje, atëherë është mirë të ma dorëzoni mua dhe Vetonit. Faleminderit shumë!